

Marius Dobrescu: Është një ish-studente rumune në Tiranë që ka disa vjet që përkthen nga letërsia shqipe. Është poeteshë dhe shkruan rumanisht dhe shqip. Mund të them se i plotëson të gjitha kushtet për të qenë një përkthyes shumë e mirë. Emri i saj është Oana Mihaela Glasu.

OANA MIHAELA GLASU

**Shqipja është gjuha
e zemrës sime dhe duhet
t'i kthej diçka vendit që
më priti aq mirë**

Intervistoi: Bujar Hudhri

(fq. 2)



In Memoriam për
SHPRESA VRETON

Dhe “Sirena” nënë
u kthye në shkumë deti...

Nga Mira Meksi

(fq. 9)

NJËSHI

ligjëratë nga
Stefano Massini

(fq. 9)

SHËNIME PËR LIBRAT

RUDOLF MARKU

“Rrathë të brendashkruar”

nga Arta Marku Qëndro

(fq. 5)

MUSTAFA GREBLLESHI

“Kujtime 1939-44”

nga Shpendi Topollaj

(fq. 17)

ANDREAS DUSHI

“Marrja e gjakut”

nga Alfred Çapaliku

(fq. 8)



“EMBLEMA E DIKURSHME” E KADARESË, SI M’U DUK PAS 44 VITESH

Nga Fatbardh Amursi (Rustemi)

(fq. 6)

Si të gjithë ata që bënin krijimtari të gabuar, i erdhi radha dhe Kadaresë, të dërgohet në kooperativën “Agimi” për të njohur “realitetin e mrekullueshëm socialist”, i cili gjendej kantierëve dhe arave. Masa ndëshkimore, dikujt mund t’i duket si leje krijuese, gjë që ne e prisnim me gëzim. I larguar nga Tirana pa të drejtë botimi, deputetit Kadare, nuk i lejohej të banonte në qytetin...

Ekspozita “Fotonet. Nga qielli drejt detit”

REALJA POETIKE MES DY KALTËRSIVE

Nga Alisa VELAJ

(fq. 16)

HARUKI MURAKAMI

Çasti kur u bëra
romancier



(fq. 18)

BIBLIOTEKË

Arben Prendi

(fq. 10)

Pasqyrat e kohës

Shazim Mehmeti

(fq. 11)

Ars poetica

Agron Bajraktari

(fq. 12)

Bagatelle

W. Somerset Maugham

(fq. 13)

Zotëria që i dinte të gjitha

**Pasaktësitë e
përkthimit të romanit
“Vëllezërit Karamazov”**

nga THEODHOR CICO

(fq. 14)



Marius Dobrescu: *Është një ish-studente rumune në Tiranë që ka disa vjet që përkthen nga letërsia shqipe. Është poeteshë dhe shkruan rumanisht dhe shqip. Mund të them se i plotëson të gjitha kushtet për të qenë një përkthyes shumë e mirë. Emri i saj është Oana Mihaela Glasu.*

OANA MIHAELA GLASU

Shqipja është gjuha e zemrës sime dhe duhet t'i kthej diçka vendit që më priti aq mirë

Intervistoi Bujar Hudhri

Gjatë një bisede me përkthyesin e shquar Marius Dobrescu e pyeta nëse shihej në horizont ndonjë Dobrescu i ri, nga shqipja në rumanisht. M'u përgjigj: "Po, një ish-studente rumune në Tiranë e cila ka disa vjet që përkthen nga letërsia shqipe. Është poeteshë dhe shkruan rumanisht dhe shqip. Mund të them se i plotëson të gjitha kushtet për të qenë një përkthyes shumë e mirë. Emri i saj është Oana Mihaela Glasu." Një vlerësim i madh për ju, apo jo? A mund të na tregoni si erdhët në Shqipëri dhe pse vendosët të mësoni shqip?

E lexova atë intervistë një të premte në mbrëmje, sapo u shfaq, në *ExLibris*, dhe jo vetëm më nderoi vlerësimi i z. Marius Dobrescu, pasi erdhi nga një njeri i letrave, i diplomuar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Tiranë, si dhe një përkthyes i shkëlqyer, mjeshtër në përkthimin e veprës së Ismail Kadaresë, por edhe më dha shtysë për të vazhduar dhe për të besuar se ajo që po bëj është e mirë për gjuhën shqipe, letërsinë apo kulturën, me të cilën ndihem akoma shumë e lidhur. Them mjeshtër i përkthimit të Kadaresë, sepse është e natyrshme që pas një numri kaq të madh të vëllimeve të përkthyer (minimumi 28) të bëhesh një specialist dhe një njohës i dalluar i shkrimtarit me të cilin merresh.

Nuk përtoj dhe nuk mërzitem asnjëherë të tregoj si erdha në Shqipëri. Arrita në Tiranë në vitin 1996, si pjesë e një protokollit bashkëpunimi midis Ministrive të Arsimit

nga vendet tona, sepse shqipja konsiderohej gjuhë e rrallë dhe folësit e saj ishin shumë të paktë. Po u referohem njohësve që kryejnë arsimin e lartë e që më vonë bëhen albanologë dhe mendoj se ne, rumunët e asaj kohe, ishim gjenerata e parë që rifilluam këtë traditë, pas 20 vjetësh që kur u diplomua vetë Marius Dobrescu. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë që ndoqa ishte regjistruar si opsioni i vetëm në programin e studimit për të cilin kisha fituar bursën, por më vonë kuptova se, në fakt, gjuha shqipe ishte ajo që më zgjodhi, me të cilën u dashurova dhe mbeta e apasionuar përgjithmonë. Ndoqa pak leksione në fillim për shkak të ngjarjeve të vitit 1997, por mësova duke u shkrirë me shqiptarët, duke dashur të bëhem një prej tyre, duke jetuar me ta – jo vetëm teorikisht ose në mënyrë të kufizuar, aq sa mund të ofronte një ditë leksionesh. Merrja fletoren e stilolapsin dhe pyesja se çfarë do të thoshte kjo apo ajo; diskutimet e mia ishin njëkohësisht me shqiptarë nga Veriu dhe Jugu i vendit dhe në këtë mënyrë mësoja të shprehem në dialekt, në varësi të bashkëbiseduesit. Në kuptimin e gjuhës letrare u përpoqa të vidhja sa më shumë nga pedagogët, por edhe nga librat, leximet. Në njëfarë mënyre, isha duke mësuar saktë në një mënyrë autodidakte edhe nga kujtesa vizuale, sepse doja të shkruaja në mënyrë të përsosur, ngaqë kisha vërejtur se shkruhej ashtu siç flitet. Dhe rastet ishin të shumta, nga sportelistët e konvikteve të dokumentet zyrtare në situata të caktuara.

Nëse për shkrimtarët është krejt normale pyetja përse shkruajnë, a mund t'ju pyesim se përse përktheni?

Është hera e parë që pyetem përse përkthej, sepse njerëzit zakonisht më pyesin pse e dua Shqipërinë dhe shqiptarët. Ju falënderoj që më dhatë mundësinë t'i përgjigjem kësaj pyetjeje. Kam lexuar më shumë sesa kam folur në vitet që jam larguar nga Tirana. U largova nga Shqipëria me libra, miqtë e mi më dërguan gjithmonë të tjerë dhe mjetet moderne që kemi sot më afrian edhe më shumë me letërsinë shqipe. Kështu, duke parë që disa shkrimtarë shkruajnë shumë mirë, si poezi ashtu edhe prozë, doja t'i ndaja me dashamirët rumunë të letërsisë ato që lexoja. Dhe fillova me poezi, të cilat i postova në Facebook. Me kalimin e kohës vlerësimet që poeti X apo Y mori nga lexuesit rumunë më bënë të kërkoja emra të tjerë dhe stile të tjera, që më vonë arrita t'i botoja në mjaft revista kulturore në Rumani. Diçka e tillë po ndodh sot: çfarë kemi nga Shqipëria për numrin tjetër? Pastaj bashkëpunova për shumë vjet me një revistë lokale, në të cilën botoj edhe studime gjuhësore ose artikuj të ndryshëm kulturorë për Shqipërinë. Nuk mund të bëj aq sa do të doja ose për aq njerëz sa do të doja, megjithëse i jam përkushtuar shumë kësaj pune, sepse armiku im i madh është koha. Kur përkthej, bashkë me tekstin dua të përcjell edhe frymën e atij që e shkroi dhe dua që ai të kuptohet në rumanishte ashtu siç e ndiej unë në origjinal. Shqipja është gjuha e zemrës sime dhe duhet t'i kthej diçka vendit që më priti aq mirë. Përkthej nga shqipja në gjuhën e vendit tim të lindjes për të bërë të njohur letërsinë, kulturën dhe njerëzit e saj.

Mund të na tregoni përvojën tuaj të parë si përkthyes; filluat me prozë apo poezi?

Në vitin 1997, rreth një vit pasi kisha filluar studimet për gjuhë-letërsi shqipe, në fund të vitit shkollor u përktheva studentëve të gjuhëve të huaja që bënë rumanisht ca hartime nga shqipja në rumanishte. E para fare si përvojë, kjo më duket se ka qenë. Deri në fazën e përkthimeve artistike jam marrë shumë me studime dhe duke bërë krahasime, patjetër kisha nevojë t'i përktheja. Më vonë fillova me poezi në varg të lirë, tregime dhe arrita të romani.

A është kusht që përkthyesi të jetë poet apo prozator?

Nuk mendoj se është një kusht sine-qua-non. Përkthimi nënkupton zotërimin e gramatikës së gjuhës sate shumë mirë, por edhe të gjuhës tjetër me të cilën punon. Pastaj duhet të kesh një leksik të pasur, të zhvilluar, i cili mund të merret vetëm nga shumë lexime të grumbulluara me kalimin e kohës. E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, ka nevojë për pak talent. Ashtu siç ka nevojë për pak dhunti. Por, nëse përkthyesi është vetë një krijues, atëherë kjo mund të nënkuptojë vetëm një plus, një vlerë e shtuar për produktin përfundimtar.

Përkthimi kudo në botë nuk shpërblehet siç duhet, megjithatë, duhet të ketë edhe një kënaqësi shpirtërore pse përkthyesit vazhdojnë të punojnë. Si e ndieni ju këtë kënaqësi?

Kjo është e vërtetë! Jo vetëm përkthyesit, por edhe të drejtat e autorit paguhen dobët, nëse u referohemi botuesve të mirëfilltë që botojnë libra, sepse edhe këtu ka një diskutim. Janë mbi 30.000 shtëpi botuese të regjistruara në Rumani, për shembull, por shumica e tyre kanë rolin e shtypshkronjës, domethënë ta pranojnë dorëshkrimin pa korigjim, pa një redaktor teksti. Ata ta botojnë dhe ta japin librin, të cilin e paguan vetë, natyrisht. Ka pak shtëpi botuese që bëjnë punën e tyre, në kuptimin që respektojnë autorin ose përkthyesin, dhe jo gjithmonë bëhet fjalë për ndonjë përfitim domosdoshmërisht financiar. Mendoj se është e rëndësishme që botuesi të të bëjë të ndihesh si shkrimtar përmes asaj që bën për ty ose veprës që ka botuar për ty. Personalisht, siç më pëlqen të them (shqiptarët tani e dinë këtë), punoj për kënaqësi shpirtërore dhe ndjenja e lumturisë që marr nga letërsia, ose vlerësimi im për një autor apo një tjetër, janë të paçmueshme. Dhe kjo lumturi më përkthehet në një dashuri të madhe. Kuptohet, për letërsinë që ai shkruan. Gëzimi im më i madh është lumturia e tjetrit kur ia kthej shkrimin në gjuhën time dhe rumunët njohin shpirtin e tij. Në tërësi, mendoj se do të ishte e pamundur që tregu botues i një vendi, siç është yni, të mbështesë financiarisht tarifat e duhura. E thjeshtë, sepse shkruhet shumë në krahasim me leximin, që do të thotë shitje.

Jeni shumë aktive në rrjetet sociale dhe keni shumë *friends* shqiptarë në Facebook që ju bëjnë “like” për postimet e krijimtarisë dhe përkthimeve tuaja. Është një fjalë shqipe që shqiptohet pothuaj njësoj si kjo fjalë angleze: “lajkë”. Ndaj pyetja e natyrshme do të ishte: Si i dalloni “like”-t nga “lajkat” e autorëve shqiptarë që kanë dëshirë të përkthehen nga ju?

Qesh tani kur përgjigjem! Facebook-u është një hapësirë publike për t’u shprehur. E dobishme, e shpejtë si mjet komunikimi, por në disa raste mund të bëhet edhe e rrezikshme, deri në masën që një autor të ushqehet me këto pëlqime të cilat kurrë nuk mund të kenë vlerë objektive ose të përfaqësojnë një masë të saktë vlerësimi. Një autor ose një tekst mund të ngrihet shumë më lart se këto emotikone subjektive, ashtu siç mund të vendoset në një nivel shumë më të ulët. Kam parë pseudoshkrimtarë që mbledhin 500 pëlqime menjëherë dhe tekste të jashtëzakonshme me 5 vlerësime. Sidoqoftë, mendoj se gjëja më e rëndësishme është të lexojmë tekstin ose autorin, përtej këtij konkursi ose humbjes së kohës për të parë kush të dha *like*, kush jo dhe pse. E njëjta gjë vlen edhe për komentet. Shumë pak janë të sinqerta, domethënë komentuesi provon se të ka lexuar dhe shprehet me vetëdije. Sa për mua, arrij të bëj dallimin mes lajkës dhe pëlqimit. Është e vërtetë që jam shumë e njohur dhe kam shumë miq nga ditët e qëndrimit tim në Tiranë gjatë studimeve, të cilët i dua dhe më mungojnë; këto ndjenja janë reciproke dhe shumë nga vlerësimet e postimeve të mia lidhen me këtë aspekt. Për shkak se vitin e kaluar aktiviteti im në internet ishte shumë i bazuar në promovim, kur kam përkthyer ose kam botuar një poet në një revistë, veçanërisht autorin e romanit “Fjala e fundit e Sokrat Bubës”, pa dyshim që interesi për t’u ndjekur është rritur, në kuptimin që të tjerët donin të tërhiqnin vëmendjen time. Ishte shumë e rrallë që dëshirat tona të përkojnë, pasi zakonisht jam unë ajo që zgjedh. Besimet e mia në lidhje me një tekst ose autor bazohen në atë që unë ndiej, perceptoj ose kam intuitën për atë që mund të prodhojë përkthimi midis audiencës rumune. Në kuptimin e poezisë më rrëmben metafora, por edhe saktësia e të menduarit të thellë, kurse në roman gjithmonë kërkoj përsosjen estetike ose artin e ndërtimit të portreteve. Për kohën time të kufizuar, cilësia ka shumë rëndësi. Tre rreshta poezie mund të lënë gjurmë më të thella se 10 strofa dhe një roman i mirë ndihet që në fjalinë e parë. Në të njëjtën kohë, kategorikisht, hedh poshtë letërsinë që seksualizon fjalët dhe nuk dua të kuptohem se kundërshtoj erotizmin natyror, të përshkruar në tablonë letrare, por dua të them atë që grafomania prodhon sot për të tërhequr vëmendjen, kur diçka është shumë dhe aq e keqe. Po, këto lajkat më ndodhin, unë i kuptoj ato, i ndiej. Për të qenë shumë e drejtpërdrejtë, refuzoj më shumë sesa pranoj dhe, sinonim i lajkës, ky *like* pas një kohe zhduket vetë. Nga këtu nuk e di se çfarë ndodh, nëse ai që e refuzoj më mban *friend* në listë, sepse as nuk e di sa miq kam dhe nuk ka imponime, madje as virtuale, për një marrëdhënie miqësore.

Marius Dobrescu është, si të thuash, përkthyesi zyrtar i Kadaresë, ndaj nuk ka kuptim pyetja se përse nuk keni përkthyer nga ky autor i shquar shqiptar. (Madje, ky fakt është i mirëpritur për autorët e tjerë që ju do të përktheni.) Jam kurioz të di, në fillimet tuaja, a keni krahasuar ndonjë libër rumanisht të Kadaresë me variantin shqip, thjesht për të marrë përvojë si përkthyes?

Marius Dobrescu është përkthyesi i vetëm dhe më i miri i Kadaresë. Po, është zyrtarisht ai që mban të drejtat e autorit në Rumani për veprën e shkrimtarit të shquar dhe ne shpesh e quajmë atë “përkthyesi i Kadaresë” e jo me emër. Së pari, është çështje e deontologjisë që të mos ndërhysh në punën e një përkthyesi tjetër, veçanërisht kur e di faktin, siç e thashë në fillim, se ai është një specialist i atij autori. Pastaj, përkthimet e Marius Dobrescut janë shembullore dhe nuk mendoj se ai apo ato do të kishin nevojë për riinterpretim. Për shembull, kam lexuar “Kronikë në gur” në shqip dhe më vonë, pas një kohe, e kam lexuar romanin edhe rumanisht. Ishte njësoj. Me një fjalë, mbivendosja e Marius Dobrescut me tekstin origjinal nuk lë hapësirë për vërejtje. Asnjëherë nuk kam menduar të kontrolloj, të bëj analizën e çfarëdo lloji midis teksteve. Në përkthimet e mia ose, le të themi, te përkthimi im më i rëndësishëm, që nënkupton romanin e lartpërmendur, evitova krahasimet, ndikimet, nuancat ose interpretimet e sekuencave. Arsyeja është se gjithmonë preferoj të kem një komunikim të drejtpërdrejtë me autorin që po përkthej, kur diçka nuk është shumë e qartë për mua. Dhe nuk gabova duke e bërë këtë, sepse, në këtë mënyrë, përmes shpjegimeve të ofruara nga autori për

një fjalë apo një frazë, arrita të shkoj përtej kuptimit të fjalës, në mendjen apo zemrën e autorit. Dua të them se ky komunikim i drejtpërdrejtë, për mua, do të thotë gjithashtu të njohësh llojin, temperamentin, karakterin e autorit, gjëra thelbësore për dhënien e një teksti, si përkthim, natyrisht, përveç talentit ose stilit, gjithashtu përparësi.

Nuk e di si do të ishte sikur të ekzistonte një *curriculum vitae* në paraqitjen e këtij përkthimi të parë e aty të ishte emri i Kadaresë dhe cili do të kishte qenë ndikimi apo perceptimi për mua në këtë pozicion të ri, atë të përkthyesit. Besoj shumë në fatin e njeriut dhe veçanërisht të një libri, sidomos kur yjet rreshtohen për suksesin e tij. Është e vërtetë që përmes përkthimit ne njohim një vepër të huaj dhe sukcesi i saj në gjuhën në të cilën është përkthyer varet shumë nga cilësia e përkthimit, sepse nganjëherë përkthimi është ai që mund të shkatërrojë një autor. Që në fillim kam menduar në aspektin e prezantimit të shkrimtarit dhe romanit të tij në rumanishte, për vlerën e tekstit, për respektin ndaj gjuhës shqipe dhe autorit, dhe më interesonte më pak cilësimi im i ri, si një plan personal, përmes të cilit as sot nuk jam duke kërkuar ndonjë afirmim. Madje as pas reagimeve pozitive dhe lavdëruese ndaj cilësisë së përkthimit.

Ju keni përkthyer dhe promovuar një autor si Thanas Medi, vepra e parë e të cilit u nderua me çmim kombëtar në Tiranë. A mund të na flisni për këtë përvojë?

Për marrëdhënien time me Thanas Medin si shkrimtar, ose për përkthimin e romanit të tij të vlerësuar me çmimin e madh nga vendi i tij, nuk mund të flas në të kaluarën,



sepse bashkëpunimi ynë vazhdon me përkthimin e një romani tjetër të tij, si dëshirë imja, por edhe me kërkesë të botuesit *Eikon*, i cili dëshironte të bënte një seri botimesh për veprën e këtij shkrimtari. (Bëhet fjalë që *Eikon* të botojë edhe librat e tjerë.) Zbulova rastësisht një shkrimtar të madh shqiptar, të cilit i kërkoja romanin “Fjala e fundit e Sokrat Bubës”. Fjalia e parë premtoi vërtet një libër të shkëlqyer, por nuk fillova menjëherë përkthimin. Pas gjithë magjepsjes që prodhoi teksti për mua, pësova një bllokim. Kishte kaq shumë bukuri në këtë libër, sa më mbyti. Pastaj lexova tregimin “Këpucët” në Facebook dhe e kontaktova menjëherë për të më lejuar ta përktheja dhe ta botoja. Ky tregim bëri xhiro në shumë revista në Rumani. Pastaj përktheva tri histori të tjera, ndërkohë që kisha arritur larg me përkthimin e romanit. Ajo që mund të them sot, kur romani arriti te lexuesit rumunë, por edhe te kritikë ose shkrimtarë të caktuar, të cilët tashmë janë shprehur dhe të tjerët do të vazhdojnë ta bëjnë këtë, është se mendimi im për Thanas Medin filloi të bëhet mendimi i shumë rumunëve dhe ne këtu e njohim atë vetëm me shkrim. Kam përkthyer “Fjala e fundit...” në rumanishte, por e kam lënë shkrimtarin në çdo fjalë, nga fryma kur lexojmë deri në një thellësi të shpirtit të tij, për të cilin vetëm ai e dinte se si dridhej kur shkroi, por kritikë Christian Crăciun, për shembull, arrin të futet atje dhe të kuptojë saktësisht se çfarë dëshironte autori të mbetej nga ky libër. Fakti që në Rumani vepra e tij shikohet në kuptimin e letërsisë së madhe dhe vetëm nga një libër tani për tani, forcon bindjen time që zgjedhja ishte shumë e mirë. Tekstet e tij nuk lexohen, por ndihen, sepse cilësia e tij e madhe e transformimit të një ndjenje të veçantë në një kolektive i kthehet individit në të njëjtën masë subjektive gjatë leximit. Gjithkush e gjen veten në personazhin ose gjendjen që i përshtatet dhe këtu mendoj se ndodh një shndërrim alkimik në mënyrë të pavullnetshme. Jam e lumtur me gjithë suksesin e shkrimtarit deri më tani në vendin tim dhe e di që ai do të vazhdojë të rritet. Më vjen mirë gjithashtu që me shfaqjen e romanit në gjuhën rumune shqiptarët e rizbulojnë dhe e kërkojnë librin e tij në libraritë e Tiranës, ku fatkeqësisht nuk gjendet më, por jam e kënaqur me interesimin për shkrimtarin e tyre. Promovimi. Është një subjekt i gjerë dhe një vepër e veçantë që vjen në mbështetje të një shkrimtari. Sepse ai ishte këtu një i huaj, nuk dihej asgjë për të dhe duhet ta ndërtosh imazhin e tij në një mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme. Ky mbetet një nga kapitujt më të vështirë për mua, por nuk mund të bëhet ndryshe. Unë shkoj kudo në Rumani gjatë kësaj periudhe me shtëpinë botuese për ta prezantuar atë, për të organizuar lexime publike, përkthej dhe botoj pjesë nga romanet e tjera etj. Thanas Medi hyri vonë në letërsinë e madhe, por ai erdhi të qëndrojë dhe emri i tij meriton të përpiqesh për atë që, ndoshta, ne do ta vlerësojmë më vonë që ai i la letërsisë universale.

Cilët nga autorët shqiptarë njihni më mirë dhe a keni përkthyer prej tyre?

E njoh më së miri Kadarenë, sigurisht, sepse e lexoj më shumë. Si në rumanishte ashtu edhe në shqipe. Kudo në botë, secili prej nesh jemi pak a shumë të shënjuar në një moment nga ai idhull që lexojmë gjatë gjithë jetës, ose nga ai model në letërsi, qoftë yni apo i huaj. Është absolutisht normale dhe ndodh pothuajse në mënyrë të pavullnetshme, si efekt i depozitave të informacionit për secilin prej nesh. Fakti që e lexova në gjuhën shqipe gjithashtu më ndihmoi të identifikoja ose të dalloja shkallën në të cilën ndërhyjnë një ndikim i caktuar te shkrimtarët shqiptarë dhe cila është pika ku ata shpëputen nga modeli i tyre dhe ndjekin rrugën e vet në letërsi. Kjo është një analizë personale, të cilën e bëj pa një qëllim të caktuar dhe për të cilën nuk tregoj ndonjë konsideratë kritike për dikë. Në përgjithësi, lexoj letërsi bashkëkohore shqiptare, sepse segmente të publikut rumun në duart e të cilit përfundojnë revistat në të cilat botoj autorë shqiptarë duan të vazhdojnë të lexojnë nga i njëjti autor ose diçka nga shqipja. I kam përkthyer dhe botuar me poezi ose tregime disa shkrimtarë, si: Agron Tufa, Besnik Mustafaj, Rexhep Shahu, Petrit Ruka, Ramiz Gjini, Zhaneta Barxhaj etj. Agroni dhe Zhaneta janë tashmë të përfshirë në një antologji. Një prozë e Odise Kotes do të dalë së shpejti dhe ndoshta e merr vesh tani duke lexuar *ExLibris*, sepse ishte një surprizë për të. Unë marr me postë ose në format pdf romane, vëllime të shumë shkrimtarëve, por është e pamundur t’i përballosh. Po punoj për romanin e dytë të Thanas Medit dhe në përgjithësi, 10 orë në ditë i kushtoj përkthimit. Është një përpjekje, por edhe një kënaqësi. Gjë që rritet gjithnjë e më shumë kur vëren reagimet ndaj krijimtarisë së tij nga ana e rumunëve.

Problemi më i vështirë për përkthyesin është se si të gjejë botues. E keni të vështirë që t’i botoni autorët shqiptarë? Meqenëse jemi në Ballkan dhe paragjykimet ekzistojnë, apo jo?

Këtu ka dy aspekte. Sa u takon revistave, nuk është aq e vështirë, sepse atyre u duhen shkrime, artikuj, që të shtypen. Në Rumani shumica e revistave kanë seksione të tilla si: Universalia, Meridiane ose seksioni i të ftuarve, të gjitha të destinuara për letërsinë e huaj në përgjithësi, shkrimtarë të huaj, përkthime... Ato shtypen nga njëra anë me fonde nga Ministria e Kulturës, Lidhja e Shkrimtarëve dhe nga ana tjetër, me fonde private si sponsorizime. Kuptohet që artikujt nuk paguhen nga autorët, as autorët nuk marrin ndonjë shpërblim, por, për ato që po përjetojmë sot, habitem që ato revista dalin akoma. Për vëllimet me poezi, tregimet ose romanet situata ndryshon. Këtu ka nevojë për botues seriozë që ta pranojnë tekstin në kuptimin e botimit të tij, por aspekti më i rëndësishëm mbetet promovimi i librit dhe autorit. Promovimi është bërë një institucion më vete dhe për një autor të huaj, aspak i njohur për publikun, është vital.


Sa i përket botimit të autorëve shqiptarë, asnjëherë nuk më kanë refuzuar, përkundrazi, akoma më kërkojnë tekste dhe nuk ka paragjykime. Para së gjithash, redaktorët e revistave bëjnë një përzgjedhje dhe kur unë marr përgjigjen që teksti i shkrimtarit filan do të botohet, përveç gëzimit, kam parasysh faktin që përkthimi ka kaluar testet e cilësisë, sepse përndryshe kompromisi editorial do të ishte i madh dhe askush nuk e merr përsipër. Së dyti, gjithmonë bëj një prezantim për shkrimtarët që botoj dhe gjithashtu i dërgoj një letër qëllimi kryeredaktorit, ku flas për gjuhën shqipe dhe njerëzit e kulturës në Shqipëri. Gjithmonë i zgjidhja vetë tekstet që i përktheja, sepse më pëlqenin dhe sepse e dija që ato do të tërhiqnin vëmendjen e lexuesve rumunë, domethënë ishin të përshtatshme për përkthim, pa pasur nevojë për përpjekje, vetëm për dashurinë ndaj artit.

Dorëshkrimin e romanit që përktheva ua dërgova disa botuesve dhe ca prej tyre m’u përgjigjën menjëherë, duke dashur ta botonin. Zgjedha shtëpinë botuese *Eikon* në Bukuresht, sepse është një fenomen në tregun botues rumun. Ajo është një nga të paktat që shkon me libra në të gjithë territorin për të promovuar autorët, domethënë organizon turne në shumë qytete ose rajone dhe mbërrin gjithmonë në vendlindjen e autorit, në shenjë respekti të lartë për të. Për “Fjala e fundit...” ajo erdhi në qytetin tim të shtunën e kaluar dhe shumë njerëz zbuluan gjëra interesante rreth shkrimtarit ose romanit. Shtëpia botuese punon me një grup kritikësh, të cilët shpesh shoqërojnë karvanin e librit në panairë, ngjarje kulturore dhe kronikat e tyre kanë rolin e udhëzimit të lexuesit, për ta ndihmuar atë të zgjedhë librin e duhur. Një aspekt tjetër është se nuk boton çdo gjë, kështu që edhe këtu ndërhyr përzgjedhja, me fjalë të tjera, cilësi dhe jo sasi. Për një shkrimtar të huaj mendoj se ka shumë rëndësi të përkthehet nga një njeri i lindur në gjuhën e shtetit ku edhe duhet të botohet, të promovohet, të shitet, sepse ky është një aspekt vlerësimi, por edhe një lidhëse urash midis kulturave të dy vendeve.

Studiuesit e gjuhës kanë gjetur shumë pika takimi midis rumanishtes dhe shqipes. Rumunët dhe shqiptarët janë kushërinj të një gjaku, ka thënë personaliteti i shquar i Rumanisë, Nikolae Jorga. Si njohëse e shkëlqyer e këtyre dy gjuhëve, cili është mendimi juaj?

Mendimi im është i njëjtë dhe kjo nuk është një gojëdhënë, por një e vërtetë që unë e kam jetuar, përjetuar, studiuar në 7 vitet e kaluara në Tiranë. Lidhjet midis popujve tanë janë të lashta, në sfondin dako-thrako-ilir, por do të përmend vetëm disa aspekte. Dëshmia e parë e mbërritjes së një numri masiv (15.000) shqiptarësh (mes tyre shumë arumunë) në Rumani daton që nga viti 1595. Ata ishin kryesisht ushtarë, tregtarë, personalitete dhe arritën të integroheshin shpejt në mjedisin politik dhe kulturor rumun për shkak të afiniteteve të gjuhës dhe zakoneve. Deklarata e historianit të famshëm Nicolae Iorga është shumë e vërtetë. Shqiptarët dhe rumunët janë kushërinj të një gjaku. Në vitin 1915 Iorga zbuloi tekstin e parë shqip (Formula e Pagëzimit) dhe në vitin 1919 ka shkruar historinë e parë të Shqipërisë në frëngjishte.

Marrëdhëniet tona gjithmonë janë mbështetur në një miqësi të madhe, një mbështetje e pakushtëzuar nga Rumania e cila në shekullin XIX u bë djepi i Rilindjes Shqiptare, pasi shumë prej atyre që do të kontribuojnë me vendosmëri në formimin e shtetit shqiptar emigrojnë këtu: Naum Panajot Veqilharxhi, Dora d’Istria, Jani Vreto, Nikolla Nacio, Lasgush Poradeci, Viktor Eftimiu, Asdreni, Ibrahim Temoera etj. Disa konsiderata gjuhësore që mund të nxjerrim nga studimet e përbashkëta të dy studiuesve në këtë fushë, Eqerem Çabej dhe Grigore Brâncuși, mendoj se e forcojnë mjaft deklaratën e Iorgas, në kuptimin që rumuni Brâncuși konsideronte se shqipja dhe rumanishtja karakterizohen, brenda bashkimit gjuhësor ballkanik, nga një farefisni e ngushtë. Kjo farefisni shihet, siç dihet, në të gjithë sistemin e dy gjuhëve, në përbërjen fonetike, në strukturën morfologjike, në ndërtimin sintaksor, në frazeologji, në fjalëformim dhe në leksik, kurse shqiptari Çabej mendonte se afërsia është aq e madhe, saqë gjuhëtari shpesh ka përshtypjen se ka vetëm një lëndë të gjuhës përpara. Nga karakteri i këtij afiniteti mund të



thuhet me njëfarë sigurie se në historinë e tyre populli shqiptar dhe populli rumun ishin në afërsi të njëri-tjetrit, në disa vende ata mund të kenë jetuar në simbiozë.

Na flisni pak për rutinën e punës suaj: a përktheni çdo ditë? Përktheni pasi ktheheni nga puna, në mëngjes herët apo natën vonë?

Absolutisht përditë, me shumë pak përjashtime. Në shtëpi, në punë, në park, kudo. Kuptohet që për poezitë ose tregimet koha është më e shkurtër, por për romanin punoj mesatarisht 10 orë në ditë, siç e thashë. Ndodh që për një sintaksë ose përshtatje të topikës të humbas gjithë ditën dhe të mos shkruaj asgjë tjetër. Ose më ndodh të zgjahem natën, sepse atëherë kam një moment më të mirë të krijimit. Përkthimi është gjithashtu një krijim. Në thelb, rishkruaj gjithçka që nga fillimi, por libri do të mbetet gjithmonë i autorit. Përkthej poezi ose tregime kur lodhem nga romani ose frymëzimi më lë. Është mënyra ime se si pushoj... Pjesën tjetër të kohës ua jap detyrimeve të tjera, të cilat gjithashtu janë të shumta.

A mund të ndani sekretet e punës suaj me lexuesin tonë: kur e ndieni zërin e autorit që po përktheni, në leximin e parë, të dytë...? E lexoni fillimisht deri në fund romanin që do të përktheni dhe pastaj nisni punën, apo, për të mos shuar kureshtjen, e përktheni ndërkohë që po e lexoni?

E lexoj nga fillimi dhe jo një herë. Pastaj rifilloj kapitujt dhe diskutoj me autorin fjalët që nuk i kuptoj, pasi mbase janë dialektore ose mbase nuk i kam dëgjuar kurrë. Tashmë kam thënë që një tekst i mirë më tërheq nga fjalja e parë ose vargu i parë. Nga këndvështrimi im, është e vështirë, nëse nuk përjashtohet mundësia, që një tekst letrar të përkthehet në shikim të parë. Në përkthimin gojor është e mundur, në rastin e një romani mendoj se është kundër rregullave. Kur po lexoja romanin e Thanas Medit, në mendjen time fjalitë në rumanishte ndërtoheshin aty për aty dhe rridhnin vetë, por, kur po përktheja, duhej të bëhesha një me autorin, të shkrihesha me të. Kjo është arsyeja pse bashkëpunimi autor-përkthyes ishte shumë i dobishëm për mua, sepse jo vetëm që zëvendësoja fjalët, por riprodhoja autorin me të gjitha ndjenjat ose mendimet e tij në rumanishte. Që të kisha sukses në këtë, duhej të zhytesha në kuptimet ose thellësitë e të menduarit të autorit në kohën kur u krijua libri. Për shembull, isha e interesuar në situata të caktuara se çfarë po mendonte autori duke përdorur një fjalë të caktuar. Ose, në shumicën e kohës, për të zhvendosur veten plotësisht në lëkurën e autorit, ishte edhe më e nevojshme. Do t’ju tregoj një sekret të vogël. Përtej talentit, stilit të veçantë, leksikut të larmishëm, mendimit filozofik ose interpretimit të jashtëzakonshëm psikologjik të karaktereve njerëzore, proza e Thanas Medit bazohet në diçka absolutisht thelbësore, siç është ritmi. Ai është një autor lirik dhe e kuptova që në fillim se, nëse humbas ritmin, e humbas librin. Ose do të dukej si një poezi me ritëm të ndërprerë dhe në fund, mund të dilte vetëm një katastrofë.

Meqenëse jeni vetë poete, si arrini t’i ndani këto dy akte krijimtarie? E planifikoni apo kjo ndodh në mënyrë intuitive?

Mund të them që bazohem më shumë në intuitë sesa në plane. Nëse e do atë që bën, arrin të pajtosh ndjenjat e së njëjtës kornizë të shfaqjes së krijimit.

Lidhur me krijimet e mia, poezinë time, kam shkruar për një kohë në shqipe, sepse kam menduar direkt kështu, por edhe sepse miqtë shqiptarë nuk e kuptonin me përkthimin e Facebook-ut, dhe kjo funksionon për të dyja gjuhët. Rumunët gjithashtu më pyesin të njëjtën gjë kur përkthimi në Facebook është i mangët dhe deformon shumë përmbajtjen. Ndihej më afër kësaj gjinie letrare, sepse ajo, poezia, ka qenë diku në mua për një kohë të gjatë dhe mbase moshë, pjekuria e të menduarit, më përcakton të shprehem tani. Pastaj është çështja e stilit tim të ndërtimit, duke qenë një person i prirë drejt hermetizmit dhe natyrisht, në këtë kuptim doja të eksperimentoja në shqipe, si përvojë, interpretim dhe veçanërisht si ndikim për lexuesit shqiptarë.

Një përkthyes letrar përkthen kulturën e një vendi, jo thjesht gjuhën. Si i ruani lidhjet me Shqipërinë?

Gjuha është një instrument për të dhënë kulturën e një kombi, që do të thotë tërësia e modeleve të mendimit, qëndrimit dhe veprimit që karakterizojnë një popullatë ose një shoqëri. Ajo përfshin përbërësit idealë – besimet, vlerat, simbolet, modelet e veprimit – dhe përbërësit materialë.

Lidhjet e mia me Shqipërinë mbahen përmes komunikimit të përditshëm me miqtë (dhe kam shumë), por kryesisht përmes këtij plani kulturor të realizimit të njohurive personale, përvojës gjuhësore, si dhe një afrimi të pakufishëm ndaj gjithçkaje që do të thotë vlera të këtij vendi, i cili më adoptoi për një kohë, por mbeti vendi im i dytë, përgjithmonë. Gjatë viteve kam botuar artikujt të shumtë në revistën *Oltart* në lidhje me traditat, personalitetet, ngjashmëritë e gjuhës, pasi gjithmonë kam konsideruar që një vend me njerëzit ose kulturën e tij duhet t’i bëhet i njohur botës me të gjitha më të mirat, më të çmuarat dhe jo përmes përshtypjeve të rreme ose të ekzagjeruara televizive. Në përgjithësi, bëj ose shkruaj vetëm atë që ndiej, dhe ndiej dashuri të madhe për Shqipërinë e shqiptarët gjithashtu!

Mbi librin “Rrathë të brendashkruar” të Rudolf Markut

KOMPASI I POETIT

Nga Arta Marku Qëndro

*Këpucët e vjetra nuk i dreqim më.
Vonë në muzg i hedhim në qoshen ku nuk na sheh
askush,
sikur të ndienim turp prej tyre. E kush nuk ndien
turp nga gjërat e vjetra?
Po këpucari plak ku mund të jetë? Ai që kërrusej
për të arnuar shollën e ngrënë, lëkurën tërë plasa,
thumbat si dhëmbë të rënë
Më thonë se ka vdekur
dhe unë nuk mund t’ia sjell as emrin ndërmend...*

Është poezia “Këpucari plak” prej nga e nisa, kushedi për ç’rastësi a kumt të pashpjegueshëm, leximin e librit “*Rrathë të brendashkruar*” (botimet ONUFRI) të Rudolf Markut. Ndala gjatë te kjo poezi që flet për kohën tonë, për kohën kur gjërat e vjetra i flakim në rrugë, për t’u ndjerë më mirë, më të sigurt, por pa mundur megjithatë.

Përtej kësaj poezie konkrete, poezia në përgjithësi, më shumë se *gjërat*, na provokon ndjesi. Na bën të ndihemi më mirë, me gjasë, edhe më keq. Gjithsesi ndihemi të turbulluar, për ta gjetur sërish qetësinë, ndoshta, pas kohës së reflektimit për shkak të saj.

Datat në fund të poezive të librit, edhe pse ndonjëherë mungojnë, na bëjnë me dije se jemi në një fragment krijimtarie të kohëve të fundit të autorit. Jemi në shekullin e ri. Ndryshe e thënë kemi të bëjmë me këndvështrimin e sotëm të poetit që, si një krah gjigand kompas, rrotullohet e vizaton rrathë virtuale: mbi botën, gjërat, jetën, vdekjen, të sotmen, të djeshmen, kujtesën, vendin, atdheun, lëvizjet, ikjet e rikthimet... dhe padyshim, mbi dashurinë në 360 gradë.

E cili poet do të shkruante poezi duke e anashkaluar dashurinë? E cili libër poetik nuk e ka hapësirën e vet të dashurisë? E cili lexues nuk do të priste, pashmangshëm, në një vëllim poetik, leximin së paku të një copëze për dashurinë?

Sakaq, poetët kanë këndvështrimet e tyre. Të ngjashme apo të ndryshme nga njëri-tjetri, të ndryshme herë-herë edhe brenda vetes. Pikërisht sepse dashuria shihet nga kënde të ndryshme nga hera në herë. Gjithnjë është një pikë tjetër në të cilën gjendet poeti në momentin e parë, tek nis e rrotullohet, bashkë me krahun e kompasit që lë mbi letër gjurmën virtuale të një rrethi.

Josh dashuria që ikën, zëvendësuese e asaj që dikur vinte. Prania e mungesës ose mungesa e pranisë. Nuk ta lejon shpërfilljen një tatuazh që koha s’e ka cënuar. As edhe një çast i largët që kujtoje se e kishe harruar e që vjen e shfaqet pikërisht kur nuk e pret. Të mbytet malli i shkaktuar nga distanca, përzier me përfytyrimin e dhomës së zhveshur e dashurisë...

*Ti merr avionin në moskohë. Nuk është as ditë, as natë,
Konfuzion i natyrshëm i së qeshurës me lotët;
Ndej honin e mungesës së trupit tënd.
Po kështu, Zotat e lashtë, hutueshëm do ta kenë
ndjerë humbjen
Pasi e krijuan botën...*

Në fragmentin e poezisë “*Pas ikjes sate*”, përfytyrimi është ai i ndarjes së dy të dashuruarve në një aeroport. Por nuk është një përfytyrim konkret, megjithatë. As një çast konkret, as një kohë konkrete, as një vend konkret, siç janë gjithnjë aeroportet: vende të ndërmjetme, askundi e gjithkund. As në ajër as në tokë, edhe në ajër edhe në tokë, as për ndarje as për takime, edhe për ndarje edhe për takime. Një lloj hapësire pragnore e vështirë për t’u përkufizuar.

Poezia nuk ka emër vaje e as burri. Veç në mos për vetë poetin. Por ai s’na e thotë. S’na lipset. Na mjafton përcaktimi *nimfë*. Poezia i tejkalon njerëzit konkretë sepse për të gjithë, *qenka e vështirë ta vështrosh nga larg/ atë që nuk e ke më pranë*.

Çfarë mund të përfytyrojë lexuesi në një rast të tillë, në mos MUNGESËN, MOSPRANINË dhe HUTIMIN që prodhon, ndjesinë e HUMBJES që edhe vetë ZOTAT DUHET TA KENË NDJERË pavarësisht madhështisë...

O grua që të ndesha në tafkobin e kësaj bote – thotë Rudolf Marku, teksa rrotullohet me krahun e kompasit të tij, i bindur se veç dashuria nuk mund të parashikohet dy herë nga orakujt. Nuk mund të ndalemi dy herë në të njëjtën pikë. Kompas rrotullohet, por gjithherë maja e tij gërvisht rrathë të rinj.

*Ishte dashuria. Kishim rënë jashtë kohe.
Kalonim mes një zjarri që ndizej përherë e më tepër.
Nuk kishte as muaj e as vite. Ditët ishin çastet kur
ishim bashkë.
Zjarrfikësit të gjithë, të gjithë kishin vdekur.
Edhe qyteti kishte vdekur. Parajsa qe bashkuar me
Ferrin...*

Nëpër poezitë e librit “*Rrathë të brendashkruar*” herë dashuria është me D të madhe, e paidentifikuar me dikë konkret. Të tjera herë dashuria kërkon të lerë një gjurmë të dukshme. Të individualizohet. Njëra poezi lidhet pikërisht me një emër. Titullohet “*Për Alma P.*” Nis në vitin 1972 dhe mbaron në vitin 2019.

Më vjen kaq papritur kujtimi yt – shkruan poeti. Fundja kujtesa, e ndryrë në një sënduk, vjen e të shfaqet para sysh. Një copëherë e gati 50 vjetëve të shkuara del e të zë rrugën e ti nuk i shmangesh dot. Edhe mund ta kishe harruar që ajo copëz kish qenë në sëndukun tënd, por ajo nuk e pranon harresën. Kujtesa e zotëron harresën. Padyshim, jo gjithçka e palimpsestit njerëzor ka të njëjtën peshë. Çfarë harrohet ka qenë pendë e lehtë, e parëndësishme, e destinuar të harrohet. Çfarë del nga thellësia e kohëve, qoftë edhe papritmas, për t’u shfaqur në të tashmen, me siguri ka qenë plumb e nuk mund të fluturojë.

Krilla e kujtimit tënd, fluturoi përzishëm, thotë Rudolf Marku në një tjetër poezi. Ama bëhet fjalë për fluturim *fantazmash* që sillen gjatë gjithë kohës, pa shkelur tokën e të lidhura me tokën, rrotull njeriut, pa ikur asnjëherë përgjithnjë. Të gjithë kemi *fantazmat* tona që bëjnë rrathë që na brendashkruajnë.

Poeti, siç besoj, ia nis nga vetja. Edhe për Rudolf Markun mendoj se, tek vizaton rrethin e radhës, pika fillestare është ai vetë. Ai si burrë, si njeri, si banor, si shtegtar... Ai si poet, përballë poetëve që i përbashkon poezia.

Sa shumë poezi për poetin dhe poezinë të mbledhura në një libër të vetëm. Ndoshta sepse një poet e di më mirë se kushdo, se poetët meritojnë t’u kushtohen poezi. Rrathë të panumërt, brendashkruar rrethit të madh poetik, parë pikërisht nga këndvështrimi i vetë poetit.

Rudolf Marku

Rrathë të brendashkruar



OnufriPoezi

*Poetët mblidhen në Ferr,
Mes sqqfurit djegës. Bisedojnë të qetë
A thua se janë në shtëpitë e tyre...*

Nuk është e rastësishme që vetë filozofët i kanë hedhur, gjithnjë, sytë nga poetët dhe poezia. Ndonjëherë i kanë “përrjashtuar nga qyteti” si demonë të rrezikshëm. Se e mbartin edhe “rrezikun” poetët. Nga ana tjetër, nuk është e rastësishme që poetët japin e marrin me idetë e filozofëve edhe kur argjila e skulpturës së tyre është poeti vetë.

Dhe vështirë se dikush mund ta kundërshtojë Rudolf Markun kur shkruan:

*Kur anija e poetit të thyhet prej dallgëve,
Me dhogat, hartat, velat që pluskojnë mbi det,
Ndërtoni varkat tuaja
O njerëz që qëndruat gjithë jetën në breg...*

Pra, POETI ËSHTË UDHËRRËFYES. Aq sa edhe një filozof, jep kumte filozofike, mëson filozofi jete. Aq sa edhe një psikolog, kërkon të shpjegojë njeriun. Dhe pastaj, poeti është prani...

*Poetët nuk janë zogj migratorë, nuk shtegtojnë në vende të largëta.
Madje edhe kur vdekja i merr, pa lajmëruar askënd...
Miku ynë vazhdon të na dërgojë poezitë e tij që nga bota tjetër...
Poezitë e fundit që nuk kishim kohë t’i lexonim bashkë,
Poezitë më të fundit që nuk i dërgon me postë, ngaqë kurrë nuk u besoi postave...*

Asnjë indikacion në libër, por vargjet më ravijëzuan Ndoc Gjetjen. Kështu e lexova unë. Madje lexova një ndërthurje. Një zgjatim të Ndoc Gjetjes te Preç Zogaj, në një poezi të vetme, me pamundësinë për të gjetur kufirin e vërtetë ndarës. Sepse ndoshta kufi s’ka. Një tjetër lexues nuk di a nuk mundet të afrojë emra konkretë a ndonjë portret poeti me tipare reale. Dhe ndoshta më mirë kështu. Se poeti është koncept edhe pse i mishëruar te një njeri, edhe pse i shkrirë në një lëndë të pandashme më. Poetët i përbashkon, siç duket e mes të tjerash, prania e përjetshme. Nuk ikin kurrë, mjaft të kenë shkruar një poezi që ende lexohet. *Poeti galaksinë e shndërron në shtëpi të zakonshme e shtëpinë e vet e kthen në galaksi.*

Te “*Rrathë të brendashkruar*” janë brendashkruar poetët, herë me emra, herë me vargje, herë me tituj, herë me përrshkrime... Janë poetët, miq të poetit, pavarësisht nga kohët e vendet prej nga vijnë. Janë miqësi të lidhura nga “vargoj” poezie. Janë Gjetja, Zogaj, Ačka, Dantja, Rilke, Uitmani, Pesoa, Homeri, Safo, Ovidi, Migjeni... Poetët që, sipas Rudolf Markut, as nuk kanë vdekur e as nuk do të vdesin.

Nuk vdesin poetët, por nuk vdesin as nënat e poetëve. I kanë përjetësuar bijtë, gjithnjë të pranishme në libra poetikë, rrathë brendashkruar një rrethi më të madh.

*Nuk vdesin nënat e poetëve.
Edhe kur na shohin prej botës tjetër
Me atë shikimin e hutuar të fëmijës që humbet papritur,
Edhe kur psherëtimin me një zhurmë dallgësh,
Edhe kur harrojnë emrat tanë,
Nuk vdesin nënat e poetëve – i grisni nekrologjitë!*

Dhe kompas i poetit vijon të rrotullohet, të krijojë rrathë pas rrathëve...

E pata pyetur Rudolf Markun, kohë më parë, se çfarë është poezia për të. Dhe m’u pat përgjigjur duke iu referuar një tjetër poeti: “*Robert Frost, duke dhënë një përcaktim për përkthimin, jep indirekt një përcaktim për poezinë. Ai thotë, se poezia është ajo që mbetet pa u përkthyer, ajo që nuk arrin të përkthehet. Ajo që tepron mes tekstit origjinal dhe përkthimit*”. Çfarë nënkupton Robert Frost me këtë? Sepse me fjalë poezia është përkthyer dhe prapë diçka paskësh mbetur. Sipas Rudolf Markut, ajo që ka mbetur, e që qenkësh poezia: “*është fryma, është shpirti...*”

Rudolf Marku u shfaq në botën e poezisë në vitin e largët 1973. E prej atij viti poezia dhe poeti u bënë një binon i shpallur dhe i pandryshueshëm. Edhe pse nuk ndodh gjithnjë kështu, në rastin e Rudolf Markut edhe proza do të vinte. Por nuk do të ishte një breg që do t’i impononte shkëputje nga bregu poetik. Ai thjesht do të hidhte një urë ku do të endej sa nga një breg në tjetrin, sa nga proza te poezia. Kësaj here qëndroi te poezia, te RRATHË TË BRENDASHKRUAR, te rrathë të shumtë brenda një tjetër rrethi më të madh, si rrathët që hapen në një sipërfaqe uji ku në vend të një guri, poeti ka lëshuar një fjalë (jo një fjalë të thjeshtë), një imazh, një emocion, një mendim poetik, një kumt filozofik. Ka lëshuar shpirtin e tij, shndërruar në poezi.

“EMBLEMA E DIKURSHME” E KADARESË, SI M’U DUK PAS 44 VITESH

Nga Fatbardh Amursi (Rustemi)

Si të gjithë ata që bënë krijimtari të sgabuar, i erdhi radha dhe Kadaresë, të dërgohet në kooperativën “Agimi” për të njohur “realitetin e mrekullueshëm socialist”, i cili gjendej kantierëve dhe arave. Masa ndëshkimore, dikujt mund t’i duket si leje krijuese, gjë që ne e prisnim me gëzim. I larguar nga Tirana pa të drejtë botimi, deputetit Kadare, nuk i lejohej të banonte në qytetin, ku e kishin zgjedhur deri në një urdhër të dytë, kur sa e sa i largonin nga Tirana me pretekstin e “qarkullimit të kuadrit”, duke mos bërë përjashtim as ata të Bllokut. Atëherë ku qendron padrejtësia ndaj shkrimtarit? Mos vallë intelektualisti Kadare e bën të madhe shkruarjen në fshat, ngaqë iu prish rehati, ndërkohë që po atë viti, 1976, shkruan poezinë “Lulemollët” me vargje si këto: “Mbledhin buzët me siguri ish-zotërinjtë:/Uh, ç’lajme pa lezet “me fshat”.../“Pështyj mbi sensacionet e përtej detit,/Mbi “yjet” dhe “superyjtë” e gjithë ç’janë”/Të gjithë ata bashkë dinjitetin./E një are me grurë s’e kanë!” Në të gjithë universin e krijimtarisë së Kadaresë, do u ndodh që: poeti i angazhuar me raste të vërë në pozitë të vështirë shkrimtarin heretik. Ndaj kundërshtarët kanë shkruar autobiografinë e tij në vargje, sikurse ia kërkojnë rrënjët nëpër vargëzime për partinë, udhëheqësin, socializmin. Njësoj si të nisesh nga armëpushimet midis palëve në luftë dhe të thuash, që s’pati betejë?! Afërmendsh që, ish-borgjezët, të mblidhnin buzët për lajmet me fshat, por pse autori u kundërvihet, kur, ai vetë, është i pakënaqur me përdhunën e vidhisjes baltrave të Myzeqesë? Të pështysh mbi sensacionet e borgjezisë, apo mbi “yjet” dhe “superyjet” ha të diskutuar, pasi nuk është e vështirë të kuptosh konçensionin që shkrimtari është i detyruar t’i bëjë regjimit, nëse llogarisim sulmet e kritizerëve, të cilët suksesin në Perëndim e shoqëronin me akuzën se Kadare shkruante për lexuesin e huaj, i përshtatej shijeve të borgjezisë. Me vetëdijën se i përgohej gjithçka, i duhej të jepte shembuj distancimi, ku nuk mungon dhe ekuivoku. Përmendja e “yjeve” dhe “superyjeve” ashtu në tym, pa e specifikuar: p.sh “Yjet e Hollivudit” apo emra vipash, i shërbejnë autorit për të neutralizuar insinuatën me qitje të largët, sikurse iu bë hapur në një konferencë talentesh të reja në Durrës: “Ne një yll kemi, ajo është partia.”, kështu që të mos gënjej mendja se ti je një star, që mund të rivalizosh me yllësinë e udhëheqësit. Ky horoskop me lëvizje yjesh, nuk kishte të bënte me vallen e yjeve të Lasgushit, por një kalkulum si e si të ekspozohesh përballë Babazotit, i cili lavdinë nuk e ndante me askënd.

Në një rast të ngjashëm për njohje jete, 23 vjeçari Lubonja shkon në Laç, aty ku ndërtohej uzina e superfosfatit dhe befas, sikur me qenë në kishën e Shna Ndout, i ndodh iluminimi, i thërret mendjes apo i hapen sytë dhe, kupton se Kadare me poemën “Ëndërr industriale”, i frymëzuar nga ndërtimi i uzinës në fjalë, paskish mashtruar Fatosin dhe shqiptarët bashkë, pavarësisht se i jati i tij u shplante trutë shqiptarëve si drejtor i RTVSH-ës. Siç dihet, si ai i iniciativës revolucionare që angazhohej dhe tjetri i masës ndëshkimore,

që dëbohej, njëri me hir dhe tjetri me pa hir: vuajtjen e kishin njësoj, por, të parit, ajo i njihej si sakrificë, ndërsa të dytit, si mundësi për katarsis, reflektim, brumosje ideologjike dhe në fund happy end: një libër të frymëzuar nga realiteti socialist, sikurse me romanin “Dasma”. Në një shoqëri të përlulur nuk ishte njësoj, si të dilje nga rreshti, si i tjetërlojit dhe, të të nxirrnin nga rreshti në luftën brenda llojit. Helena në librin “Kohë e pamjaftueshme”, përmend një episod, që i jep shtysë arsytimit tonë: “Një ditë më pyeti nëse më kujtohej se ku mund të ishin disa shënime të tij të një udhëtimi që kishim bërë së bashku dikur në disa fshatra të Myzeqesë, menjëherë pas martesës sonë... Më kujtoheshin

me dhimbje të tmerrshme koke, por ai i shmangte ilaçet, ngaqë ndruhej se mos ato i mpinin ndjesitë. Kjo është e vetmja vuajtje që i njihet shkrimtarit, të tjerat jetohej si fatkeqësi dhe mjerë kujt i ndodh. “Nuk pranonte që letërsia (ajo e vërteta) të trajtohej si viktimë para diktaturës. I dukej fyerje për të.”-shkruan Helena Kadare në librin e saj autobiografik. Sepse, fajet e metodës së realizmit socialist, nuk u kthyen në fajsi për shkrimtarin që bëri fagmë në botë. Nëse të tjerët qahen nga metoda e realizmit socialist, që s’i la të bëhen të mëdhenj, Kadare ia doli, duke u akuzuar shpesh se nuk i respektonte parimet e saj, ndërsa sot i përmendin indoktrinimin. Kur shkrimtari ia heq të drejtën vetes të ankohet nga pozita e viktimës, ti tregohesh hileqar, duke e përfshirë tek shërbëtorët e regjimit, nisur nga mungesa e disidencës, që së pari është përgjegjësi e shoqërisë. Disidenti nuk është edhe i vetmi trim në luftë. Ai shfaqet në vende ku ka korifej të artit, sikurse njihet Rusia. Cari s’kishte ç’ti bënte Tolstoit, por Tolstoi ia tundëte fronin. “Shkrimtari do ose nuk do, është detyrimisht një tjetër. Shqisa e dëgjimit të tij ka tjetër ndërtim, kështu që kur ajo shqisë kap më mirë fëshfërimin e barit, se sa zhurmën e një lufte që ndodh pak më

turmës, e cila barazinë sociale e reflektonte në rrafshimin e vlerave. Por, Kadare s’ishte si shokët, e mjaftueshme kjo, që kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve ta diferenconte prapësisht: “Ai s’ka shokë”. “Ti s’ke shokë!”-të thuhet sa herë, kur shokët duan të mveshin një faj. Pse t’i mungonin shokët, kur në shtëpinë e Kadaresë, tashmë muze, ishim mysafirë të gjithë? “Ti e di se sa e hapur ka qenë banesa ime. Vinin me dhjetëra njerëz, midis tyre dhe shkrimtarë të rinj. Pinin kafe në sallon, kuvendonin, nganjëherë unë shkoja të pushoja në dhomën e gjumit dhe kur kthehesha i gjeja prapë atje, duke pirë kafënë e dytë a duke polimizuar si në kafene. Nganjëherë rrinin për drekë. Shumica ishin njerëz të mrekullueshëm, por disa ishin të pabesë. Jashtëzakonisht të pabesë.”-i thotë Ismaili Maks Velos, i cili e përmend këtë bisedë në librin e tij “Zhdukja e pashallarëve të kuq të Kadaresë”. Aftësia për të kapur fëshfërimin e barit, mund të injoronte zhurmën e luftës, por kurrësesi Qafë Barin, që, i shfaqej shkrimtarit në horizont, sikurse burgu në kalanë e Gjirokastrës, por që për 17 vjet me radhë qe “shtëpia pa qera” e Lubonjës. Pikërisht kjo e bën të dhimbshme polemikën e ish miqëve, ku njëri ishte i liruar me kusht dhe tjetri i burgosur. Kadare

Ismail Kadare në kooperativën bujqësore “Agimi”, Seman, 1975



“Agimi” ende fshatrat: Seman, Ndërnënas... Hotelet e vogla e të varfëra ku kishim kaluar gëzueshëm. Pikërisht në ato anë ai kishte shkruar për “të jetuar pranë popullit”. Do të shkruaj diçka, tha. Ato shënime më duhen. Edhe ti, më kujtohet se kishe një fletore dhe diçka shkruaje gjatë udhëtimit. Zemra më bëri “krak”. Kuptohej se ai po bëhej gati të shkruante diçka, ndryshe nga më parë. Pra, do të shkruante ashtu si duhej. Fjala ishte për “Emblemën e dikurshme”,-së cilës, Lubonja i kishte hedhur një sy pas 44 vitesh, para se të shkonte në emisionin e Sokol Ballës TopStory dhe e vetmja gjë, që i qe fiksuar: përmendja e sabotatorëve të naftës, duke shtuar kështu shembujt e implikimit të Kadaresë me regjimin, i cili me kulturën e manipulim simulimit, në fillim paska gënjyer shqiptarët, ndërsa tani po mashtroka të huajtë?! (Aq e cekur është përmendja e sabotatorëve në novelë, sa të bësh me faj shkrimtarin e Maqedonisë së Veriut, Kim Mehmeti pse ka të njëjtin emër me Kim Jongun e Koresë së Veriut?!) Niçe, kur shkruante poemën filozofike “Kështu foli Zarathustra”, qëllonte të ishte

tej, nuk duhet qortuar para kohe. Pas një mijë vjetësh, (e ai është gjithmonë i gjallë e përgjigjet për të), ajo fëshfërim bari mund të jetë më e fuqishme, më e kuptimshme, (Është fjala për dinjitetin e arës me grurë. F.R) dhe të ketë arsyen e të qenit më e fortë se katastrofa që ndodhi aty pranë. E njëjta gjë mund të thuhet dhe për sytë e shkrimtarit, që herë janë më tejshikues se thjerrëzat e Galileut, e dallojnë tmerre e mrekullira, që asnjë sy njerëzor s’i ka parë, e herë janë më të verbër se vështrimi i rapsodëve. Por shpesh ndodh që njerëzit që janë rrotull shkrimtarit nuk duan t’ia dinë për këtë. Ata nervozohen, përpiqen t’i mbushin mendjen shkrimtarit se ai është si ata, se ka të njëjtët veshë, të ngjëjtët sy, e padyshim të njëjtin tru. Ti je si ne, kot përpiqesh të hiqesh si fantazmë, ndaj eja midis nesh, ulu, përlulu!”-rrëfëhet Kadare në librin “Ftesë në studio” i botuar në vitin 1990, ende pa u rrëzuar diktatura. Thirrjet: “Eja midis nesh, ulu, përlulu”, pra, eja në mesin e mediokërve, përlulu para realizmit socialist, ku partia diktonte: “Aty me shokët!”, dëshmojnë pritshmëritë e

nuk ka nevojë për mbrojtjen e askujt, timen po e po, ndërsa publiku ka nevojë për të gjithë ne, për të ditur të vërtetën. Dikur na quanin “ismailjan” tani “lakej të Kadaresë”, pikërisht këta që u dhimbsen monumentet e kulturës, kujtesa historike?!

Pyesim: si është e mundur që, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kështjella”, “Pashallarët e kuq”, “Dimri i madh”, “Koncert në fund të dimrit”, etj. kritikoheshin dje nga paranojakët dhe sot prej mitomanëve? Në librat e shenjtë dhe në kodin penal thuhet se për të njëjtin faj: nuk mund të dënohesh dy herë. “Ndryshimi është se dje e bënë kallzimin fshehtazi, tashti e bëjnë haptazi. Dje e akuzoni viktimën si “idhtar i Perëndimit”, tani e fajësojnë si “besnik të komunizmit.”-ka reaguar heretiku, Kadare. Shkëlqimi i një shkrimtari të famshëm i ngjan pasqyrës, e cila i thith vetëtimat, që dikur i hidhte Zuesi paranojak, ndërsa tani janë mitomanët përngjashëm me topat mbretëror, që heshtën atëherë kur duhej të gjëmonin, në tentativë për ta thyer pasqyrën, duke rikthyer kohën e “Qorrfermanit”. (Në një

qorroface thirret poeti i shquar Tahsin Kurtogllu (Kadare), që të jepte shpjegime për vargjet: “më vrau harku, jo shigjeta”. Poeti mbrohet duke thënë se ajo ishte një vjershë dashurie, kushtuar së shoqes, ku harku i vetullës e godiste në shpirt më shumë nga sytë e saj. “Të gjitha këto janë shpifje dhe trillime të rivalëve të mi.”-deklaron poeti para turmës, që e zemëruar thërriste: ai meriton tibetianen. (“Ai Qorri” e thërrisnin socrealistët, duke e përkuar enkas me pseudonimin e Anastas Lulos, i vrarë me urdhër të Enver Hoxhës. Novela “Qorrferman” u botua në vitin 1984, një vit para vdekjes së diktatorit.) Komisioni Qendror, hashiqare Komiteti Qendror, e dëgjonte me fytyrat plot mosbesim, fjalët me dy kuptime të poetit. Tibetania ishte verbimi më mizor, por, njëri nga zyrtarët ia bën me shenjë turmës të qetësohet dhe me një fjalim të shkurtër, duke vënë në dukje zemërgjerësinë e shtetit, i cili mjaftohet këtë radhë vetëm me një qortim, një shenjë në kartën e regjistrimit, zbritje në fshat, si paralajmërimi i fundit për poetin.) Galileun nuk e çuan në turrën e druve, por e shëtitën në galerinë e veglave të torturave duke i treguar me imtësi torturimin që shkaktonin ato, pavarësisht se Papa qëlloi të ishte shok i Galileut. Në një mbledhje autodafe, ku shkrimtari kishte çuar nëpër mend të hidhej nga dritarja më e afërt e Komitetit Qendror, bën këtë autokritikë sugjestionuese: “Për librin me vjersha “Shekulli im” u kritikova për konfuzion ideor, për influenca të bagazhit kulturor borgjez e sidomos të atij revizionist. Ndikimet gjenin të çara për të depërtuar tek unë. Kjo u duk në variantin e parë të romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”. Ky roman kishte një defekt themelor në qendër të tij. Figura e gjeneralit të huaj ishte konceptuar gabim ideologjikisht. Kjo bënte që gjithçka të mirë që kishte ky roman, të eliminohej nga ky defekt... Nëse unë e bëra gjeneralin të njerëzishëm, a mund t’më thotë kush se unë simpatizoj fashistët italianë? Unë nuk iu modifikova shijeve të borgjezisë. Dikush mund t’më thotë me plotë të drejtë se dhe nëse doje, nuk do të linte kush. Por modifikimi mund të ishte jo i drejtpërdrejtë, por i tërthortë... Arma dhe kur shkreh pa dashje, të vretë.” Në të gjitha kritikën, që i janë bërë Kadaresë, askush nuk ka folur aq keq për të se sa ai vetë për veten e tij. Me sa duket persekutorët e morën kënaqësinë e të deklaruarit fajtor të vetes, ky jam bëni ç’të doni, kur nëpër hetuesira hiqnin dreqin për ta detyruar viktimën të pranonte fajsinë. Por, pse nuk e çuan deri në fund ndëshkimin me burg të shkrimtarit? Përgjigjen e marrim tek novela “Emblema e dikurshme”, që pas 44 vjetësh iu riktheva edhe unë, me qëllimin e vetëm, për të qenë i drejtë me Lubonjën, mbase, kushedi, na kanë dalë nga kujtesa pasazhe, subjekte, personazhe, që e prezantojnë keq shkrimtarin në përballje me të sotmen. Të gjykosh një shkrim pas afro gjysmë shekulli, ke rrokur pozitën e së ardhmes, meqë shpesh i lihet kohë kohës, për të qenë gjykatsja më e mirë. Nga e njëjta lartësi, pse shohim gjëra të kundërta? Përgjigjen e marrim tek ambiguiteti, përngjashëm me shprehjen: “E zuri qymyri”, që diksh e kupton si rënie në dashuri dhe tjetri si asfiksion.

Kur, Enver Hoxha, botonte libra për ushtrinë, përligjte të qenit strateg, kur ai shkroi një libër të veçantë për naftën, po pretendonte të qenit ekspert. Tek librat me kujtime po mbahej për shkrimtar. Meqë i kishte dalë nami si largpamës, ai dhe s’ka më, përkundër sabotatorëve që i dënoi për fshehje të vendburimeve të naftës, merr situatën në dorë me sinopse dhe kalkulimeve, si Kepleri në kohët që zbuloi yllin në bazë të llogarive matematikore, u përhapën fjalë se udhëheqësi kishte

parashikuar se në zonën e Myzeqesë kishte burime naftë dhe, që t’i dilte fjala: nisën shpim-kërkimet intensive në thellësira të mëdha. Zbarkimi i një grupi gjeologësh në fshat, përkon me mbërritjen e shkrimtarit, shqisat e të cilit: veshi dhe syri, nuk janë si i të tjerëve përreth, duke përfshirë dhe largpamësin. Ndaj personazhi i tij kryesor, Bardhyl Krasta, më shumë se një gjeolog përngjan me një investigator. Një rrethanë ideale për mjeshttrin e ambiguitetit, që pas sabotatorëve të fshihte kontestatorin. Lexuesi nuk sheh gjëkund një pus naftë, por një famulli, e shpallur monument kulture, që ruhej nga shteti ateist. Pikërisht këtu ndahemi me Lubonjën, meqë e rilexuat novelën pas afro gjysmëshekulli, secili për hesap të vetë. Ai e merr Krastën për gjeolog, ndërsa unë e marr Bardhylin për shkrimtar. Ai sheh sabotatorë, unë shoh kontestatorin, si personazh i dukshëm dhe i padukshëm i Kadaresë në të gjithë krijimtarinë e tij, kujtoni kapitenin Stres tek “Kush e solli Doruntinën”. (Emri Bardhyl është i preferuar për Kadarenë, sikurse quhet dhe personazhi i romanit “Mjegullat e Tiranës”, duke patur parasysh veten e tij, duke mos më penguar dhe mua, të shoh veten time, për aq sa më takon. Mos do më qortoni për konflikt interesi?!) Personazhja e novelës, Ana, mësuese, 23 vjeçare, me të cilën mburrej i gjithë fshati, përfshi dhe shoqet e saj, bie në dashuri me Bardhylin, një burrë i divorcuar ky, i cili nga martesë e parë kishte dhe një vajzë. Për kohën tema e divorcit ishte tabu, që shkrimtarit do t’i hapte aq shumë telashe në romanin “Dimri i madh”, në ndarjen e Besnikut me Zanën. (Nëse do shpreheshim me një gjuhë të rëndomtë: gjeologu shkon për naftë dhe gjen grua, ku ideja e shpim-kërkimit mund të lërë shkas dhe për vulgarizim.) “Kozmai, i shtëpisë së kulturës, i sapokthyer nga qyteti me makinën e kryetarit të kooperativës, u kishte treguar vajzave, se e kishte parë Anën tek ecte përqaftuar ndanë xhades me njerin prej gjeologëve. Ai e përfundoi të folurën, duke thënë pa pritur, gati me psherëtimë: -Ra dhe Ana.” Meqë rënia në dashuri po perceptohej si rrëzim personaliteti, ia behin autoritetet për të stabilizuar situatën. Nuk mund të mos bëjë përshtypje, tërheqja e sekretarit të partisë, i cili ia ngarkon si detyrë kryetarit të kooperativës, të këshillonte Anën. “Po ti, ti je ndryshe, Ana! Ne me ty, siç e thashë në fillim...mburreshim, të nxirrnim në presidiume.”-janë fjalët e kryetari baballëk. Ana po shihej me sy tjetër, sikur kishte

shkarë nga ana morale, duke shkelur në nderin e presidiumeve. Që të ishte në rregull: mos duhej të merrte traktoristin dhe jo gjeologun e divorcuar? “-Mos vallë po të dalësh në presidiume, duhet të heqësh dorë nga dashuria?” Një përgjigje si kjo të hapte telashe, por Ana e thotë me gojën plot, ndonëse kusuret mund të ishin për autorin. Autoritet dukeshin si të ngopura nga dashuria për partinë dhe çdo dashuri tjetër: shihej me skepticizëm. “-Jo, xhanëm s’them ashtu, se ja Sofika e Vasil Kronit u shqep duke dalë në tabela nderi e në radio e në raporte dhe para dy javësh na u martua me dashuri. S’them ashtu, por, sidoqoftë ti je ndryshe, Ana.” Një vajzë e dashuruar po shihej nga opinioni zyrtar, sikur po mëkatonte. Fundja: çështje të privatisisë, pse duheshin bërë muhabetë zyresh? Gjë që shkaktonte irritim tek lexuesi. Irritohu këtu, irritohu atje, a nuk futeshin xixat duke ushqyer kundërshtinë? Sipas autorit, fshati ku Ana jepte mësim, ishte nga më të prapambeturit e Shqipërisë, ndonëse i përkiste zonës më të begatë, Myzeqesë. Lavatriçja e parë mbërrin aty pas 30 vjetësh socializëm. “Bardhyl Krasta shikonte se si fshatarët i vinin rrotull makinës larëse, e vërenin me butësi, dhe buzëqeshjet e tyre pasqyroheshin paksa të ndryshuara mbi sipërfaqen e emaluar të saj.” Siç shihet, veshi dhe syri i shkrimtarit në syrgjynin për njohjen e jetës, sheh gjëra të zararit: llucë, pellgje, qerre dhe pleq të moçëm. Ky na qënkish fshati socialist?! Plaka 120 vjeçare, Patra Baltaj, dëshmon duke hedhur dritë në zbulimin e një krimi të vjetër: “Mos më lini të gënjej, se jam plakë, s’kam kohë të ndreq shpirtin. Arra është plakë, shumë plakë... Dhe atë që sheh arra e mban mend më mirë se njeriu.” Nisur nga aftësia që ka arra, e cila fotografon peisazhin që ka përpara, ndryshe nga aparati fotografik, që zgjat një pjesë të sekondës, shkrepja e drurit të arrës ndodh për 30 apo 40 vjet, shkrimtari me gjuhë ambiguitive kërcënon indirekt se krimet e fshehura, do të vijë një ditë që do të zbulohen. Afati prej 30 apo 40 vitesh përkon me ardhjen e demokracisë.

Gjeologu Bardhyl Krasta shfaq interes për: mësuese Anën dhe famullinë, ndërsa për naftën flitet: “Në ekranet e TV-ve, rrugët e Romës dhe të Amsterdemit të shkretuar nga makinat. Mbreti Fajzall i Arabisë Saudite, një nga kryevendet e naftës, qe vrarë aksidentalisht nga nipi i tij i çmendur. Ndërsa lexonin lajmin, spikerët dukeshin sikur thoshin: duhet të jeni tepër budallenj ta besonin këtë aksident. Fytyra e sulltanit të vdekur, në ekranet e TV-ve

dukej e frikshme.” (Vetëm TVSH kishim në monizëm, pse në shumë: ekranet e TV-ve? Mos po dekonspiron veten se ndiqte stacionet e huaja?) Nëse andej vritej sulltani tek ne ishte sulltani, që vriste të të tjerët. Në një realitet kriminal, Bardhyl Krasta, vihet në kërkim të zbulimit të një krimi të vjetër, kur detyra e tij ishte të zbulonte naftën, sipas porosive të udhëheqjes. “Sabotatorët mbronin mendimin e vjetër të specialistëve të huaj që naftë s’ka. Tani duhej vërtetuar e kundërta.”-shkruan autori duke i dhënë material Lubonjës, ta regjistrojë si fakt, sikurse më jep të dhëna për ta mbrojtur. Autori i bën naftën naftës, pasi gjeologu Krasta i qepet famullisë së fshatit, kurjos të zbulonte krimin e vjetër. “-Siç e shikoni, kërkoja të dhëna për naftën dhe ndesha në luftën e klasave,-tha ai. Ajo tundi kokën në shenjë pohimi. -Ajo është kudo, dhe asgjë s’mund të jetë jashtë asaj. As nafta.” Por, krimi i vjetër që gjeologu investigator kërkon të zbulojë s’ka të bëjë me luftën e klasave, pasi ngjarja ka ndodhur më 29 tetor 1943 në kohën e luftës Nacional-Çlirimtare. “Terrorit të bardhë të bandave të Isa Toskës dhe të Xheladin beut njësitet guerile i përgjigjeshin me terror të kuq.”-shkruan autori, duke vënë shenjën e barazimit midis ballistëve dhe komunistëve, ku të dyja palët si armë friksimi përdorin terrorin.

Në famullin e vjetër, Bardhyl Krasta, zbulon një bareliev të qëmotshtëm, sipas pleqëve të fshatit, i dëmtuar dhe i vjedhur nga “Kapuçonët e zinjë”. “Përse duhet t’u interesonte vrasësve zhdukja e emblemeve të Muzakajve, me kufijet etnikë të vetë Shqipërisë? Një embleme vetvetiu ka lidhje me të gjitha këto. Me asgjësimin e saj ata donin të zhduknin një dëshmi. Një dëshmi tepër të rëndësishme. Pra, ata donin të bënin një përçudnim në histori.”-arsyeton investigatori. Kush janë të interesuar për zhdukjen e një embleme, si e Muzakajve, mund të shtoni dhe të Kastriotëve, goftë dhe të emblematikut Kadare, sikurse ishin zhdukur familjet e mëdha në diktaturë? “Mbetet çështje e kufijve etnikë,-vazhdoi të fliste ai.-Emblemat shpesh kanë lidhje me to.” Ballist Morina besoj se është i një mendje me Bardhyl Krastën. Në kohën kur shiten ikonat, vjedhja e një embleme, thua të jetë një objekt trafikantësh? “Ata nuk donin të linin kujtesë për të. Donin që gjithçka të harrohej, të harrohej.”-tek “ata” duhen futur dhe “këta”. Po me pusin e naftës ç’bëhet, o gjeolog?! “Ky është një krim apo aksion, quaje si të duash, që dilte jashtë stilit të kohës. Nuk di si ta shpjegoj, por unë

(Vijon në faqen 8)



(Vijon nga faqja 7)

e ndjej se pikërisht kjo gjë tregon se krimi kapërcente mbi kohërat, mbi gjendjen politike të çastit, administradën, qeveritë.”-vazhdon të hulumtojë gjeologu i kthyer në investigator. Më në fund i vjen radha dhe naftës: “Emblema e Muzakajve është një nga dëshmitë e rralla, në mos e vetmja, që vërtetonte burimet e naftës në këtë zonë.” Një fakt ky që duhet ta ketë ditur dhe i kënduari Faik Konica, sikurse e dëshmon dhe Julian Amery në librin “Bijtë e shqipes”: “Në njërën nga konferencat e shumta ndërkombëtare, që u mbajtën pas Luftës së Parë Botërore, Shqipëria ishte përfaqësuar nga Faik bej Konica, një njeri mendjehollë dhe shumë i shquar. Faik beut i duhej siguruar përkrahja britanike në lidhje me kërkesat e vendit të tij dhe, pas shumë përpjekjeve të pasuksesshme, iu afrua më në fund, jo pa hezitim një bashkëbisedim me Lordin Kërzon. Kërzon e priti Faikun duke qenë i ulur dhe në mënyrë të ftohtë, kërkoi që të mos zgjatej në ekspozenë e tij. Delegati shqiptar bëri një referencë dhe ia nisi: “Shkëlqesë, në Shqipëri ka vajguri.” Sytë e Kërzonit filluan të shkëlqejnë: “Uluni, i dashur mik!”-i tha duke u ngritur përnjëherësh dhe për çudinë e sekretarëve të padurueshëm, biseda u zgjat më tepër se një orë.” Kjo është arsyeja që konsulli anglez Eden u tregua shumë aktiv në mbajtjen e Kongresit të Lushnjës, i cili binte më shumë era naftë se sa barut. Nëse doni ta aktualizoni edhe më, shihni tensionet midis Turqisë dhe Greqisë, sikurse marrëveshja e detit me Greqinë, e cila ka rikthyer tek ne historinë e tradhtarëve. Emblema e Muzakajve, sikur të jetë një hartë gjeologjike shenjon dhe burimet e naftës, të cilat nuk duhen kërkuar në pllakatet apo sinopset e diktatorit.

Pra, hetimet në famulli nuk ngjasojnë me hetimet në Pallatin e Ëndrrave. A nuk të krijohet ideja e një kundërvënie? “Kapuçonët e zinjë”, vrasësit e rojes së famullisë, një kosovar ky, shkatërrojnë emblemen, si dëshmi e burimeve të naftës, përngjashëm me një vjedhje projekti, së cilës shkrimtari i jap përmasat e një komploti konspirativ botëror. Një aludim i tillë, në një kohë kur dënoheshin sabotatorët e naftës, ishte si t’i shfaqsoje ata, pasi rrënjët e së keqes globalizoheshin. “Ata janë më të përgjithshëm se shtetet dhe administratat. Teknokratë, kozmopolitë, agjentë të shoqërive anonime ndërkombëtare.”-shkruan autori, duke injoruar siglat e partisë, distiktivët e udhëheqësit, ku rëndësi të dorës së parë merr emblema.

Për të përforcuar idenë e shkatërrimit të emblemes prej “forcave të errëta”, në novelë flitet dhe për shkatërrimin e titujve të pronësisë e të sinoreve. Krahaz “kapuçonëve të zinjë” shfaqet dhe personazhi enigmatik, Veniamin Papa, me profesion topograf, i cili vihet në shërbim të shpronsuarëve duke piketuar kufijtë e vjetër të pronave, me mjete rrethanore, në fshehtësi të plotë. “Nis, ndoshta për herë të parë në rruzullin tokësor, një punë që s’kishte as traditë, madje as emër, në asnjë gjuhë të botës”, i cili në shishe të fshehura thellë, shenjonte tokat e të shpronsuarëve, ngaqë: “Ish-pronarët shpresonin se do të vinte një ditë se ato shenja do ta lëkundnin tokën si një çarçaf të madh. Dhe do të rrokulliseshin dhe do të shkundeshin prej saj gjithë këto ferma e kooperativa, me rrugët dhe shtëpitë e tyre, me kryesitë dhe pllakatet e ngjitura mureve, me shtëpinë e kulturës, antenat e TV-ve, pambukun, makinat shirëse, festivalet e amatorëve... Sepse ata kishin shpresa se do të vinte një ditë që çifliqet

do t’i merrnin përsëri.” Ta thoshe këtë, në një kohë kur nuk njiheshin titujt e pronësisë, kur ikonat ishin zëvendësuar me distiktivët, si të kërkoje belanë me zor.

Sulmet ndaj figurave emblematike justifikohen prej mitomanëve me gjoja çmitizimin apo dekomunistizimin. Në fakt, çmitizimi ishte një aksion politik i kohës së diktaturës, ndërkohë që Enver Hoxha fetishizohej, duke u krijuar miti se Enveri i njihje njerëzit nga sytë, bile deklarohet se një nga puçistët e byrosë e kishte zbuluar pikërisht nga sytë. Helena në librin e saj “Kohë e pamjaftueshme”, shkruan: “Qarkullonte mendimi se E. Hoxha ishte si ndonjë magjisttar që kur t’i ngulte sytë e kuptonte se ç’kishe ti në kokën tënde. Njerëzit e thoshin këtë në mënyrë të ndryshme: me admirim ose me ironi të fshehtë. Shumë kohë më parë Drago Siliqi ia kishte thënë shprehimisht Ismailit një gjë të tillë. “I vetmi që kam frikë të takoj është E. Hoxha, ngaqë jam i sigurt se do t’më kuptojë se ç’kam në kokë.” Në novelën “Emblema e dikurshme” Kadare shkruan: “Thonë se njerëzit njihen nga sytë...Jo, or bir, jo! Dëgjomë mua ti, më mirë se libri, apo syri, apo veshi, njerëzit i njeh kjo këtu,-dhe plaku i ra me dorë qafës së tij!-S’ka si qafa, or bir!” Qafa është vendi ku vihet zgjedha. Burgu i Qafë Barit. “Nganjëherë populli ka ca vegla të pagabueshme si ajo: qafa e Hill Mingës.”, i cili kishte punuar si hamall në skelën primitive të kënetës. Mjafton emblema e Muzakajve ku pasqyrohen burime naftë, që libri i udhëheqësit për naftën të dalë skarco, sikurse mjafton qafa e Hill Mingës, që sytë e udhëheqësit, të jenë të përshtatshëm për “Qorrfermanin”. Po pusi i naftës ku është, o gjeolog? Me sa duket u është lënë mitomanëve ta zbulojnë.

VËSHTRIM PERIFERIK MBI ROMANIN “MARRJA E GJAKUT” TË ANDREAS DUSHIT

Prof. dr. Alfred Çapaliku

Romani sintezë i Andreas Dushit “**Marrja e gjakut**” e ka origjinën te “Krye i nandëmbdhetët - Gjaku e gjinija, vllaznimi e kumbarija në Kanù të Malevet” të Kanunit të Lekë Dukagjinit, por në mënyrën sesi është konceptuar dhe në sumusin e tij strukturon një sistem paradoksal akohor. Prindi i varur në litar sa paraqitet vetëvrasës depresiv, aq del i vrarë nga presioni real i të tjerëve, gjë që zbulohet në letrën personale dëshmuese të krimit:

“*Kam frikë nga ju!*”
(Faqe 12).
Ky është boshti ku mbështetet konstrukti i librit apo aksi ku xhiron shfletimi i tij.

Në shtjellën marramendëse të letërsisë me format postmodern Dushi Andreas shprish rrënjët e arketipit primitiv duke mos ndjekur ndonjë model paraardhës. Artefakti i prozatorit Andreas Dushi është shkrimi çlirues gjysmëautomatik, që me anë të gjuhës së veprimit përdor sekuenca monologësh e dialogësh, si në ato të një skenari kinematografik.

Poetika e veprës valëzon vazhdimisht duke paraqitur një frakturë heronjsh, që gjatë lakores së trillerit rezultojnë pseudoheroikë. Përndryshe parakalojnë frymorë kryeneçë me komplekse metafizike, të cilët e durojnë skajshëm njëri - tjetrin:

I. Vrasësi problematik i vetes, nga shkaku i të tjerëve - Voci.

II. Vëllai i tij mjaft intrigues dhe tepër çorientues - Vilzani.

III . Gruaja me bukuri të huaj e të ndjerit - Leticia.

IV. - V. - VI. - VII. Djemtë e fatiut: - Laloshi, - Leci, - Leka, - Lulashi, që duhet të marrin gjakun e të vdekurit tek njëri prej tyre, bir legjitim.

VIII. - Rapsodi i Shquar që këndon fatalitetin, përherë me mënyrën e tij monotone, në falset.

IX. – Figurantët rastësorë, ndividët pa identitet, që qarkullojnë para dhe pas duke shërbyer thjesht për mbajtjen e temporitmit të ngjarjes.

Personazhet e fragmentuara inkuadrohen në këndin

prej nëntëdhjetë gradësh të dopioshikimit, mbasi në çdo episod vrojtojnë të tjerët, pikërisht në çastin kur të tjerët janë duke i kundruar në aspekte minucioze.

Por në dekorin e tendosur, që shpaloset nga Mali me Tym deri në Qytetin Mijëravjeçar, ky grup figurash në kalim nuk i mjafton krijuesit Andreas Dushi për shtrirjen e plotë të pëlhurës bardhezi të bëmës, e cila si fund ka fillimin. Për të thurur tridhjetë minikapitujt e teksturës së avancuar i duhet dhe një individualitet pa profil e pa moshë.

X. - Lexuesi i marrë me mend, qoftë si pjesëmarrës në sfondin e arealit gjeografik, qoftë si i pranishëm në spiralet psikologjike:

“*Qysh kur kam filluar të shkruaj këto çfarë di e kam dëgjuar, të kam menduar ty lexues. Gjithë çfarë jam duke bërë, të drejtohet ty dhe vetëm ty.*”
(Faqe 96).

“*Dua të them përse të drejtohem me TI. Janë dy arsye. E para është sepse ky libër që ti mban në dorë të drejtohet vetëm TY. Prandaj, nëse drejtohem me ju, duket sikur po flas me shumë njerëz, ndërkohë që ti je duke lexuar krejt i vetëm. E dyta është sepse nuk dua të krijoj ftohtësi mes nesh. Përderisa unë po të tregoj disa gjëra në të cilat sigurisht jam edhe pak unë, do të thotë se për mua ti je një mik. Dhe unë nuk kam dëgjuar asnjëherë biseda mes miqsh ku njëri t’i drejtohet tjetrit me ju. Dy jemi dhe ne të dy: ti dhe unë. Dy miq që na lidh përjetësisht ky libër.*”
(Faqe 98).

Ndërsa për zbërthimin artistik të nëntitullit të romanit (**metafora e parë e një absurdi shqiptar**) i duhet edhe vetja si personazh.

XI. – Autori (vetvetja fiction) i përfshirë në qerthullin e fabulës dhe në suspansën e saj, që deklarohet vetëm si rrëfyes i ngjarjes në lëvizje, duke i vështruar me dyshim sfidues profesionistët e të shkruarit:

“*Ju lutem, mos më quani shkrimtar.*”
(Faqe 126).

Shkodër, më 26. 09. 20.

ANDREAS DUSHI

Marrja e gjakut



OnufriRoman



NJËSHI

nga Stefano Massini

ligjëratë e përshtatur në shqip

nga Gëzim Puka

Si lind diktatura?! Si formohet diktatura?! Një përgjigje e mora disa ditë më parë prej një ngjarjeje të vogël në parkun afër shtëpisë. Ndërsa po shëtisja në lulishte qenin tim, vërej disa fëmijë të sapodalë nga shkolla, që po luanin në cirkun aty pranë. Një djalë i hequr mënjanë vjen të përkëdhelë dhe të luajë me qenin tim. Nisa një bisedë me të. Më thotë se quhet Marko dhe është shtatë vjeç. E pyes se pse nuk luan me shokët e klasës dhe Markoja duke më treguar rrëshqitësen e parkut, më përgjigjet më njëfarë toni paksa të zemëruar: “Jo, nuk mund të luaj, sepse aty është edhe Kevin. Është ai që vendos se si duhet të luhet...”

Më tërheq vëmendjen ky personazh, Kevin... Vështroj fëmijët dhe lojën që po zhvillohet tek rrëshqitësja, ku në fakt është një djalë, që po jep porositë e nevojshme. Vetëm ai vendos se si duhet të luhet. Loja në rrëshqitëse të bëhet në krahun e kundërt, domethënë, duhet të ngjitesh nga përpara dhe të zbresësh nga prapa. Kevin madje ruan edhe radhën se kusht duhet të ngjitet dhe kush duhet të zbresë. Ndonjërit i jep edhe vlerësimin me notë për lëvizjen e shkathët. Atëherë unë e pyes Markon: “Po ti, a i ke thënë Kevinit që rrëshqitësja nuk është e tij dhe se ti ke të drejtën të luash siç dëshiron.”

Atëherë djali i vogël shtatë vjeçar më jep një mësim të vërtetë politike. Duke shkundur kokën në shenjë ironie ndaj pyetjes sime aspak të zgjuar, më thotë: “Jo! Nuk është faji i Kevinit, por i të tjerëve...”, - dhe ikën duke vrapuar.

Ky është një leksion i vërtetë.

E shoh Kevinin me vëmendje dhe nuk dalloj asgjë të veçantë në krahasim me fëmijët e tjerë. Nuk është më i madh në moshë dhe as më i bëshëm. Jo, thjesht, ai është një nga ata që di të imponohet.

Po të tjerët?! Të tjerët, që simbolizojnë mbase secilin prej nesh, lehtësisht tërhiqen vetëm për shkak të përtesës. Po, po, prej përtesës. Kështu udhëheqësit karizmatikë lindin prej përtesës. Demokracia është diçka e mrekullueshme, por në fakt është edhe e lodhshme, sepse demokracia është sforcim. Të kesh një ide dhe ta mbrosh atë, kërkon që me dikë i cili nuk mendon si ti, duhet që të sforcohesh, që të diskutosh, qoftë edhe duke e respektuar. Kjo gjë gjithsesi kërkon një sforcim që shpesh nuk kemi dëshirë që ta bëjmë. Ndaj shpesh themi: “Po, unë po ia delegoj të gjitha Kevinit e të vendosë ai çfarë loje të bëjë, të vendosë ai se kur e kam unë radhën dhe a e kam bërë mirë apo keq.”

Ky është udhëheqësi karizmatik. Kjo është figura për të cilën ne jemi të gatshëm të lëshojmë rrugë edhe pse na kushton humbjen e shumë hapësirave tona të lirisë. Kështu ndodh që udhëheqësit karizmatikë shndërrohen më vonë në diçka tjetër, në diktatorë. Kevin nuk vendos vetëm se si të tjerët duhet të luajnë, por ai vendos të shpëtojë edhe gjithë parkun e lojërave. Më vonë për të qëndruar në drejtim Kevin duhet të shpikë edhe një armik, një armik të brendshëm. Diktatorët krijojnë një armik, sepse vetëm përmes frikës qëndrohet në këmbë.

Po si merr formë diktatura?!

Për këtë mund të japim shembullin e bashkëbisedimit të Njëshit me Zeron.

Njëshi i thotë Zeros: “Duket që ti je vërtet një hiç! Edhe unë nuk jam diçka më shumë se ti, sepse përballë Dyshit jam vetëm gjysma, përballë Treshit jam një e treta, për të mos folur pastaj për Shtatën, Tetën dhe Nëntën, që janë shumë përpara meje. Por edhe pse jam diçka më shumë se hiç, e dashur Zero, unë kam mësuar një hile. Dhe a e di se çfarë bëj?! Marr një ose disa zero si ti, i vendos prapa dhe bëhen Dhjetë, Njëqind, Një mijë edhe Një milion nëse përkushtohem...”

In Memoriam për Shpresa Vreton

DHE “SIRENA” NËNË U KTHYE NË SHKUMË DETI...

Nga Mira Meksi

Gruan shtatvogël me sy të mëdhenj plot dritë dhe energji të jashtëzakonshme, e njoha personalisht fundviteve 80’, kohës kur punoja si përkthyes letrare në shtëpinë botuese “Naim Frashëri”. Ishte si një takim i gëzuar me fëmijërinë e largët. Fati kish dashur që të ndaja zyrën me të paharruarin Odise Grillo, shkrimtarin tim të dashur të vogëlisë dhe më pas bashkëpunëtorin dhe mikun e shtrenjtë. Kur Shpresa vinte në zyrën tonë për t’u takuar me Odisenë, i cili merrej me redaktimin e librave të letërsisë për fëmijë, ajo kishte gjithmonë një buzagaz në fytyrë, pavarësisht halleve dhe mundimeve të jetës së saj, dhe gjithçka kthehej në magji: Odiseja nxirrte përherë nga sirtarët një grusht arra, ndonjë mollë dhe kish raste edhe pak verë Vunoi në gota plastike për të na gostitur, dhe niste bisedën për librat e të vegjëlvë, të cilës më pas i jepte zjarr Shpresa. Fillonte me librin që po përgatiste secili për shtyp, apo me librin në proces shkrimi dhe me librat e autorëve të tjerë. Më pas vinte shpalosja e projekteve të të dyve për të ardhmen ... Sa shumë projekte! Sa shumë ide, sa shumë personazhe përrallash parakalonin në zyrën tonë të vogël!

Andej nga fundi i shpalosjes së projekteve letrare, kur ishte folur tanimë për përshtatjen e “Historisë së Skënderbeut” të Naim Frashërit për fëmijët, për aventurat e veshkaushëve e të tjerëve, ata më ktheheshin mua. Isha, po ashtu, projekti i të dyve. Gjer atë kohë isha marrë, më së shumti, me përkthime, qoftë nga letërsia për fëmijë dhe qoftë nga letërsia për të rritur. Shkruaja edhe tregime, kisha botuar ndonjë syresh në gazetën “Drita”. Porse nxitja e tyre e njëmendtë ishte: “shkruaj letërsi për të vegjëlvë!” “Është një mënyrë e jashtëzakonshme komunikimi”, thoshte Shpresa; “Është një urë lidhëse mes të rriturive dhe fëmijëve”, vazhdonte Odiseja, “përçon vlara kulturore të jashtëzakonshme te fëmija-lexues. Por edhe arrijmë të themi të vërteta që nuk i themi dot për të rriturit” vijonte ai dinakërisht dhe me humor, duke i bërë nder emrit që mbante. “Vetëm imagjina e tyre i pranon natyrshëm tërë marrëzitë tona krijuese”, i vinte kapakun Shpresa, duke buzëqeshur si përherë. Me siguri kjo thënie e saj më nxiti të krijoja një personazh krejt të pazakontë në letërsinë shqipe për fëmijë të atyre viteve, i cili me kohë u pat vënë flakën ëndrrave të mia: Xhuxhi i detit – krijesa e jashtëzakonshme me shtatëpëllëmbë trup dhe tripëllëmbë mjekër të kaltër. Dhe rrëfenjat e tij. Ishte një përmbledhje përrallash me personazhë nga më të padëgjuarit dhe më të pabesueshmit për kohën. Nuk do kisha guxuar ta paraqisja për botim, nëse nuk do kisha mbështetjen plot dashamirësi të Shpresës dhe

Odisesë, miqtë e mi me besë, që ishin lexuesit e saj të parë. Kështu hyra në aradhen e atyre shkrimtarëve që ruanin në zemër si askush magjinë e fëmijërisë.


Viteve të lirisë së rigjetur, Shpresa Vreto u kthye në një nga misionaret e jashtëzakonshme të librit për fëmijë. Të pajisjes së fëmijëve me kulturën e leximit. Ishin vite shumë të vështira. Të vështira edhe për librin për fëmijë, të cilin ajo e kish parë të shitej kioskave së bashku me revista pornografike dhe ishte tronditur.

Me nismën e saj dhe me bashkëpunimin e një grupi shkrimtarësh, përkthyesish dhe ilustratorësh, u krijua gazeta “Sirena e vogël” dhe më vonë “Bota ime”. Më kujtohet qartazi pasdreka në shtëpinë e Shpresës në Rrugën e Kavajës, kur pagëzuam gazetën e parë për fëmijë të kohës. Unë kisha propozuar “Xinxifillua” si emër, librin e mrekullueshëm të Mitrush Kutelit dhe të parin libër që kisha lexuar vetë; pastaj “Princi i vogël”. Shpresa ishte për të shqyrtuar titujt e përrallave të klasikëve të botës: përmendëm përrallat e Grimëve, të Perraut-së, Andersenit... Për dashurinë e Andersenit fitoi “Sirena e vogël”. Albana, e bija e Shpresës dhe piktoe e talentuar, vizatoi sakaq një sirenëz të bukur të kaltër, e cila do të bëhëj logoja e gazetës. Nisën të dilnin numrat e parë. Shpresa fluturonte nga gëzimi; të gjithë kontribonim sa mundnim. U botuan shkrime për fëmijë, përkthime, krijime origjinale. “Libri dhe leximi do ta ndryshojnë botën” ishte lajtmotivi i gazetës. Më kujtohej që krijoja një rubrikën time në gazetë të titulluar “Karkanxholli i pyllit të librave”, me rrëfenja krijesash imagjinare, një pjesë të “peshkuara” në folklorin tonë. Shumë shpejt, “sirena e vogël” u bë tejet e dashur për fëmijët, një ushqim i shëndetshëm kulturor, por edhe argëtues. Në sajë të Shpresës së paepur. E kam përpara syve se si me çanta në shpinë, të mbushura deng me gazeta, ajo dhe Vasili fisnik, i shoqi që e ndihnte shumë në gjithçka, shkonin shkollë më shkollë për t’i shpërndarë. Jo vetëm në shkollat e Tiranës, edhe në ato të fshtreve, por edhe të qyteteve të tjera.

Shpresa Vreto gëlonte nga idetë avangardiste. Punonte palodhshëm. Aktivitetet që krijonte dhe realizonte për librin dhe fëmijët qenë të panumërta. Me ndihmën e UNICEF-it krijoi Bibliotekën e Përrallave për fëmijë te Pallati i Kulturës, me një fond prej disa mijëra librash, të cilën e drejtoi me shumë sukses për 12 vjet me radhë. Ishte një ambjent i mrekullueshëm, kam shkuar disa herë për t’u lexuar fëmijëve të shumtë që vinin aty, përralla nga librat e mi, apo të autorëve botërorë që kisha përkthyer. Pjesa më argëtuese ishte kur Shpresa i nxiste fëmijët të shprehnin mendimin e tyre mbi përrallën e lexuar, por edhe pritshmërinë që kishin mbi përfundimin e saj. Shpesh dëgjoja që së bashku me ta, krijonte variante të ndryshme përrallash, sipas humorit dhe dëshirës së fëmijëve.

Shpresa arriti që ta anëtarësonte Shqipërinë në IBBY, Organizata ndërkombëtare e zhvillimit të librit për fëmijë dhe të rinj, e cila kishte si qëllim kryesor krijimin e kushteve që çdo fëmijë në botë të ketë mundësi të sigurojë libra për moshën e tij me cilësi të lartë artistike. Merrte pjesë në kongreset e IBBY-t, në panairët e tij të librit ku njihej me të rejtat e botimit të librave për fëmijë dhe të rinj, siguronte libra nga fondacionet e huaja, por edhe nga shkrimtarët për shkollat dhe Bibliotekën e përrallave. Shqipëria u vlerësua me një çmim nga IBBY për “Qendrën e leximit”. Më kujtohen përpjekjet e saj që autorët shqiptarë të kandidonin për Çmimin “Andersen”, Nobelin e letërsisë për fëmijë, që i dorëzohet autorit fitues nga dora e mbretëreshës së Danimarkës.

Shumë kujtime vijnë e më mpiksen në mendje tani që Misionarja e pashembullt e librit të të vegjëlvë nuk është më. Shumë nderim ndiej për të, shumë mirënjohje. Metafizika e shuarjes, e vdekjes ma turbullon shpirtin. Porse zemra më thotë se sirenat e saj të vogla tani janë rritur, kanë hedhur shtat, kanë këmbë njeriu në vend të bishtëpeshkut dhe vijnë (kam besim të palëkundur se kudoqofshin a në çdo lloj forme qofshin), të mbjellin farën e librit dhe të leximit te fëmijët. Që bota të bëhet më e mirë. Zemra më thotë se Sirena Nënë vetëm se është shndërruar në shkumë deti për të udhëtuar e lirë oqeanëve të pafund...



Pasqyrat e kohës

poezi nga

ARBEN

PRENDI

KOHA NË TË CILËN JETOJMË

Ra shiu përsëri në tokë, me bubullima, me vetima,
si në ditën e parë të krijimit të botës.
Përzihen e kaluëmja, e ardhmja, para nesh,
nën helikat kozmike të kohës.

Disa prej stuhisë së jetës ikin rrugës pa kthim,
të tjerë dalin strehësh dhe në vorbulla hyjnë.
Gjyshat ikën, prindja largohen nën vetima,
parajsën e shkretnueme e popullojnë fëmijët.

Un’ rri në mes të shiut edhe sot turpnueshëm,
Adam i mbuluem me një gjethe fiku.
Sepse koha, koha në të cilën jetojmë,
na ktheu në palaço cirku.

Nuk e ndërtuem as na,
botën e bukur,
që andërr e panë prindja e gjyshat,
andaj rrimë në shi si qyqat.

2013

LAGJA G’JUHADOL

Shtëpi të braktisuna,
lagje e braktisun,
qen, kaq të vetmuem,
sa nuk e kërkojnë më as zotninë e vet me angullim.

Rrugica e heshtun në të tri momentet esenciale të
ekzistencës:
mëngjes, drekë, darkë.
ku s’ndihet era e voes së fërgueme me tlyen në shpi,
as zani i nanave që me kafshatë buke në dorë ndjellin
fëmitë,
sepse s’ka më fmiysh lodertare bërtimë,
që të ngasin mbas topit të kalbun të futbollit.
Veç Tingulli
i kumbonëve dhe kori i murgeshave ajrin e çan,
mija copash si qelqurinë
e tjegullat si dhambë të prishun,
në gojën e një plakët,
bien prej çatish,
tue zbulue skeletet,
e mureve të nximë,
ku harbohen shermasheku, trandafili,
hardhitë e buta dikur,
tash të egra.

G’juha i doli lagjes G’juhadol,
e u bâ shurdhmece,
sepse gjyshat kanë vdekë,
djemtë dhe nipat kanë ikë,
si në kohë të Barletit prej osmanëve
tue marrë me vete zoja e zotnij hijerandë të Shkodrës,
muzikën e violave e pianove, muzat ambla të poetëve,
mbyllë dyert antike me rrathë bronzi
e popullue lagje e rrugica të tjera të botës,
në kërkim të Tokës së Premtueme ...

2013

BIMA E EGËR

Bima e egër rritet vetiu,
e buta
mbas shumë përkujdesjesh...

2015

PASKAJ ORE!

Jeta si vdekja është punë kohe,
kohë me lindë, kohë me jetue,
kohë me vdekë,
kohë për dashuni, kohë me qeshë.
Por edhe ndryshe,
në kohën me vdekë
mundesh me lé...
në kohën me qeshë,
mund të dashunohesh...
në fund të një rruge
mund t’ia nisesh një tjetre andërr ...

Koha është pa skaj ore!
Me shikue, me kujtue, me shkue,
me kalue e me u harrue,
si mos me pasë rrue,
me kohue,
si *me kenë* i përjetshëm.

... *Problem kohe*,
të thotë si apostull edhe bariu në brigjet e Buenës,
tue kullotë ditët e tij - edha,
përmes mjegullës ku qesin shkëndija legjendat e reja
me shkëndijime legjendash të vjetra,
aty ku Drini plak e i përrallshëm,
fillon e bân dredha.

ANIJE E ANKORUEME NË PORT

Lindës

Dashunia është,
si trandafili erëmirë,
si vëna e mirë.
Koha kohon: ajo vjetërohet, ne pimë,
dehemi nga pak sistematikisht,
rrugën si dikur nuk e humbim...
ndër erëmime petalesh...

Androjmë, shikojmë dhe njohim botën,
dhe veten
përmes saj.

Dashunia, e jona
është e qetë, e ambël,
e plotë, e sigurtë,
sa ç’mund të jetë një anije e ankorueme në port,
e valëvisin dallgët fort,
po nuk e përmbysin.

Ësht si lumi pranveror,
kur i del para ndoj pengesë:
cung, gur thepokë, urë
e kapërcen me vrull
e mandej rrjedh e qetë në
shtratin e saj...

Si bima,
nuk ka nevojë për vazo,
tokën e vet – shpirtnat tonë,
ushqim ka.

Një gjethe e saj ndërrohet,
me një tjetër,
dhe me një tjetër gjethe.
Stinë mbas stine,
na erdhën lulet – vajza dhe djemtë tonë.

Kjo dashuni është e lidhun me pejzat e sprovave të jetës,
si dora e lidhun përmes gishtave natyrshëm,
që të pushton,
pa vrazhdësi,
me butësinë e dorës që nuk dridhet ma,
si herën e parë,
e sigurtë na mban,
mos me ra në ndonjë gropë
ku i gaprron sytë mëkati...

Ësht pra dashunia jonë!
Nuk i njoh sa duhet të tana trajtat e dashunisë,
por kjo e jona është,
e kësojeshme.
E heshtun,
e pabujë,
e vetëmjaftueshme,
edhe pse jetojmë në një botë,
tmerrësisht të ndryshueshme...

Janar, 2010

KUAJT MINIATURË

Bota në miniaturë
janë studentët e mi,
dhe unë dishepull i harruem
që s’më ven kush veshin.
Fytyrat e tyne pergamenë e hapun
ku parashoh të ardhmen,
ndaj më përqeshin.

Këtu është hamalli punëtor,
që tash i dhemb kryet prej mësimëve,
dhe zyrtari i ardhshëm hileqar,
që në provim rreket të kopjojë.

Shkencëtarja dhe tyrfyli rrinë në një bankë,
dhe ngajnë njësoj.

*Romeo dhe Zhuljeta, Hamleti,
I huaqi, Idioti, Don Kishoti
dhe Tre shokët, në këtë rresht,
Beatrica dhe Madam Bovari,
në bankën tjetër.*

Abeli, Pjetri, Jozefi, Sara, Madalena...
Kaini nuk ka ardhë sot...
prej tmerrit të gjykimit të provimit...

Juda nuk mungon,
në bankën e fundit,
por mbas puthjes,
ai ka me e tradhëtue prapë Mësuesin...

Dhe Mësuesi do ta falë,
për kushedi të sesatën herë,
me shpresën se
ka me ndryshue dikur...

2008

Arben Prendi lindi në Lezhë në vitin 1971. Që prej vitit 1993 është pedagog pranë Departamentit të Letërsisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, përgjegjës i të cilit është aktualisht. Ka botuar disa libra me poezi si “Vajzat nguten me u ba gra”, “Qirinj të ndezun për të gjallë”, përmbledhjen “Vepra I” si dhe disa studime: “Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia shqipe bashkëkohore”, “Tekste në kontekste” etj.

Për veprën e tij, kanë shkruar edhe disa kritikë e studiues mes të cilëve, Dr. Rafaela MARTETA, ndër të tjera thotë:

...Poezia e Arbenit krijon një atmosferë që asht e pathanshme, por ndonëse e përveçme të vjen edhe shumë familjare: ti si lexues shumë herë mund ta kapësh veten tue thanë “edhe unë”, “edhe mue”...

Ndërsa, Dr. Lisandri KOLA, poet dhe studiues shprehet: ...Tematikat në të cilat e lëvron poezinë Arben Prendi [...] janë natyrisht shqetësime të përhershme të letërsisë, universale, e patjetër të pranishme edhe në produktin letrar shqip. Por, gjykoj se ndieshmënia asht unike, kodi empatik që vendoset me lexuesin si edhe asosacioni estetik i trinisë jetë-kohë-vdekje.



Ars poetica

poezi nga

SHAZIM MEHMETI

ARS POETICA

(kanavaca e bardhë, piktori, mbase unë...)

Aty ku çasti qafën e vet pret,
ti copash je.
Ngulur, vetmisht, te këthizë e fatit.

Hutimthi,
përpara asaj pëlhure të bardhë,
preparuar për dorë,
preparuar për brushë,
preparuar për grua,
preparuar për diell.

E, në vend se gruaja,
në vend se dielli,
të del përpara deti.

Vranësira s’është trupi i gruas
që e kërkon n’ëndrra.
Je vetmitari në rrugëtimin e largët,
je ylli që ngarend të mbytet,
në hullinë e kurreshtjes, errësimit.

Asnjë Zot nuk të del zot,
qielli është i madh i errët,
i thellë i egër deti.

Je ku kthim nuk ka,
je barka e vogël që luhatet,
dridhet, përmbytet.

Në pafundsinë e pambarimtë të hamendjes,
krahësh të godet stuhia -
furtunë e fortë përpara teje.

Secili asht brenda teje thehet,
brenda teje dhemb.
Një dërrasë barku,
kalbur t’është, thyer -
brenda teje rrjedh, përfutet deti.

Trupi yt s’është yti,
gjithë derdhja e detit,
gjithë shembja e botës
mbi mishin tënd ndodh.

Në thellësinë e pamatë,
e ke prekur vdekjen,
e ke prekur shkëmbin.
Atje poshtë te fundi,
ti krahë i vë ëndrrës,
ngjitesh, noton, noton.

Ti lind në sërishje,
ti lind për ta parë diellin,
dhe trupin e gruas,
n’kanavacë e n’zemër...

DRIDHUR ZË I ZOGUT
T’NDROJTUR...

Dridhur zë
i zogut t’ndrojtur;
krehur, flokënajë
e lagur e natës;
dy hije derdhur
n’njëra tjetrën;
trupit tënd ngjitur,
i vdekuri rilind...

BEKIM

Qoftë prej guri
ai trup, ai shpirt,

prej argjile qoftë,
a prej humusi,

qoftë prej bime
a prej secilit shpend,

prej bishe qoftë,
prej mali, prej malli,

qoftë prej krimbi
a prej kafshe t’butë,

prej ere qoftë,
prej drite, prej terri,

qoftë prej njeriu
a prej një djalli brinjar,

ajo e lanë...

Ujë është koha.
Bekuar qoftë!...

VLIM

I kam ndigjue
shtërzimet e gjata t’natës,
n’çastet e fundit t’shtatzanisë shenjte
dhe kam qa.

I kam pa
edhe kambët e vogla t’mëngjesit
n’lindjen e tij praptas
dhe kam qa.

Kam vlue n’zemër -
lotë gjaku kam derdhë
me këto dy sy terrine,
kur kam pa si bahet dritë
mishi i territ...

TRËNDAFIL MBI GUR...

A çahet guri,
trëndafil?...

Shtërzon të mbijsh,

shtërzon të mbijsh mbi gur,
e dita m’bëhet tirane.

Dhe gjaku
i kaltër e letrës
tiran më bëhet,
dhe drita,
që s’më ndrit,
s’më lanë...

S’të ndihmoj, më ndje!...
N’kthetra errësire,
n’kthetra embrioni
akoma m’je,
trëndafil
mbi gur!...

UDHË...

Drita lahet
në sytë e tij.

Shumë udhë,
i dalin para syshë,
e ai nuk di.

Kah t’ia mbajë,
kah t’ia mbajë,
ai rob i Zotit?...

Gjithë zori
i vjen nga e thjeshta:
udhët janë shumë
e mendja një...

MËNGJESËT, BALADA T’REJA I
THURIN GJAKUT...

Mëngjeset,
balada t’reja
i thurrin gjakut;

zogjtë e gurëve
me pendla drite
e vrasin urinë;

përditë
çahet gjoks i qiejve,
nga tirania e përpiktë
e skifterëve t’hekurt;

digjen gurë e qiej,
qiej e zogj;

pardon’ja eterike -
rrena masive
vazhdon ta përgjakë
jeshilenë e butë,
jeshilenë e mjerë
të fukarenjve sydiej;

si miklime engjëllore,
paketohen, shiten krimet,
e mbarsin eterin...

Gjithëçka e kuptueshme, Zot imi:
n’shekullin e kushedisatë

t’rrenës e t’gjakut,
engjëj duken tiranët,
dhe bota vazhdon të mbetet
po ajo gjëmë...

ATY ËSHTË, ATY S’ËSHTË...

Aty është,
aty s’është,
ai shelg,
ai zog.

Sytë mashtrojnë,
fryma është
shpëtim.

Shikimi është
një farfuritje
kaluese.

Drita
ka ngjyrën
e këtij mendimi...

MËNGJESI DEL PREJ GJUMI...

Mëngjesi
del prej gjumi.
Mëngjesi
sytë e vegjël
përpëlit.

Sheh
mërdhirë mbi shelg,
zogun e dimrit,
dhe dimër
i bëhet
fjala.

(Fjala,
zemër është
a stinë?...)

MËSYVE, MËSOVE, E ZURE ATË
YLL...

Mësyve,
mësove,
e zure
atë yll.

Mësyj,
mëso, tashti,
si mbahet
prushi ndorë...

(kohë n’paç,
zemër,
durim...)


DITË, DRITË E ZOTIT...

Ditë,
dritë
e Zotit,

bardhësi
e virgjër,
borë e re,

gjurmë hapash
mbi borë,
edhe gjurmë ujku,

shtrirë,
tutje, e tutje,
deri te ajo pikë e zezë
ku shikimi përgjaket...



Bagatelle

tregim nga

AGRON BAJRAKTARI

Jam ulur në njërën prej dy karrigeve në dhomën e ndenjes. Divani i përket planeve të rrogës së muajit tjetër. Bashkë me të edhe tavolina e shkrimit. Laptopin e mbaj në prehër. Kjo e ndenjur me shpinën e kërrusur më lodh, kështu që ngrihem në këmbë. Dua të rri në këmbë, por dua të rri edhe në laptop; zgjidhja më e mirë më duket se është komodina, lartësia e të cilës më mbërrin te gjoksi. Ashtu i bie ta vë laptopin mbi të, por jo pa larguar në fillim çelësat e shtëpisë, një shishe me ujë dhe disa paracetomola.

Pozicioni i ri më duket i kënaqshëm. Kështu, dhimbjen e shpinës, e cila, si çdo dhimbje, pavarësisht se mund të ketë filluar vetëm para disa minutash, duket sikur ka vite që më torturon, do ta ndiej më pak. Doktorin më ka thënë që kam nevojë për lëvizje. Në pamundësi të daljes në park këtë të diel me shi, lëvizja në vend është ku e ku më e shëndetshme sesa kërrusja mbi karriget e vogla apo shtrirja në krevat.

Gruaja është në kuzhinë. Po gatuan drekën. Ia ndiej lëvizjet e matura prej këtu, nga tavolina e re e punës. Pas pak, pasi kam humbur në rrjedhën e asaj që po mundohem të bëj, e cila, pse mos ta pranoj, është tentativa e tretë për të krijuar një tregim, ndiej mbi faqe buzët e saj. Si gjithmonë, i ka të lëngëta. Një ndjesi që në mungesë të sensualitetit do quhej kërqethje, ndërsa në prani të tij do mbështillej nga drithërima e dashurisë, ma kaplon gjithë pjesën e shpinës. Për një çast edhe ma pushon dhimbjen e kryqit. Gruaja më puth edhe njëherë, por trupi stepet. Nuk pranon të zihet më në befasi, kështu që gatitet në kohë. Gjithsesi, stepja nuk është krejt efikase, pasi sapo gruaja pëshpërit diçka, trupi më dridhet përsëri.

Një lëxues i vëmendshëm dhe kureshtar, në këtë pikë, do shpresonte që drithërima të mos ishte pasojë e pëshpërimës në vetvete, por e fjalëve të përcuara nëpërmjet saj. Fatkeqësisht, më duhet ta zhgënjej këtë lëxues. Drithërima, e cila mund të përshkruhet vetëm nga fjala e shëmtuar, e mësuar në femijërinë e largët të qytezave të veriut, kërqethje, erdhi vetëm si pasojë e pëshpërimës. Bëra të them diçka, siç them sa herë e ndiej acarimin tek lind, gurgullon dhe shndërrohet krejt papritur në nerv, por e ndala veten. Mirëpo kjo ndalesë nuk mbetet e padukshme ndaj syrit të mprehtë të gruas sime. Ajo e vëren nervin tek më sillet në fytyrë, tek e përçudnon atë në përpjekjen e tij për t'u çliruar nga lëkura; e sheh kur mbërrin në sy dhe shfaqet në shkëlqimin e pagabueshëm të irritimit; e sheh në dorën time, që në pamundësi për të bërë gjë tjetër, u shkon flokëve dhe qafës, jo pa lënë disa vija të kuqe mbrapa.

Në fillim, gruaja nuk thotë gjë. Pastaj, tek dëgjohet zhurma e vakët e gatimeve që mbërrijnë pikën e tyre të vlimit, merr drejt kuzhinës, jo pa i lënë edhe ajo disa fjalë mbrapa.

“Anton, fiksime të tua janë tmerrësisht specifike.”

Nuk kam nevojë t'i kaloj dy herë nëpër kokë ato fjalë që të pranoj se ka të drejtë. Edhe më e lehtë për t'u pranuar është kënaqësia që ndiej nga përzgjedhja e fjalëve të saj. Nuk ma thotë drejtpërsëdrejti se të ashtuquajturat fiksime të miat janë të parëndësishme; m'i quan specifike. Një fjalë tmerrësisht delikate, si një qelq që mund të thyhet po s'dite ta mbash mirë; fjalë që më shan, po edhe më lavdëron, pavarësisht se jo një lavdërim që një burrë e pret nga gruaja e tij, duke ma quajtur fiksimin edhe të rrallë. Pra, edhe i parëndësishëm, edhe i rrallë. Të shumta janë gjërat e parëndësishme që më vijnë në mendje, e gati të gjitha do i fusja në thesin e gjërave që bëhen pak a shumë nga të gjithë. Dhe shpesh është bërja e tyre prej të gjithëve që i shndërron ato në të parëndësishme. Të tjerat, të parëndësishmet e rralla, janë me të vërtetë të rralla. Dhe gruaja ime po e fut edhe fiksimin tim ndaj pëshpërimave në atë thes.

“Unë u shkëputa nga puna për ty, ndërsa ti bezdisesh.”

Teknikisht këtë më thotë heshtja e saj tek hamë drekën. Nuk është e rëndë, si ata që ulen pa i ftuar kush në tavolinë. Është e idhët, por e kapërdishme. Si limoni.

Gruaja ha shpejt e shpejt, pastaj shkon në dhomën e gjumit. Dënimi im është i vetëkuptueshëm. Pavarësisht se nuk është rradha ime, enët do i laj unë. Ky është çmimi i një dashurie të nënvlerësuar. Çmimi i të pasurit tmerr fjalët që vijnë nëpërmjet një pëshpërimë.

Në fakt, nuk do e quaja tamam tmerr. Është më shumë bezdisje. Por një bezdi aq e thellë, sa çdo mekanizëm brenda meje, që, në fund të fundit, është duke bërë punën e vet, ndalet për një çast dhe bën në fytyrë atë shprehjen që bën fëmija kur provon limonin për herë të parë.

Fatkeqësisht, është diçka që s'mund ta tejkaloj. Nëse vullneti i lirë është diçka që qiejt nuk na e kanë dhënë thjesht si iluzion, ky i ashtuquajtur fiksime nuk është i pranuar në rrethin e veprimeve që gëzojnë të drejtën e vendimarrjes. Nëse do isha në humor më të gëzueshëm, do guxoja ta quaja edhe pasion, duke marrë parasysh se rrënja e kësaj fjale nënkupton vuajtjen që vjen nga paaftësia e mbartësit të pasionit për ta frenuar.

Lexuesi jonë i vëmendshëm me siguri ka kapur edhe këtë tjetër: në fjalinë e saj qortuese, gruaja ime përdor shumësin. Nuk thotë: fiksime yt. Thotë: fiksime të tua. Pra, ka më shumë se një. Më shumë se pëshpërima.

Kujtesa më çon në fëmijëri. Me syrin e mendjes shoh gjyshin që afrohet me hapin e tij të rëndë. Më vendos dorën e madhe mbi kokë dhe më përkëdhel për ca çaste flokët duke më pyetur se ç'kam bërë atë ditë. Pastaj më puth në faqe, në pjesën e sipërme të mollezës, krejt afër syrit, siç e ka zakon, dhe në fund m'i kap faqet me gishta.

Kapja nuk është e fortë. Ndryshe nga ç'kam dëgjuar për namin e dorës së tij, në faqen time ajo gjithmonë ka vepruar butë, si mbi një qelq që mund të thyhet po s'dite ta mbash mirë. Pavarësisht kësaj, ndiej në mua tek ngrihet i njëjti nerv, e njëjta bezdi specifike që ndiej kur më pëshpërit gruaja. Nuk ka rëndësi që e gjitha po më ndodh në mendje, tek kujtoj një fëmijëri që do doja ta vizitoja qoftë dhe veç për një çast. Vetë ideja e atij veprimi zgjon në mua djallin e bezdisjeve specifike. Dhe ma përçudnon fytyrën. Dhe më ndez aq shumë sa më duhet të sforcohem që ta ndaloj flakën të dalë përjashta.

Një mik i vjetër më pat thënë njëherë se pikërisht ngaqë s'e lija të dilte, vazhdonte të ndodhte prapë ajo gjë. Pra, vetëpërmbytja ime ishte ajo që e lejonte të ishte ende gjallë. Nga ana teorike ai kishte njëfarë të drejte. Që njeriu të mos mendojë gjithë kohën për seksin, ai duhet të bëjë seks. Nga ana praktike, gjithsesi, s'është krejt ashtu. Vetëpërmbytja ime nuk është kundërmasa e vetme që kam provuar ndaj fiksimeve të mia specifike. Është e vetmja që më lejon të jetoj me ta pa prishur gjërat përreth. Për shembull, pa i bërë turrë gruas për diçka që në çdo njeri tjetër do krijonte ndjenjën e shumëkërkuar të lumturisë. Ose pa grushtuar murin...

Enët nuk janë shumë. Mund t'i laj për dy minuta. I ngrej nga tavolina e vogël e bukës dhe i vendos në lavaman. Sfungjerin, të cilin për ca çaste e kërkoj nëpër sirtaret e sipërme, nuk e gjej askund. Kërkimi im zgjat shumë më shumë se ç'duhet kërkuar diçka si sfungjeri, por e gjithë kjo ndodh ngaqë nuk dua të shoh në vendin ku e di se do e gjej: brenda në lavaman. I qullët. I pistë. E fundit aty ka qenë gruaja dhe pavarësisht se e di që zemra e saj nuk i pëlqen fort hakmarrjet e vogla (të mëdhajat s'kam guxim t'i ngacmoj), një pjesë e imja nuk mund të mos mendojë ndryshe.

Një kërkim i shpejtë në internet më tregon se fjala *bagatelle*, të cilën për herë të parë e mësova nga titulli i një kënge të vjetër të Yann Tiersen, ndër të tjera, do të thotë:

- diçka pa rëndësi
- një pjesë e shkurtër letrare.

Pasi laj enët, i rikthehem laptopit mbi tavolinën-komodinë për të përfunduar tregimin e filluar. Në fakt, nuk e kam filluar ende. Kisha një ide në fillim, por me shfaqjen e pëshpërimave, kapjes së faqeve me gishta dhe sfungjerëve në lavaman, ajo është zhdukur. Harresa, thoshte nëna ime, tret gjërat që s'kanë rëndësi. Fatkeqësisht, jo të gjitha. Jo gjërat specifike. Jo ato që kur jam në humor të mirë guxoj t'i quaj pasione.

Isha përgatitur ta urreja Max Kelada-n përpara se të Injihesha me të. Lufta kishte mbaruar dhe numri i udhëtarëve që lëviznin me anijet transoceanike ishte tepër i madh. Të gjeje vend në to ishte shumë e vështirë, ndaj ishe i detyruar, me durim, të pranoje atë që punonjësi i agjensisë zgjidhte të të jepte. Të shpresojë për një kabinë më vete, ishte e pamundur, kështu që u tregova mirënjohës kur mu dha një e tillë me vetëm dy shtretër. Komunikimi i emrit të bashkudhëtarit më bëri të pezmatohem. Kjo nënkuptonte dritare të mbyllura dhe, rreptësisht, asnjë lloj kontakti me ajrin e natës. Ta ndaje kabinën me një person tjetër për katërmbëdhjetë ditë (do të udhëtoja nga San Francisco në Yokohama) nuk ishte aspak e këndshme, por të gjitha këto do t'i kisha konsideruar më pak të frikshme nëse emri i bashkudhëtarit do të kishte qenë Smith apo Brown.

Kur u ngjita në bordin e anijes, bagazhin e zotit Kelada e gjeta të ulur për tokë. Pamja nuk më pëlqeu aspak; valixhet ishin të mbuluara me etiketa dhe baulja e teshave ishte tepër e madhe. Vura re se ai i kishte nxjerrë jashtë sendet e tualetit dhe se ishte myshteri i firmës së përsosur Monsieur Coty: mbi lavaman pashë parfumin, shampoon e flokëve dhe brilantinën e tij. Furçat e zotit Kelada, prej abanozi dhe me dy inicialet e emrit të tij të derdhura në flori, do të ishte më mirë të përdoreshin si furça pastrimi. Zoti Kelada nuk më pëlqeu aspak. Bëra disa hapa drejt dhomës së duhanit. Kërkova një palë letra dhe nisa të luaj *patience*. Akoma nuk kisha filluar lojën mirë, kur një burrë më erdhi pranë dhe më pyeti a e kishte drejt nëse, sipas tij, quhesha kështu apo ashtu.

‘Unë jam Kelada,’ shtoi ai tek u ul në tavolinë me një buzëqeshje që zbuloi një radhë dhëmbësh të shndritshëm.

‘Oh, po, më duket se kabinën e kemi të përbashkët.’

‘Një grimë fati, e quaj unë. Nuk mund ta dish se kush të bie për pjesë. U gëzova pa masë kur mora vesh se ishit anglez. Jam plotësisht për atë që anglezët ta mbështesin njeri-tjetrin jashtë shtetit, në më kuptoni se ç'dua të them.’

Unë kapsita sytë.

‘Anglez jeni?’ pyeta, ndoshta pa takt.

‘Deri diku. S'ma ha mendja se ju dukem amerikan, hë, si thoni? Britanik deri në palcë, ja çka jam unë.’

Për ta vërtetuar këtë, zoti Kelada nxori nga xhepi një pasaportë, dhe me një pamje pompoze, ma valëviti atë nën hundë.

Mbreti George ka shumë shtetas të çuditshëm. Zoti Kelada ishte i shkurtër, me një konstrukt të fortë, i rruar pastër, zeshkan, me hundë mishtake e të kthyer dhe sy të mëdhenj, të shndritshëm e të kthjellët. Flokun e kishte të zi dhe me kaçurrela. Fliste me një rrjedhshmëri në të cilën nuk gjeje asgjë angleze, ndërsa gjestet i kishte të tepruara. E ndjeva veten fare të sigurt se një vëzhgim më i kujdesshëm i pasaportës britanike do ta zbulonte faktin se zoti Kelada kishte lindur nën një qiell më blu sesa ai që, zakonisht, shihet në Angli.

‘Çfarë dëshironi të pini?’ më pyeti ai.

E pashë me dyshim. Prohibicioni, ishte në fuqi, dhe me sa dukej, anija ishte tharë nga pijet. Kur nuk kam etje, e kam të vështirë ta përcaktoj se cila pije ma shpif më shumë, limonada me xhenxhefil apo limonada e mirëfilltë. Fare papritur, zoti Kelada më dhuroi një buzëqeshje orientale.

‘Uiski dhe soda apo Martini pa alkool, mjafton vetëm ta hapni gojën.’

Ai nxori një faqore prej secilit xhep të prapmë të pantallonave dhe i vendosi të dyja në tavolinë përpara meje. Unë zgjodha një Martini, ndërkohë që ai thirri punonjësin e shërbimit dhe porositi akull në një çafkë pa vjegë si edhe dy gota.

‘Koktej shumë i mirë,’ thashë unë.

‘Atëherë, aty ku është marrë kjo ka edhe një mori të tjera, ndaj, nëse keni miq në bord, t'i lajmëroni se keni një mik në anije i cili disponon të gjitha pijet e botës.’

Zoti Kelada ishte fjalëshumë. Ai foli për New York-un dhe San Francisco-n. Diskutoi për dramën, filmat dhe politikën. Ishte atdhetar. Flamuri i Britanisë së Madhe është një copë pëlhurë që të lë mbresa, por kur valëvitet nga një zotëri pre Alexandria-s ose Beirut-it, nuk ka sesi që unë të mos ndiej se ai humbet disi në dinjitet. Zoti Kelada ishte miqësor. Unë nuk dua të hiqem superior, por ama, nuk mund ta shmang ndjesinë që kam se e gjykoj të hijshme që një person, krejtësisht i huaj, duhet ta vendosë fjalën zotëri përpara emrit tim sa herë që më drejtohet. Pa dyshim, për të më bërë që të ndjehesha rehat, Zoti Kelada iu shmang formalitetit. Nuk më pëlqeu. Kur ai u ul në tavolinë, letrat

Zotëria që i dinte të gjitha

tregim nga

W. SOMERSET
MAUGHAM

i kisha hequr mënjane; mendova se duhej ta vazhdoja lojën, ngaqë, si për rast të parë, biseda jonë kishte zgjatur mjaft.

‘Treshin mbi katrën,’ tha zoti Kelada.

Nuk ka asgjë më shqetësuese sesa të jesh duke luajtur *patience* dhe dikush të të thotë se ku duhet hedhur letra e sapo kthyer, pa t’u dhënë mundësia për ta parë njëherë vetë.

‘Po del, po del,’ thirri ai. ‘Dhjetën mbi fant.’

Me zemërim dhe urrejtje ne zemër mbarova lojën. Në atë moment, ai rrëmbeu pakon e letrave.

‘Të pëlqejnë marifetet me letra?’

‘Jo, i urrej,’ u përgjigja.

‘Mirë, do t’ju tregoj vetëm një.’

Më tregoi tre. Më pas, i thashë se do të zbrisja në sallën e ngrënies që të zija një vend.

‘Oh, në rregull,’ tha ai. ‘Vendin j’ua kam zënë unë. Meqenëse ndajmë të njëjtën kabinë, mendova se, fare mirë, mund të uleshim në të njëjtën tavolinë.’

Zoti Kelada nuk më pëlqeu.

Jo vetëm që ndava kabinën dhe u ula tre vakte në ditë në të njëjtën tryezë me të, por edhe gjatë shëtitjeve në kuvertë nuk m’u nda asnjëherë. Ishte e pamundur ta shpërfillje. Nuk i shkonte kurrë ndërmend se ishte i padëshirueshëm. Ishte i bindur se ishte aq i gëzuar kur ju shihte, saç ishit edhe ju. Në shtëpinë tuaj mund ta hidhnit me shkelma poshtë shkallëve, t’ia përplasnit derën në fytyrë dhe përsëri nuk do t’i vinte ndërmend si ishte vizitor jo i mirëpritur. Përzihet me lehtësi mes të tjerëve, dhe brenda tre ditëve u njoh me të gjithë në bord. Organizonte gjithçka. Përpilonte listat, drejtonte shitjet në ankand, mblidhte lekët për çmimet në veprimtaritë sportive, drejtonte lojën e precizonit me rrathë plastikë, ndeshjet e golfit, shfaqjet dhe mbrëmjet e vallëzimit. Ishte, sigurisht, njeriu më i urreyer i anijes. E thërrisnim Zotëria që-i-Di-të-Gjitha, dhe madje këtë ia thonim edhe në sy. E merrte për kompliment. Gjatë tre vakteve bëhej më i padurueshëm se kurrë. Thuaje për një orë të tërë ishim në mëshirën e tij. Ishte entuziast, gazmor, fjalëshumë dhe debutues. Dinte gjithçka më mirë se të tjerët dhe nëse nuk bije dakord me të, kjo përbënte fyerje për kotësinë e tij mendjemadhe. Nuk pushonte së komentuari një temë të caktuar pa të imponuar mënyrën e tij të menduarit. Mundësinë se mund ta kishte gabim as që e imagjinonte. Ishte djaloshi që dinte. U ulëm në tavolinën e doktorit. Gjithçka do të shkonte sipas dëshirës së zotit Kelada, po të mos kishte qenë për Ramsay-n, i cili u ul me ne; doktorin ishte një tip i ftohtë e indiferent. Ai ishte po aq dogmatik sa edhe zoti Kelada dhe inatosej shumë me sigurinë arrogante dhe tipike të Levant-it. Diskutimet midis tyre ishin therëse dhe pafund.

Ramsay punonte në Shërbimin Konsullor Amerikan në Kobe. Ishte një djalë trupmadh e i rëndë nga Middle West-i, me dhjamra të lëshuara nën një lëkurë të tendosur dhe që dukej sikur rrobat e gatshme që kishte veshur, mezi e mblidhnin. Po kthehej për të rimarrë postin pas një fluturimi në New York, ku kishte shkuar për të marrë gruan e cila kishte kaluar një vit në shtëpinë e saj. Zonja Ramsay ishte një vajzë e re simpatike, me edukatë dhe humor. Shërbimi konsullor nuk paguhet mirë, ndaj dhe ajo vishej gjithmonë shumë thjesht; por dinte, ama, si të vishej. Jepte efektin e një originaliteti qetësues. Unë nuk do t’i kisha kushtuar asaj asnjë vëmendje të veçantë, por çfarë t’i bëja që zotëronte një cilësi, ndoshta të zakonit edhe në gra të tjera, por që në ditët tona nuk shfaqet në sjelljen e tyre. Nuk mund ta shikoje pa të bërë përshtypje modestia që i shndriste si një lule e vendosur mbi pallto.

Një mbrëmje, tek hanim darkë, biseda kaloi rastësisht tek tema e margaritarëve. Shumë ishte folur nëpër gazeta mbi margaritarët artificialë që prodhoheshin nga të shkathët japonezë; doktori vërejti se ato, pashmangshmërisht, duhej ta ulnin çmimin e margaritarëve natyralë. Ishin goxha të mirë tashmë; së shpejti, do të ishin perfektë. Zoti Kelada, siç e kishte zakon, u ngut të hynte në temë. Na tha gjithçka që duhej të dinim për margaritarët. Besoj se Ramsay nuk dinte asgjë për to. Por nuk mundi t’i bëj ballë tundimit që ta sulmonte Levant-inin, dhe brenda pesë minutave që të dy u përfshinë në një debat të nxehtë. E kisha parë zotin Kelada të furishëm dhe brisk nga goja, por kurrë nuk e kisha parë kaq brisk dhe të furishëm sa tani. Më në fund, Ramsay tha diçka që e thumboi keq atë, sepse ai e goditi tavolinën me forcë duke bërtitur:

‘Atëherë, besoj se e di se ç’po them. Në Japoni po shkoj vetëm për të parë nga afër biznesin e margaritarëve. Merrem me tregtinë e tyre dhe nuk ka rob që të mos j’ua pohojë, se çka them unë për margaritarët, është e vërtetë. I njoh të gjitha margaritarët më të mirë në botë dhe çka nuk di, nuk ia vlen ta dish.’

Ky ishte lajm për ne, sepse zoti Kelada, me gjithë llafazanërinë e tij, nuk i kishte thënë askujt se me se merrej. Dinim, qartazi, vetëm se po shkonte në Japoni për një porosi tregtare. Si ngadhënjimtar, ai hodhi vështrimin rreth tavolinës.

‘Kurrë nuk ka për t’u prodhuar një margaritar artificial që një ekspert si unë të mos e dallojë me gjysmë syri.’ Më pas, bëri me gisht drejt një gjerdani që mbante veshur zonja Ramsay. ‘Ma merrni fjalën për bazë, zonja Ramsay, gjerdani që mbani veshur nuk do ta humbasë asnjëherë vlerën që ka sot.’

Zonja Ramsay, me mënyrën e saj modeste, u skuq pak në fytyrë dhe,

shpejtazi, e rrëshqiti gjerdanin nën fustan. Ramsay bëri trupin përpara. Na dhuroi një shikim e një buzëqeshje të gjithëve, ndërkohë që sytë i regëtuau.

‘Gjerdani i zonjës Ramsay është i bukur, apo jo?’

‘Më ra në sy menjëherë,’ u përgjigj zoti Kelada. ‘Pa shiko, thashë me vete, këto janë margaritarë për së mbari.’

‘Natyrisht që gjerdanin nuk e kam blerë vetë. Do të më interesonte ta dija se sa ka kushtuar sipas mendimit tuaj.’

‘Oh, në treg, diku aty rreth pesëmbëdhjetë mijë dollarë. Por, nëse është blerë në Fifth Avenue, nuk do të çuditesha po ta merrja vesh se për blerjen e tij janë paguar afërsisht tridhjetë mijë dollarë.’

Ramsay buzëqeshi me zymtësi.

‘Keni për t’u çuditur kur ta merrni vesh, tani, se zonja Ramsay e bleu gjerdanin në një qendër tregtare, një ditë para se të iknim nga New York-u, për tetëmbëdhjetë dollarë.’

Zoti Kelada u përflak në fytyrë.

‘Dokrra. Jo vetëm që është natyral, por për madhësinë që ka, është nga më elegantët që kam parë ndonjëherë.’

‘Doni të vini bast? Vë bast kundër jush njëqind dollarë se është artificial.’

‘Dakord.’

‘Oh, Elmer, nuk mund të vësh bast për gjëra të sigurta,’ tha zonja Ramsay.

Në buzët e saj kishte një buzëqeshje të lehtë, ndërsa toni ishte butësisht kundërshtues.

‘Nuk mundem? Do të isha i metë nëse më jepej mundësia të fitoja lekë me kaq lehtësi dhe të mos e shfrytëzoja rastin.’

‘Por, si mund të provohet kjo?’ vazhdoi ajo. ‘Këtu kemi vetëm fjalën time dhe atë të zotit Kelada.’

‘Më lejoni ta shikoj gjerdanin, dhe po qe se është imitim, nuk do të vonoj t’ju them. Mua nuk më kushton asgjë të humbas njëqind dollarë,’ tha zoti Kelada.

‘Hiqni gjerdanin, e dashur, dhe lejoheni



zotërinë ta shikojë atë sa të dojë.’

Zonja Ramsay ngurroi për një çast tek vuri duart te kapësja e gjerdanit.

‘Nuk e zbërthej dot,’ tha ajo. ‘Zoti Kelada duhet të më besojë.’

Papritur më lindi dyshimi se diçka e prapë do të ndodhte, por nuk më shkonte ndërmend se ç’mund të ishte.

Ramsay u hodh në këmbë.

‘E zbërthej unë.’

Ai ia kaloi gjerdanin zotit Kelada. Levant-ini nxori një xham zmadhues nga xhepi dhe e vëzhgoi me kujdes. Një buzëqeshje triumfi u përhap mbi fytyrën e tij të butë dhe zeshkane. Ktheu mbrapsht gjerdanin. U bë gati të flasë.

Papritur, syri i kapi fytyrën e zonjës Ramsay. Ajo ishte zbardhur aq shumë, saqë dukej se ishte gati për t’i rënë të fikët. Ajo po e shikonte me ngulm, me sy të zgurdulluar dhe të tmerruar. Një lutje përgjëruese dallohej në sytë e saj; ishte aq e dukshme saqë pyesja veten sesi i shoqi nuk e shihte atë.

Me gojën hapur, zoti Kelada u ndal. Fytyra iu përflak keq. Përpjekja që po bënte për ta mbajtur veten nuk mund të fshihej.

‘Gabova,’ tha ai. ‘Është imitim shumë i mirë, por sigurisht, sapo e pashë nëpërmjet xhamit zmadhues, e kuptova menjëherë se nuk ishte natyral. Besoj se vlera e këtij gjerdani të mallkuar është afërsisht tetëmbëdhjetë dollarë.’

Ai nxori portofolin dhe tërhoqi prej tij një kartëmonedhë njëqind dollarëshe. Ia dorëzoi Ramsay-t pa thënë asnjë fjalë.

‘Ndoshta do t’ju bëhet mësim, që herë tjetër, të mos jeni kaq shumë i sigurt,’ miku im i ri, tha Ramsay tek mori kartëmonedhën.

Vura re se duart e zotit Kelada po dridheshin.

Lajmi i episodit u përhap në anije ashtu siç ndodh me ngjarje të tilla dhe zotit Kelada iu desh t’i bënte ballë shpotive të shumta atë mbrëmje. Zotëria që-i-Dinte-të-Gjitha ishte kapur në grackën e një tallje me shije të hollë. Zonja Ramsay, nga ana e saj, u tërhoq në kabinën e vet me dhimbje koke.

Të nesërmen në mëngjes, u ngrita nga shtrati dhe fillova të rruhem. Zoti Kelada po pinte cigare i shtrirë në shtrat. Papritur, u dëgjua një zhurmë e lehtë, si një gërvishtje, tek pashë një letër të shtyhej nën derë. Hapa derën dhe hodha vështrimin në korridor. Nuk kishte njeri. Ngrita letrën nga dysheja dhe pashë se i drejtohej zotit Max Kelada. Emri ishte shkruar me germa të mëdha. I dhashë letrën.

‘Kush e dërgon?’ E hapi. ‘Oh!’

Ai nxori nga zarfi njëqind dollarë, por jo letër. Pa nga unë, dhe përsëri u skuq. Pasi e grisi zarfin copa-copa, ma dha mua.

‘A mund t’i hidhni këto nga dritarja e kabinës?’

‘Ja plotësova kërkesën me një buzëqeshje.’

‘Askujt nuk i pëlqen të bëhet një lolo i vërtetë,’ tha ai.

‘Mos ishin natyralë margaritarët?’

‘Po të kisha një grua të re dhe simpatike, nuk do ta lejoja që të kalonte një vit në New York, në kohën që unë qëndroja në Kobe,’ tha ai.

Në atë çast, antipatia ime për zotin Kelada sikur u zbut. Ai nxori portofolin, dhe me kujdes, vendosi në të kartëmonedhën prej njëqind dollarësh.

*Përktheu nga anglishtja: Aristidh Shqevi
Oslo, 02.09.2020*

Këtë analizë po ia kushtoj përkthimit në shqip të romanit të Dostojevskit “Vëllezërit Karamazov”, që është romani i fundit i shkrimtarit, i vlerësuar si një nga arritjet më të larta në letërsinë botërore, roman filozofik i pasionuar që hyn thellë në çështjet e Zotit dhe të moralitetit, një dramë teologjike, ku trajtohen problemet e besimit, të dyshimit dhe të arsyes. Është vepra më përfaqësuese e Dostojevskit, sinteza e hulumtimeve të tij dhe e kontradiktave të tij, me një temë që spikat mbi të tjerat: dialektika mes së mirës dhe së keqes, përplasja mes rrugës së arsyes, rebele dhe krenare, që shpall mohimin e Zotit dhe të krijimit, dhe rrugës së zemrës e të parandjenjës fetare. Zigmund Frojdi ka thënë: “Është romani më i shkëlqyeshëm i shkruar ndonjëherë...Sigurisht, nuk është një rastësi që të tri kryeveprat e të gjitha kohëve trajtojnë të njëjtën temë, atëvrasjen: e kemi fjalën për “Edipin mbret” të Sofokliut, “Hamletin” e Shekspirit dhe “Vëllezërit Karamazov” të Dostojevskit. Në të tria këto vepra del lakuriq edhe motivi i prapësisë: rivaliteti seksual për posedimin e gruas”.

I përmendëm këto vlerësime për të thënë se sa kujdes duhej treguar në përkthimin e një vepre të këtij niveli.

Romani në fjalë është përkthyer nga Xhemile Zyka, është redaktuar nga Rexhep Hida dhe është botim i vitit 2017 i shtëpisë botuese “Fan Noli”.

Qysh në krye të herës duhet thënë se përkthimi është një përpjekje për të qenë sa më korrekt me tekstin origjinal të veprës, në dallim nga përkthimi i romanit “Krim dhe dënim”, ku, në shumë raste, fillimisht gjërat rrotulloheshin në mendjen e përkthyeses, merrej me mend se çdonte të thoshte autori dhe pastaj hidheshin në letër fjalitë dhe frazat e tij dhe aq me tepër në dallim nga përkthimi i “Doktor Zhivagos”, ku shtoheshin fjalë e fjali nga xhepi i përkthyesit, liheshin pa u përkthyer jo vetëm fjali dhe fraza, por edhe pasazhe të tëra, veç pasaktësive të tjera të shumta kuptimore e gjuhësore. Mirëpo, krahas vlerave pozitive të përkthimit të romanit “Vëllezërit Karamazov”, kanë kaluar edhe mjaft pasaktësi. Kështu, janë harruar pa u përkthyer fjalë (mbiemra që shoqërojnë emra, ndajfolje që shoqërojnë mbiemra të ndryshëm etj.), si dhe fjali të tëra. Kemi përkthim jo të saktë të disa fjalive dhe të shumë fjalëve të veçanta, në shumë raste nuk respektohen shenjat e pikësimit të origjinalit (vihet pikë, kur s’ka pikë, hiqen dy pikat sipas qejfit dhe vihet pikë ose presje, hiqet pika dhe vihen dy pikat, ose kur është presje, hiqet dhe vihet pikëpresje dhe, e kundërta, kur është pikëpresje, hiqet dhe vihet presje etj.), si dhe kalohet në kryeradhë sipas dëshirës së përkthyeses.

Le t’i shqyrtojmë këto pasaktësi duke analizuar disa momente të përkthimit të veprës, në pamundësi për ta analizuar të gjithë veprën fjali për fjali.

F. 13-14 dhe 33-34: Thuhet “tridhjetë vjet më parë”, por në fakt është “trembëdhjetë vjet më parë (тринадцать)”, thuhet “ishte i martuar tri herë”, por në fakt është dy herë (два раза), «мозгляка» përkthehet “mendjelehtë”, se është nisur nga мозг-тру, por në fakt мозгляк do të thotë i dobët, shëndetlig (тщедушный, слабосильный, хилый), «богородица» nuk është

“shenjtoresh”, por “nëna e Krishtit” (мать Христа). Kalohet në kryeradhë, kur nuk është kryeradhë, si në rastet “Tani do t’ju flas...”, “Kjo e gjitha...”, “Po kështu...”, “Ja kjo është tabloja!”, “Megjithatë ai donte...”, “Ai kishte shkuar...”, “I ati...”; këto raste janë vetëm të faqeve të mësipërme, sepse në kryeradhë, kur s’është kryeradhë në origjinal, përkthyesja ka kaluar me dhjetra e shumë më shumë herë gjatë përkthimit të

Mbi romanin “Vëllezërit Karamazov” të Dostojevskit

PASAKTËSITË E NJË PËRKTHIMI

nga THEODHOR CICO

veprës. E ka bërë shpesh këtë me mendimin se e lehtëson kësioj lexuesin në leximin e paragrafëve vërtet të gjatë të veprës, mirëpo se kur kalohet dhe kur nuk kalohet në kryeradhë, këtë e ka përcaktuar autori, sipas shtjellimit të medimeve nga ana e tij në vepër dhe nuk ka aspak të drejtë as përkthyesi, as redaktori dhe as kurrkush tjetër ta ndryshojë këtë. Po kështu duhet të ndodhë edhe me shenjat e pikësimit, shkrimin me shkronja kursive të fjalëve a fjalive, vënien ose jo të kllapave, vënien ose jo të thonjzave etj. Pra, në të gjitha rastet duhej zbatuar gjithçka me skrupulozitet, siç i ka autori, se vepra është e tija.

F. 53-54: Kanë kaluar pa u përkthyer «о каких-то ...deri в речке и проч.» që do të thotë “për disa të drejta të prerjes në pyll dhe të peshkimit në lumin e vogël e të tjera”, si dhe «и всё ещё...deri границе», pra “dhe ende vazhdonte davaja për të përcaktuar kufirin ndërmjet tokave”. Nuk janë kryeradhë “Papritur...”, “Sipas të gjitha gjasave...”, “Vëlla Ivani dhe Miusovi”, “Pak kohë...”, kurse “Kur mori vesh për takimin...” është kryeradhë, por përkthyesja nuk del me kryeradhë. Për sa i përket “kryeradhës” nuk do t’i përmendim më rastet e tjera në vepër, se janë shumë. Në këto faqe dhe

në shumicën e rasteve «отец игумен» përkthehet “kallogjer”, kur është “atë igumeni” dhe të jepej shpjegimi në fund të faqes që është “ati epror në një manastir të rëndësisë mesatare”, kurse “kallogjer” është thjesht murg ortodoks. Sa mirë në f.134 e përkthen “atë igumeni”?!. Te fjalia «Если кто ...deri съезд» i ka rënë shkurt, sepse përkthimi është “nëse ekzistonte dikush mes këtyre rivalëve dhe grindësve që mund ta merrte seriozisht këtë mbledhje (dhe jo kongres), ky ishte, pa dyshim, vetëm vëlla Dmitrij (nuk përkthen “vëlla” dhe emri është Dmitrij dhe jo Dmitri, siç jepet në të gjithë romanin. Po kështu duhet Dostojevskij dhe jo Dostojevski, Grigorij dhe jo Grigori, Varvinskij dhe jo Varvinski).

F. 73: «послушник» (siç rezulton edhe në f.353) nuk është “dhjak”, por “rishtar”-fillestar në manastir që përgatitet të bëhet kallogjer, kurse “dhjak” është thjesht ndihmës i priftit në kryerjen e shërbesës fetare, pra s’ka të bëjë me manastirin. Lë pa përkthyer një pasazh të tërë: «Это я всё...deri и замолчу» që do të thotë “Gjatë gjithë kohës desha t’ju prekja me dorë, të mësoja nëse ishte e mundur të jetoja me ju. A ka vend për përruljen time pranë krenarisë suaj? Ju jap një fletëlavdërimi: me ju është e

mundur të jetosh! Dhe tani do të hesht, gjatë gjithë kohës nuk do ta hap gojën. Do të ulem në kolltuk dhe do të hesht”.


F. 93-94 dhe 113-114: «старец» do të ishte mirë ta linte “starec”, duke dhënë, në fillimin e përdorimit të kësaj fjale, shpjegimin “murg i shkuar nga mosha” (është tipike ruse si fjalë, kurse “kallogjer” nuk është e saktë, pastaj si «старец», ashtu edhe «игумен» i përkthen “kallogjer” që s’është e saktë, sepse “kallogjer” në rusisht është «монах». Edhe në f.253-254 «старец» përkthehet “kallogjer”, sikurse edhe në f.233, 253, 314, 360 dhe 407. «Половина первого» e përkthen “ora një e gjysmë”, por është “dymbëdhjetë e gjysmë”.

F. 113-114 dhe 133-134: Lë pa përkthyer «как-то...deri сгорбившись», që do të thotë “duke i ngritur aq shumë supet, saqë dukej gati si gungaç”; «орпада» nuk është “porta”, por “muri rrethues, gardhi”, mirëpo në f.11 të vëllimit të dytë këtë fjalë e përkthen mirë “gardh”; përkthen jo saktë “Kam dëgjuar shumë, kam parë nga pak”, jo, është “Kam dëgjuar gjithçka tek luaja rolin tim, dhe pa bërë as gëk as mëk shikoja gjithçka, kurse tani dua t’ju vë në skenë edhe aktin e fundit të shfaqjes”. Këtë ka thënë autori. Ka lënë pa përkthyer «Нет, отцы, с вами тут, пожалуй, в хлыстовщину втянешься...» që do të thotë “Jo, etër, këtu me ju ka rrezik të përfundosh mes hllistëve (хлыст-shufër, purtekë), pra lidhet me një nga sektet fetare në Rusi, që lindi në fund të shekullit XVII-fillimi i shekullit XVIII, i cili nuk pranonte ritet e kishës ortodokse dhe kultivonte vetëfshikullimin me kamxhik. Po pse e ka lënë pa përkthyer? Sepse i ka dalë përpara kjo «хлыстовщина» që e shpjeguam, dhe ka thënë me vete “Kaloje, se s’ka për ta parë njeri”. Po ja që s’është gjëja tënde, që të bësh si të duash.

F. 153-154: Nuk është “krejtësisht i qetë”, por është e kundërta “me gjithë shqetësimin e tij” (при всем беспокойстве); lë pa përkthyer katër vargje të poezisë së Shilerit: “И куда...deri зрит!”, që do të thotë: “Dhe kudo ku Cerera// Hedh shikimin e trishtuar// Sheh kudo njeriun// Në poshtërim të thellë”.

F. 173-175: Është në titull «вверх пятами» që e përkthen “me këmbë përpjetë”, por nuk tingëllon mirë, prandaj duhej përkthyer “kryengulthi” (p.sh. hidhem kryengulthi në ujë), pra që thembrat (пятами) janë lart dhe koka poshtë. Për sa i përket titujve, kemi edhe disa raste të tjera me përkthime të pasakta. Kështu, në f.383 titulli “Hë për hë, jo shumë e qartë” (se çdo presja këtu një zot e di) në origjinal është «Пока ещё очень неясная», domethënë “Hë për hë ende shumë e paqartë”, pra “e errët”, por kur thua “jo shumë e qartë”, nënkuptohet sikur diçka edhe është e qartë, kur në fakt çdo gjë është shumë e paqartë, e errët. Në f. 138, vëll.2, titulli “Ai i mëparshmi” është lënë përgjysmë, sepse është “Ai i mëparshmi dhe i padiskutueshmi” (Прежний и бесспорный). Në f.608, vëll.2, titulli “Një sofist” duhet të jetë rezultat i hasjes së fjalës «мысли» (mendime). Mirëpo këtu «прелюбодей» është «человек, который совершил прелюбодеяние (нарушение супружеской верности)», që do të thotë “njeriu që ka kryer shkelje të besnikërisë bashkëshortore”, pra s’ka të bëjë me “sofistin”. Ka lënë pa përkthyer «да на продаже...deri хорошенько», që do të thotë “mirëpo në shitjen e biletës pesëmijëshe u verifikua një humbje prej dyqind e më tepër rublash. Më dërgoi mua gjithsej dyqind e gjashtëdhjetë, më duket, rubla, nuk e mbaj mend mirë...”.

F. 193-195: harron «то и съедет...deri приказанию», që do të thotë “dhe do të zhytet (mali) pa ngurrar fare, me urdhrin tuaj të parë”. Gjithashtu harron «вот что...»



deri течёт», pra “ai (lumi) që rrjedh (kalon) te ne pas kopshtit”, sikurse harron edhe «Ибо если...deri гора», që do të thotë “Sepse edhe nëse do të ma kishin rrjepur lëkurën deri në mesin e shpinës, edhe atëherë me fjalën time dhe me thirrjet e mia ai mali prapëseprapë nuk do të kishte lëvizur”.

F.213-235: «Смеясь над ним» nuk do të thotë “qeshte me të aq çiltërisht”, por kuptimi është «насмехаться, подвергать кого-нибудь насмешкам», pra “tallej, e përqeshte atë”.

F.253-276: Smerdjakovi kishte dalë për të bërë pazarin e drekës – e gjithë kjo është në kllapa, të cilat përkthyesja nuk i vë. Ka edhe raste kur ndodh e kundërta, pra vihet kllapa, kur në original s’ka kllapa, si në f.13-14 (siç e quanin atëherë të gjithë Fjodor Pavloviçin), ose f.464 (sipas mbresave të njerëzve), apo f.540, vëll.2, (nga trashëgimia e së ëmës) etj. Në f.276 ka gabuar, duke thënë të kundërtën: “dhe...dhe ajo do më shumë Dmitrin!” Në fakt është e kundërta “dhe...dhe ajo nuk e do më Dmitrin!” (и...и она более не любит Дмитрия!).

F.293-295: Tek “vajza, e cila deri tani nuk kishte qëndruar, pa folur, në vendin e saj...” ka thënë të kundërtën, sepse është “vajza, e cila deri në atë çast kishte qëndruar pa folur (e heshtur, gojëmbyllur) në karrigen e saj (dhe jo në vendin e saj)”.

F. 313-316: Lë pa përkthyer «И вот...deri к лучшему», që do të thotë “Dhe ja sepse, ndonëse e gjithë kjo është aq e ndyrë, prapëseprapë do të jetë për më mirë”, si dhe «что если б он...deri деньги», pra “nëse ai nuk do t’i kishte shkelur këto para, por do t’i kishte marrë ato...”, ose «И вот, что...deri примет, а?»», që do të thotë “Dhe ja që me siguri kështu vendosëm tani, që ai paratë do t’i marrë, ë?”

F. 333-336: Përkthehet “Forca centrifugale”, por është forca centripete ose qendërsynuese (центростремительная) dhe jo centrifugale që në rusisht është «центробежная».

Dhe vijmë te kapitulli “Inkuizitori i madh”, ku do të ishte mirë të mos kishte asnjë pasaktësi, sepse kemi të bëjmë me “majat e letërsisë universale”, siç është shprehur Frojdi, i cili ka thënë se “Episodi i Inkuizitorit të madh është një nga majat e letërsisë universale, një kapitull i bukurisë së paçmueshme...”. Por prapëseprapë fatkeqësisht edhe këtu hasim mjaft pasaktësi, të cilat po i rendisim më poshtë. Në f.359 thuhet “...kanë kaluar pesëmbëdhjetë vjet”, jo “vjet”, por shekuj (веков); «но дьявол не дремлет...» në përkthim është “Por djalli nuk flet...” Do të këtë qenë “fle” dhe do të jetë shtuar gabimisht një “t” gjatë punës me përkthimin. Më e saktë do të ishte këtu “nuk dremit” (не дремлет). Në f. 361 përkthen “në vatrat më të nxehta të qytetit jugor”, jo, «стогны» janë rrugë të gjera, sheshe (широкие улицы, площади) dhe jo “vatra”. Pra duhej “në rrugët përvëluese (стогны жаркие) të qytetit jugor”. Në f.380 kjo fjalë përkthehet “mullarët”, pra, siç duket ngatërrohet me «стог-mullar». Fjala “podium” për «автодафе» (autodafe) nuk është aspak e saktë. Autodafe është shpallja solemne e vendimit të inkuizitorit që pasohet me ekzekutimin, djegien për së gjalli mbi turrën e druve të heretikut në Spanjë, gjatë periudhës së inkuizicionit. Pra jo “podium”, por duhej ta linte “autodafe”. Lë pa përkthyer në fund të faqes shprehjen latine “ad majorem gloriam Dei”, që do të thotë “për lavdinë më të madhe të Zotit”. Në f. 362 «восста девица» nuk duhej ta linte “vosta devica”, por ta përkthente “ngrihu vajzë”. Po në këtë faqe gjejmë “Në dorë ajo mban buqetën me lulë”, jo, është “Në dorë ajo mban një buqetë me trëndafilat të bardhë” (букет белых роз), që është detaj i vogël, por i bukur. Në f. 364 “...dhe t’ua

marrësh njerëzve lirinë, për të cilën ti ke këmbëngulur aq fort...”, jo, është e kundërta “dhe për të mos ua hequr njerëzve lirinë” (и чтобы не отнять у людей свободы), se për këtë kishte këmbëngulur Zoti, jo për të kundërtën. Në f. 366 nuk përkthen saktë «и до того угадано и предсказано и до того оправдалось, что...», e ka përkthyer “ishte aq e goditur, aq e saktë, aq e qartë, saqë...”, pra nuk është përkthyer asnjë nga përcaktimet e autorit, i cili thotë “dhe deri në atë pikë është parashikuar dhe parathënë, dhe deri në atë pikë është provuar se është e drejtë, saqë...”. Këtë ka thënë autori dhe jo fjalë të përgjithshme, si “aq e goditur, aq e saktë, aq e qartë, saqë...”. Në f.371 harron «Жаждал ...deri ужаснувшим», që do të thotë “Lakmoje dashurinë e lirë dhe jo entuziazmet servile të skllavit përpara fuqisë që e kishte terrorizuar atë njëherë e përgjithmonë”. Në f.374 pas “një fushe tjetër” lë pa përkthyer «и кончат...deri знамя», që do të thotë “dhe do të përfundojnë duke ngritur kundër Teje flamurin e tyre të lirë. Por Ti e ngrite vetë këtë flamur”. Po kështu në f. 376 “Dixi” nuk duhej lënë pa shpjegim në fund të faqes “Kështu thashë unë” (nga latinishtja), pastaj pas “se do të rebelohen sërish të dobëtit” ka harruar «что разорвут порфиру еë...deri греха», që do të thotë “se do ta shqyejnë pëlhurën e saj të purpurt dhe do ta zhveshin lakuriq trupin e saj “të fëlliqur”. Por atëherë unë do të ngrihem dhe do të të tregoj mijëra milionë fëmijë të lumtur që nuk e kanë njohur mëkatin”. Në f.380 duhej të ishte përkthyer përherë “Gjithçka është e lejueshme”, siç e ka edhe autori «всё позволено» kudo, nuk lëviz kjo, sepse ka të bëjë me botëkuptimin e Ivanit (njërit prej personazheve kryesorë të veprës), është kuintesenca e botëkuptimit të tij, dhe jo të përkthehej herë “t’i lejosh vetes gjithçka”, herë “gjithçka të lejohet” dhe herë “gjithçka lejohet”. Këtu përfundojnë vërejtjet për kapitullin “Inkuizitori i madh”, kapitull, i cili, për madhështinë që ka dhe për pasaktësitë që konstatoam, më detyron t’i them tani dy fjalë për përkthimet e tri kryeveprave të letërsisë ruse të analizuar prej meje gjer më sot: “Krim dhe dënim”, “Doktor Zhivago” dhe “Vëllezërit Karamazov”. Pra, përfundimi është se shtëpitë botuese përkatëse nuk janë në ato lartësi, sa të arrijnë të përkthejnë siç duhet veprat e “gjeneralëve” të letërsisë botërore. Tjetër është dëshira dhe tjetër aftësia.

Afërsisht të kësaj natyre janë edhe pasaktësitë në vëllimin e dytë, por po mjaftohemi duke përmendur vetëm disa raste. Në f.100 gjejmë...nga ai “vend i gjoksit”, jo, thonjëzat fillojnë “nga ai vend i gjoksit” dhe e gjithë kjo është me shkronja kursive, që nuk pasqyrohen. Për sa u përket thonjëzave, ato në disa raste harrohen, nuk vihen, dhe në raste të tjera vihen, kur s’janë në origjinal (shembujt janë nga të dy vëllimet): p.sh. në f.120 “trojkë” nuk është as në thonjëza dhe as në kursiv; në f.160 “mjedisin” nuk është në thonjëza në origjinal, sikurse edhe “mbushte”, kurse “atëherë” është në thonjëza; në f.583 “një pajisje” nuk është në thonjëza etj. Po kështu ndodh edhe me shkronjat kursive. Fjala vjen, janë me shkronja kursive rastet e mëposhtme: në f.356 “edhe po s’pate të drejtë”, në f.357 “për gjithçka”, në f.368 “të gjithë së bashku”, në f.372 “në mrekullinë, në të fshehtën dhe në autoritetin”, në f. 376 “që po ndreqnin heroizmin tënd” është e gjitha me kursive, në f.140 “Të paktën të kishe një shkak” edhe kjo e gjitha me kursive etj. Në f.140 të vëllimit të dytë përkthen “dhe ia dha të qeshurit, disi në mënyrë të pazakontë për të”, duke i rënë shkurt, sepse është «но не деревянным...deri смехом», pra “por jo me të qeshurën e tij të sforcuar e me hope, por me një lloj të qeshure të qetë, të zgjatur,



nervozë, që e shkundte atë”. Si mund të lihen pa u përkthyer si duhet, në detaje, në mënyrë skrupuloze fjalët e autorit, kur pikërisht këtu qëndron bukuria dhe veçantia e mjeshtërisë së stilit të tij mahnitës?! Mos e prek anën më të bukur të këtij shkrimtari, ku ai është e paarrtishëm – përshkrimin *me imtësi*, duke pasur forcën e një psikologu gjenial, të gjithçkaje që ka të bëjë me njeriun dhe me çdo gjë që atë e rrethon. Në f.321 lë pa përkthyer dy vargje “I çuditi ata të klasës së tretë// Lajmi që lloshko Kollbasnikovi u martua”; në f.441, para “Krejt ndryshe qëndronte puna”, harron një pasazh të tërë «напротив...deri утёк-с», që do të thotë “Përkundrazi, nëse hajduti do të kishte qënë një si unë, për shembull, thjesht do ta kishte futur zarfin në xhep, pa humbur kohë për ta hapur atë, dhe sa më shpejt do t’ua mbathte këmbëve”; në f.460, pas fjalëve “është një legjendë”, e ka pasur të vështirë ta përkthejë dhe nuk e ka përkthyer «За что купил, за то и продал», që është një fjalë e urtë ruse, e cila do të thotë «только повторяю то, что слышал» (veç përsëris ç’kam dëgjuar) dhe këtu duhej përkthyer “Po ta tregoj siç ma kanë treguar”. Dhe tani disa pasaktësi gjuhësore dhe drejtshkrimore: në f.33 jo personale, por personal, dhe jo e rëndësishme, por i rëndësishëm (sepse të dy mbiemrat lidhen me emrin shqetësim); f.53 “me se bepin se të biseduar” duhej “me se bepin për të biseduar”; vë presje kot se koti, p.sh., f.53 “Gjithsesi, kallogjeri”, ose, po në kete faqe “madje, u caktua”; përdoret “ndaj” në vend të “prandaj” (f.73) “ndaj u gëzua” (vetëm në raste të rralla “ndaj” mund të përdoret për “prandaj” si, p.sh., “të dua të mirën, ndaj të thashë”); “Fjodor Pavloviçi, (ç’do presja këtu?)” “nuk u durua”, duhej “s’iu durua” ose “nuk iu durua”; f.93 “një farë” duhej shkruar bashkë “njëfarë” si përemër që është (në shumë raste të tjera është shkruar si duhet, pra bashkë); “shpesh herë” duhej bashkë “shpeshherë” si ndajfolje që është; në f. 154 hasim “vëllain” dhe “babain”, por duheshin shkruar “vëllanë” dhe “babanë” (“vëllain” e gjejmë edhe në f.640, vëll.2); f.174 “Plaka...iu gëzua Katerinës” (ndikohet nga rusishtja «Kate обрадовалась», por në shqip duhej “u gëzua për Katerinën”; f.175 “sipas këndvështrimit tuja” duhej “tuaj”; f.194 “ju besoni qa shumë”

duhej “aq”; f.214 “me hapa të shpejta” duhej “ma hapa të shpejtë”; f.194 “tek fshatari”, f.215 “tek vetja”, f.253 “tek llogaritë”, “Tek babai”, f.369 “tek jeta”, “tek qëllime”, f.100, vëll.2, “tek sheshi”, f.129, vëll.2, “tek dyqani” etj., në të gjitha këto raste duhej “te”, sipas rregullit që trajta “tek” perdoret zakonisht kur fjala ndjekëse nis me zanore dhe trajta “te”, kur fjala nis me bashkëtingëllore. Në f.274 “më momentin” duhej “në momentin”; f.293 “duke ju drejtuar” duhej “duke iu drejtuar”; f.314 “ai u ndje i fyer” duhej “u ndie”, po aty “hapi zemrën qa çiltërisht” duhej “aq”; f.334 “Europë” duhej “Evropë” dhe po kështu në f. 541, vëll.2, “europiane” duhej “evropiane”; f.368 “përgjatë shekujve” duhej “gjate shekujve”, sepse “përgjatë” përdoret kur tregohet vend dhe jo kohë (p.sh. përgjatë lumit, përgjatë bregut etj.); f.369 “jepte jetën e vet për ratal” duhej “për ata!”; në f.370 “për një minut”, duhej “minutë” dhe e hasim “një minut” edhe në f.181, vëll.2, si dhe në f.449, vëll.2; f.372 “po iu prinin” duhej “po u prinin”; f.375 “dhe iu mësove” duhej “u mësove”; f.379 “përgjigja” duhej “përgjigjja”; f.383 “edhe pse ndjente në shpirt” duhej “ndiente” dhe po këtu “prapë se prapë” duhej bashkë “prapëseprapë” si ndajfolje që është; e hasim edhe në vëll.2, f.80 “prapë së prapë”; f.443 “ndjehesha” duhej “ndihesha”; f.160, vëll.2 (me tutje janë faqet e vëll.2) “iu bënte komplimente të gjithëve” duhej “u bënte”; f.180 “nguli këmbë si mushk” duhej “mushkë”; f.260 “proces-verbalit” duhej bashkë “procesverbalit”; f.280 “sado pak” duhej bashkë “sadopak” si ndajfolje që është; po aty “shtatzaninë” duhej “shtatzënësinë”; f.301 “ndërgjegja” duhej “ndërgjegjja”; f.343 “mëndjelehtësia” duhej “mendjelehtësia”; f.360 gjejmë pranë e pranë “pa pritur” që është gabim, dhe pak më poshtë (çudi!) “papritur” që është mirë; po aty “diplomaci” dhe “diplomat” duhej “diplomaci” dhe “diplomat”; f.440 “kopësht” duhej “kopsht”; f.460 “tregëtarëve” duhej “tregtarëve”; f.462 “tepëroj” duhej “teproj”; f.481 “u muar” duhej “u mor”; f.560 “ai...heshtëte” duhej “heshtë”; f.620 “nëqoftëse” duhej veç “në qoftë se” si lidhëz që është; f.640 “rojet” duhej “rojat”, sepse kemi të bëjmë me rojtarët, pra rojë-a dhe shumë roja, rojat, kurse roj, roji është luzma e bletes që ka për shumë roje, rojet.



Niklas Holmgren (pikturë në vaj)
Lotta Törnroth (seri me 6 fotografi)

Ekspozita “Fotonet. Nga qielli drejt detit” REALJA POETIKE MES DY KALTËRSIVE

Nga Alisa VELAJ

Ekush mund ta mbushë më mirë se pafundësia, atë hon të shpirtit dhe mendimit që lind prej pikëpyetjeve të shpeshta si rrebeshe? Jetojmë në kohë furtunash, apo jemi ne qeniet humane që i trazojmë vetë furtunat? Cilado të jetë alternativa e saktë, një gjë mbetet përherë e pandryshueshme; koha dëshirore e foljeve shkon përherë drejt urimit. Ne urojmë të kthellohemi. Në dete të qetë dhe qiej të kaltër. Kërkojmë dritë. Dikur në shtratin e vdekjes Gëtja këndonte “Mehr Licht!” Nga Europa Verore, ku duket se kushtet klimaterike e kanë shndërruar ëndrrën e diellit gati në mit, përpjekjet drejt Shën Dritës kthehen në një odise të mrekullueshme, për të ngjizur në thellësitë e vetjeve, ato që më ka pëlqyer përherë t’i quaj “invisible fires”, apo zjarre të padukshme.

Ekspozita “Fotonet. Nga qielli drejt detit”, siç shkruhet në doracakun e përgatitur për vizitorët, “është një ekspozitë që bën bashkë gjashtë artistë dhe nëntë vepra arti të përzgjedhura nga artistja Donika Çina, organizuar nga Galeria e Bregdetit, Radhimë, Vlorë dhe me mbështetjen e Sëedish Art Grants Committee”. Artistët suedezë që na ftuan në këtë zbulim të dritës janë; Johan Österholm, Niklas Holmgren, Ylva Carlgren, Mikaela Steby Stenfalk, Sjoerd ter Borg dhe Lotta Törnroth. Artistët erdhën në qytetin e Vlorës pas një ekspozite të hapur në kryeqytet. Kuratorja e ekspozitës, znj. Donika Çina ishte impresionuese në mënyrën se si ia prezantonte veprat secilit prej vizitorëve. Një ekpozitë ku krahas fotografisë e pikturës, mbartej dhe kaq shumë poezi. Si poete, unë do të do të ndalem tek kjo e fundit.

Në fotografitë e Lotta Törnroth-it, i gjithë thelbi i asosacionit që koleksioni i fotografive ngjiz tek vizitori gjendet në titullin që vetë Lotta i ka vënë koleksionit të saj. Seria e fotografive pagëzohet “I èait as a Lighthouse” (Unë pres si një far). Në vetëdijet tona fari tregon drejtimin e duhur të anijeve në lundrim. Atëherë

pse artistja e shpall veten një far dhe në pritje të kujt është ajo? Törnroth-i, siç më shpjegon plot pasion kuratorja Çina, zgjedh të fotografojë me një dritë në dorë, në ato vende ku sapo ka ndodhur një tragjedi. Pra, Törnroth-i përmes farit simbolizon gjetjen e udhëve të dritës, kur qenien e ka mbytur pikëllimi. I vetmi far i duhur për t’u drejtuar është Shën Drita. Vetëm aty zemra e lënduar largon ngadale errësirën e dhimbjes për t’u përtëritur. Në serinë e fotografive shfaqet një siluetë që duket se mban në duar një diell të vogël. Kjo siluetë herë shfaqet buzë detit, herë në skajin e një porti detar, herë në mes të një lëndine ku bie në sy një pemë e vetmuar, herë në një tjetër lëndinë me gjelbërim shumë të rralluar, herë në brigjet e ujërave boreale dhe herë në buzë të një shkëmbi shumë të rrezikshëm. Në secilin peizazh ka ndodhur një tragjedi. Ndaj kudo fotografia mbjell një diell shprese. Impresionuese veçanërisht është imazhi ku silueta me diellin ndër duar shfaqet në buzë të shkëmbit. “Ndërtoje shtëpinë tënde mbi shkëmb që themelet e saj të jenë sa më të forta”, shkruhet në një varg biblik. Lotta Thörnroth e ngre gjithashtu mbi këto lloje themelesh artin e saj.

Interesante vjen poezia edhe përmes tablove të artistes Ylva Carlgreen, por në një këndvështrim krejt tjetër. Tablotë e saj na paraqesin një epikë të mjegullës, që e fsheh dritën, duke na lënë të perceptojmë një dritë të fshehur, por po ashtu “një dritë të zeze”. Mjegullimi është sa në favor të kthjellimit, sa në funksion të turbullimit. Efektin “mjegull” nuk mund ta sjellë askush më qartë, sesa një artiste nga atdheu i mjegullave, Suedia. Ylva Carlgreen e ndjell soditësin, që jo vetëm t’i sodisë mjegullat, por edhe të fillojë t’i kuptojë ato si njerëzit. Të di t’i lexojë alfabetet e tyre, t’u njohë kodet e fshehta. Nuk ka asnjë tablo ku mjegulla të jetë krejt e shpërndare. Në rastin më të mirë, imazhi evokon një mjegull më të ndriçuar nga një dritë përbrenda. “Mjegullat nuk shpërndahen dot kurrë plotësisht”, apelon Ylva. Na mbetet kështu të mësojmë si t’i

lexojmë. Për të ndezur një dritë brenda tyre; përndritjen tonë të harruar. A s’është vetë harresa mjegulla më e trishtë?

Qiejt e Johan Österholm-it të lënë në një mëdyshe, ku gjendja dritë e kthjellët-dritë e mjegulluar, të krijon një mëdyshe dhe habi trishtëmbël. Kuratorja Çina jep ketë sqarim në doracak: “Yjet që nuk janë më të dukshëm për syrin tonë për shkak të ndotjes së tanishme prej dritës, janë fiksuar në xhama fenerash me gaz të lyera me xhelatinë argjendi”.

A na rrëfejnë këto imazhe se pikëvështrimi ynë duhet të jetë maksimalisht i kthjellët për të përkapur dritën e yjeve? A jemi fare të vërtetë nëse pikasim në mënyrën e duhur dritën e një ylli?


Niklas Holmgren-i na dhuron dy piktura që në pamje të parë duket identike, por në “lexime të tjera” shohim se ato paraqesin qenie të njëjta, por në sfone të përkundërta. Një femër e dëshpëruar dhe përkrah saj një bashkëudhëtare që duket që nuk di çdritë t’i dhurojë bashkëudhëtares se saj për t’i dhuruar dritën e lumturisë. Të dyja duke medituar mbështjellë nga drita natyrale. Në pikturën tjetër drita duket e përflakur. Është vallë një dritë artificiale, që largon dritën e vërtetë dhe nuk i lë qeniet të jenë të lumtura? A është kjo e kuqe flakëruese mendimi i zjarrtë që do të gjejë përgjigjen nga vjen lumturia e shpirtit? Tabloja nxit perceptime të panumërta.

Evokimi i gjendjeve të mia poetike merr fund këtu. Punët e Mikaela Steby Stenfalk përkrijnë me dije të panjohura për formomin tim. Donika Çina shkruan kështu rreth punëve të Stenfalk: “E kundërta ndodh me punët e Mikaela Steby Stenfalk. Puna e saj fillon nga dhe ju drejtohet të tjerëve. Fotografia nuk është mediumi, as thjesht një influencë, por burimi dhe materiali




bazë i punëve të saj. Këtu nuk kemi të bëjmë me historinë e fotografisë, edhe pse ajo përdor shumë material arkivor, se sa me të tashmen e saj dhe atë që përbën arkivin digjital. Në një bashkëpunim me artistin Sjoerd ter Borg, në një instalacion audiovisual, artistët hulumtojnë mbi atë çka njerëzit lënë online kur eksplorojnë një qytet dhe se si këto gjurmë na joshin kur eksplorojmë të “njëjtën”.

Kjo ekspozitë, organizuar kaq bukur dhe me shpjegime të mrekullueshme prej kuratores, ku secili prej kundruessve ndihet komod në këndvështrimin e vet, uroj të çelë udhën e të tjera ekspozitave prej artistëve suedezë, duke vendosur kështu ura komunikimi kulturor mes dy popujve tanë. Sepse të gjithë ne, pavarësisht asaj, sa të ndryshëm jemi, ndjehemi njësoj të etur për thirrjen “Mehr Licht!”.



Johan Österholm (xhama feneri me gaz ku janë printuar pamje nga yje që nuk i shohim më për shkak të ndotjes nga drita)



Lotta Törnroth (instalacion)

Mustafa Greblleshi dhe kujtimet e tij për vitet 1939-44

Nga Shpendi Topollaj

Mustafa Greblleshi, autor i një romani aq të lexuar, me titullin “Gremina e dashurisë”, botuar në vitin 1943 dhe pastaj me “Albumi i një bojaxhiu” (1960) apo përkthyes aq i talentuar i disa shkrimtarëve të shquar, ai ishte bërë i njohur dhe i dashur për këdo qysh para çlirimit të vendit. Ishte bërë i tillë, kryesisht me artikujt e tij plot kulturë, për mprehtësinë e gjykimit në analizat e tij, kurajon për të demaskuar të keqen dhe për dashurinë për atdheun, të cilin e donte të ndërtuar mbi baza demokratike dhe qytetërimi. Por kur pa se pas çlirimit, në Shqipëri u instalua një regjim sa i padrejtë aq dhe gjakatar, kur u bë dëshmitar i arrestimit dhe zhdukjes së babait të tij (të cilit kurrë nuk iu gjet varri), që ishte njeriu më paqësor që pati njohur, kur përjetoi vetë vuajtjet e burgut, ku as nuk dinte pse kishte hyrë dhe pse do të dilte, sikurse shprehet për të Ismail Kadareja, ai normalisht që u ndie i fyer dhe i zhgënjyer, aq sa e gjeti më të udhës ta braktiste artin e të shkruarit dhe të kapte furçën e pompën për të lyer shtëpitë e kujt të mundte, ndofta edhe duke i lënë të habitur e me gojën hapur të gjithë ata që i prisnin me interes artikujt e tij, me nënshkrimin Liu i Cakeut, në gazetat e një periudhe të rëndë që diktonte pushtimi fashist. Pas kësaj, sikurse shprehet shkrimtari ynë gjenial Ismail Kadare “Mustafa Greblleshi nuk u përmend më asnjëherë si shkrimtar gjersa vdiq i harruar...” Ai mbylli sytë vetëm një vit pas diktatorit tonë, që mbante si atribut jo mburojën, skeptrin dhe çekanin si në mitologji, por drapërin e çekanin, për të prerë koka e për të shtypur këdo që i mbushej mendja. Nuk i mbeti tjetër, veçse të hidhte në letër kujtimet e së shkuarës, duke u kujdesur të mos e prekte sado pak politikën zyrtare, e cila çuditërisht ishte më e egër edhe nga ajo e pushtuesve. Por këto janë gjëra të njohura, dhe nga ana tjetër, Ismaili i sqaron aq bukur e bindshëm në parathënie. Prandaj, do përpiqem të jap përshtypjet e mia dhe gjithë admirimin tim për këtë njeri dhe intelektual, tek i cili ishin bashkuar aq mirë horizonti i gjerë me dëshirën e sinqertë për ta vënë atë në shërbim të popullit. Për këtë shkrimtar dhe gazetar fatkeq që edhe pas botimit të këtij libri kaq domethënës, thuaje i ka shpëtuar vëmendjes së kritikës tonë. Periudha ku e çojnë dhe na çojnë kujtimet e Mustafait ka qenë mjaft e trazuar për fatet e kombit shqiptar. Ai qe nxënës gjimnazi kur erdhën ushtarët e Musolinit dhe u bashkua me revoltën e përgjithshme, ku dhe plagoset dhe me atë që dhëndrri i Duçes, Konti Çiano e raportonte: “Në fytyrat e zymta të shqiptarëve dukej hapur urrejtja e shfrenuar që kishin për ne.” Atij i kishte mbetur në mend veprimi i të riut Xhemal Rexha i cili sapo kishte kryer akademinë ushtarake, vrau veten kur pa se italianët pushtuan vendin e tij. Po ashtu, një përshtypje të madhe i bëri mbyllja e bibliotekës “Karnavon”, të cilën ai e shihte si tempull të shenjtë, ku shlodhte mendjen e shpirtin. Në Tiranën e atyre viteve, edhe pse luftë, jeta vazhdonte. Vetë Mustafai, pas traumës që pësoi i ati oficer dhe mbylljes së tij në vetvete, i duhej të ndiqte shkollën apo edhe të punonte për të mbajtur familjen. Fillimisht, duke qenë se zotëronte gjuhë të huaja, e gjen të udhës të shoqërojë të sëmuret e pashpresë, sidomos nga tuberkulozi që bënte kërdrinë, në spitalet jashtë shtetit. I dhemb në shpirt vuajtja dhe vdekja e djemve dhe vajzave të reja. Ato fytyra të verdha, në ngjyrën e vdekjes, dhe ata sy me vështrim të shuar nuk do t’i harrojë kurrë. Ndërkohë, i mundësohet një vend si bashkëpunëtor dhe redaktor gazetash si “Njeriu”, “Tomori”, “Bashkimi i Kombit”, “Roja kombëtare”, “Shqipnia”, e Radio Tirana. Qe

një punë mjaft e pëlqyer, ku veç të tjerave, i krijoi rastin të njihej me mjaft figura të rëndësishme të kryeqytetit, jo vetëm të gazetarisë, letërsisë dhe artit, por edhe të politikës. Disa prej tyre ishin Haki Stërmilli, Stefan Shundi, Astrit Delvina, Vasfi Samimi, Kristo Frashëri, Xhelal Mitrovica, Kostandin Kote, Kamber Qafmolla, Gjergj Bubani, Ibrahim Kodra, Timo Dilo, Fiqiri Llagami, Mitrush Kuteli, Vangjel Kota, Selman Vaqari, Gjergj Dako, Beqir Valteri, Tefta Tashko, Kristaq Antoniu, Qazim Mulleti, Xhelal Staravecka, Cafo Beg Ulqinaku, doktor Sadedini, Leonidha Naçi, Kika Sherko, Tasim Bishqemi, Stavri Leka, Halit e Hasan Jero, etj. etj. Ai në libër, flet për ta dhe përpiqet të jetë sa më objektiv në portretizimin që u bën. Fjala vjen, kur përmend njerëz si av. Myzafer Pipa, Qemal Draçini e ndonjë tjetër, e pohon hapur miqësinë me ta, por për faktin se regjimi i kishte goditur keq, deri dhe burgosur e pushkatuar, shprehet se jam trishtuar shumë për tragjedinë që u ndodhi. Në faqet e librit me fjalë të kursyera jepen ndodhi e skena herë komike e herë serioze, ku dallon mençuria dhe sidomos erudicioni i këtij autori. Ngjarjet në skenën e luftës së dytë botërore, zhvillimet në Itali, Gjermani apo dhe në Shqipëri jepen me një saktësi e kthjelltësi të habitshme. Vetë autori del nga situata falë një zgjuarsie e gjakftohtësie të pazakontë. Kështu, kur atë e çojnë te koloneli i kuesturës Fiorito për një shkrim humoristik për tabelat e dyqaneve, emrat e të cilëve shkruheshin në gjuhë italiane, ai e zbut inatin e tij, duke i kujtuar humoristin e madh Trilussa dhe pastaj duke i deklamuar pjesë pafund nga komedia Hyjnore e Dantes dhe duke e mbyllur me vargjet lapidare të Fishtës: Edhe atij ju thaftë goja / Që përbuz këtë gjuhë hyjnore, / E n`gjuhë tjetër, kur s`asht nevoja / Flet e t`veten len mbas dore. Greblleshi na e jep Tiranën dhe gjendjen ekonomike dhe shpirtërore të banorëve të saj gjatë atyre viteve, me besnikëri të pasqorë dhe duke u mbështetur nga hotel “Dajti” deri rrotull pazarit të Vjetër. Mjaft të goditura janë bisedat e tij plot mprehtësi si me njerëz të zakonshëm, por me nuhatje të çuditshme, ashtu edhe me kolegë, si për shembull me sekretaren Meri, ku spikat niveli i lartë i kompletimit të tyre me dije rreth fushave të ndryshme e sidomos ndaj letërsisë botërore. Janë mjaft interesante pjesët ku ai bën fjalë për vizitat e tij jashtë shtetit, si në Itali, ku duke bledhur rrugëve, sodiste gjurmët e Perandorisë së lashtë Romake, ku i faniten hijet e Çezarit, Pompeut, Neronit, Brutit e Polipit me shokë. Ai i njeh mirë ata dhe sikur kërkon vendin ku Flaviusi, ai komandanti trim i dënuar me vdekje, para se të vendoste kokën në trug i tha xhelatit: “Ku të gjetën ty që nuk ke fare nishan?” dhe që s`u gabua, pasi Nigerit ju desh ta qëllonte me sopatë disa herë. Atë, kudo që shkonte e ndiqnin pas shëmbëlltyrat e njerëzve të mëdhenj që ai vend kishte nxjerrë që nga Ovidi e filozofi Boeci e deri te poeti, dikur skllav, Andronik Livio që pat përkthyer “Odisenë”. Kudo sikur ndesh fjalët e idhullit të borgjezisë liberale Volterit që shprehej se “Romakët kanë qenë një popull i vogël piratësh. Ligjet dhe kulturën i kanë marrë nga grekët.” Dhe për këtë, bindet kur shkon vetë me një delegacion në Selanik e Athinë, pranë Kryqit të Kuq



Ndërkombëtar për të siguruar ndihma për popullin e tij që lufta e kishte çuar në mjerim dhe varfëri të plotë. Dhe sa i lumtur ndihet ai kur këto ndihma sigurohen. Këtu, pra në kapitullin e kësaj vizite, stili i Mustafa Greblleshit arrin majat, erudicioni i tij merr përmasat e vërteta. Vështirë që dhe vetë intelektualët grekë ta njihnin më mirë trashëgiminë e tyre mitologjike. Periudha e komunizmit u mundua të na rrënjosë bindjen se mitologjia greke, natyrshëm është një releks i perceptimit të jetës në çdo aspekt të saj, por që pasqyron një periudhë të përcaktuar qartë. Kurse Greblleshi e shihte atë si një fenomen që do të na ndiqte pas gjithë jetën me mësimet e veta të vyera. Ai e lidhte atë me filozofinë që grekët e vjetër formësuan dhe me dramat e tragjeditë që korifejtë e atij vendi nxorrën në dritë dhe që do të përsëriteshin pambarimisht. Ai pra, jo më kot, kur ndodhet në Akropol, thotë: “Si duket, sytë e të huajve dinë ta sodisin më mirë dritën e Greqisë.” Ai e njeh shkëlqyer historinë e Greqisë që nga Platoni e Sokrati e deri në ditët tona. Ai njeh burrat e shtetit, që nga Kekropi, Ereteu, Pisistrati, Themistokliu e Perikliu dhe arkitektët, skulptorët dhe piktorët si Fidia, Panenos, Alkamesi, Kresilau, Kalikrati etj. Dhe shkruan si një enciklopedist i vërtetë, si një europianist i mirëfilltë. Mustafai ndien krenari kur miku i tij i ri, gazetari Stratis Steriopullis, i mrekulluar nga sa dëgjonte nga goja e tij, e çon te statuja e krijuesit të parkut “Zapion” dhe disa shkollave të dhëna si dhuratë Greqisë, katundarit nga Labova dhe i thotë se ky njeri dikur i varfër, pasi u ndesh me Zanën e fatit, dhe u pasurua si aksioner vajguresh në Rumani, caktoi një fond për djemtë e fshatit të tij të krishterë dhe të Picarit muhamedan që çdo vit të dërgonin nga pesë të tillë për t`u arsimuar. Dhe pasi sillet e përsillet në pafundësinë e pyllit kulturor grek, Mustafa Greblleshi nuk harron të kujtojë se zonjusha Marianthi kur e ftoi që të merrte pjesë në kremtimet e Delfit, i shpjegon se fjala greke “adhelfi” donte të thoshte vëllezër. “Pra, qëllimi i kremtimeve të Delfit ishte vëllazërimi i njerëzve.” Po ashtu, ai nuk lë pa përmendur fjalët e tjera të grekes me buzëqeshje dhe sy të bukur Marianthi Alendrinos se “Historiani Mendelssohn Bartholdy historinë e Rilindjes Greke e nis nga Ali Pasha. Marko Boçari, hero i indipendencës greke, është gjithashtu shqiptar. Amalia, e para mbretëreshë e Greqisë, fliste shqip me shkrimtarin filoshqiptar doktor Reinhold. Kryepeshkopi i Negropontit e përktheu në shqip ungjillin dhe i tha Othonit, të parit mbret të Greqisë: “Alvanon arkeis, Megaliotate”, pra “Mretëron te shqiptarët, Madhëri. Dhe kur miku i tij Rexhep Mitrovica, sekretar në ministrinë e Kulturës e cakton të shkojë në Kosovë për të parë Pejën e shndërruar në gërmadhe nga avionët aleatë, Mustafai sa nuk vë shpirtin e tij në fjalët që shkruan pena. Po ndalem vetëm te një rast. Kudo që shkonin, njerëzit prisnin në radhë për t`i marrë anëtarët e delegacionit nga Tirana për drekë a darkë. “Në Prizren, një burrë i gjatë, i heshtur e hijerëndë (të tillë ishin në përgjithësi kosovarët), iu vardis shumë Cafo Beg Ulqinakut që t`i bënte një nder të madh; të shkonim tek ai për drekë ose darkë. Dhe, kur Cafo Begu, duke falenderuar, i tha se ftesa të tilla i kishin bërë qindra të tjerë dhe se nuk dinte se kujt t`ia prishte e kujt t`ia ndreqte, kosovari ia priti me një ton që nuk i kundërshtojte dot: - Atëherë, ju pres nesër as për drekë as për darkë, por për mëngjes. Nuk besoj t`i ketë shkue kuj mendja me ju ftue për mëngjes, se nuk e kena zakon. - Dhe autori vazhdon më tej: - Nuk më harrohet mëngjesi që kemi ngrënë në atë shtëpi të qetë e të pastër të Prizrenit, qytetit të Lidhjes së famshme. Shtëpia ishte ndën kalanë, e kredhur në gjelbërim. Tryezat ishin shtruar në oborr, ndën një pjergull të madhe, të mbushura me mishra të pjekur, paçe, byrekë e ëmbëlsira që nuk bëhen as në dasma.” Pavarsisht sesa u përpoqa të bëj të pranishme nga krijimtaria e paktë e këtij autori që talentin ia prenë në mes, për ata që nuk kanë arritur ta njohin ose të paktën, ta lexojnë librin e tij, botuar kryesisht nën kujdesin e Anna Shkreli (Greblleshi), në mbyllje dua të kujtoj se ashtu sikurse thosh Antoine De Sant - Exupery se “Përsosmëria arrihet jo kur nuk ke asgjë tjetër për të shtuar, por kur nuk ke asgjë tjetër për të hequr.” Dhe nga ajo që na la ky autor, aq i dashur dikur, por ende në hije sot, nuk ka asgjë të tepërt, ndaj si i tillë, Mustafa Greblleshi, ashtu si Migjeni e ndonjë tjetër, me pak fletë, na la kujtime të mrekullueshme dhe ndriçoi një periudhë të errët të historisë tonë që jemi mësuar ta rëndojmë me kolaboracionistë e tradhtarë. Po ashtu, gazetarë, shkrimtarë dhe atdhetarë të tillë kanë meritën e njohjes dhe përhapjes nga të parët të kulturës perëndimore, ç`ka përbën kushtin themelor mbi të cilin ngrihet e drejta jonë e padiskutueshme për t`u përfshirë si të barabartë në familjen e sotme europiane.



Haruki Murakami ÇASTI KUR U BËRA ROMANCIER

Letërsia që lindi në tryezën e kuzhinës

Shumica e njerëzve, dua të them shumica prej nesh që jemi pjesë e shoqërisë japoneze, mbarojnë shkollën, pastaj gjejnë punë, pasi të ketë kaluar ca kohë, martohen. Edhe unë fillimisht kam dashur ta ndjek këtë model. Ose të paktën kështu imagjinoja se do të ndodhnin gjërat. Megjithatë, në realitet në fillim u martova, pastaj fillova të punoja, pastaj (disi) më në fund arrita të diplomohesha. Me fjalë të tjera, rendi që ndoqa ishte krejtësisht i kundërt nga ai që quhej normal.

Meqenëse e urreja idenë për të punuar në një kompani, vendosa të kem një vend timin ku njerëzit mund të shkonin të dëgjonin disqe me këngë xhaz, të pinin një kafe, të hanin vakte të lehta dhe të pinin. Ishte një ide e thjeshtë, ku rafsha mos u vrafsha: mendova se drejtimi i një biznesi të tillë do të më linte kohë të çlodhesha duke dëgjuar muzikën time

të parapëlqyer nga mëngjesi deri në darkë. Problemi ishte se qëkur u martuam duke qenë ende në universitet, s’kishim para. Prandaj, gjatë tre viteve të para, që të kursenim sa më shumë të mundeshim, bashkë me time shoqe punuam si skllëvër, shpesh duke bërë disa punë në të njëjtën kohë. Pas kësaj, bëra mora hua gjithçka që miqtë dhe familjarët mund të kursenin. Morëm të gjitha paratë e mbledhura dhe hapëm një klub të vogël në Kokubunji, një zonë studentësh në periferinë perëndimore të Tokios. Ishte viti 1974.

Asokohe kushtonte shumë më pak për të hapur një biznes tëndin sesa tani. Të rinjtë si ne ishin të vendosur të shmangnin me çdo kusht “jetën e kompanisë” dhe po hapnin dyqane të vogla ku të mundnin. Kafene dhe restorante, dyqane të shumëllojshme, librari - çfarëdo që u vinte në mendje. Disa vende pranë nesh kishin pronar dhe

drejtoreshin nga moshatarët tanë. Kokubunji ruante një atmosferë të fortë kundër-kulturore dhe shumë prej atyre që silleshin vërdallë në zonës ishin nga ata që kishin braktisur lëvizjen studentore që tkurrej. Ishte një epokë kur, në të gjithë botën, mund të gjendeshin ende çarje në sistem.

Solla pianon time të vjetër nga shtëpia e prindërve të mi dhe klubi filloi të kishte muzikë gjatë fundjavave. Disa muzikantë të rinj të xhazit jetonin në zonën e Kokubunji dhe me kënaqësi (mendoj unë) luanin për shumën e vogël që mund t’u paguanim. Disa u bënë muzikantë të njohur, ndonjëherë i shoh në klubet e xhazit në Tokio edhe tani.

Edhe pse po bënim atë që na pëlqente, pagimi i borxheve ishte luftë e vazhdueshme. I kishim borxh bankës dhe po ashtu edhe njerëzve që na kishin mbështetur. Në një rast, të zhytur në mendime për pagesën tonë mujore në bankë, bashkëshortja ime dhe unë po ecnim me kokën ulur, natën vonë, kur hasëm disa para në rrugë. S’e di nëse ishte rastësi fatlume apo ndonjë lloj ndërmjetësimi hyjnor, por shuma ishte pikërisht ajo që na duhej. Meqenëse pagesa duhej të bëhej ditën tjetër, ngjante vërtetë si shfuqizim dënimi në minutën e fundit. (Ngjarje të çuditshme si kjo kanë ndodhur në caste të ndryshme në jetën time.) Shumica e japonezëve me siguri do të bënin gjënë e duhur dhe do t’i kishin kthyer paratë në polici, por ne ishin në zgrip dhe s’mund të jetonim duke vepruar sipas këtyre ndjenjave të mrekullueshme.

Sidoqoftë ishte qejf. S’ka dyshim për këtë. Isha i ri dhe në moshën më të mirë, mund të dëgjoja muzikën time të parapëlqyer gjatë gjithë ditës dhe isha zot i pronës time të vogël. S’më duhej të shtyhesha në trenat e udhëtarëve, të merrja pjesë në takime që ta bënin mendjen dhallë, ose të duroja një shef që s’më pëlqente. Në vend të kësaj, kisha mundësinë të takoja njerëz të ndryshëm, jashtëzakonisht interesant.

Kështu në të njëzetat u mora me pagesat e huave dhe bëja punë të rënda fizike (përgatisja sanduiçe dhe pije koktejl, dhe u tregoja derën klientëve që s’i vinin fre gojës) nga mëngjesi në darkë. Pas disa vitesh, pronari ynë vendosi ta rinovojë ndërtesën në Kokubunji, kështu që u zhvendosëm në një ndërtesë më të kohës dhe me hapësirë më të madhe pranë qendrës së Tokios, në Sendagaya. Vendndodhja jonë e re kishte hapësirë të mjaftueshme për një piano të madhe, por pagesa rritej prej kësaj. Kështu që gjërat s’ishin më të lehta.

Duke kthyer kokën pas, gjithçka që mbaj mend është se sa shumë kemi punuar. Ma merr mendja se shumica e njerëzve kanë një jetë deri diku të qetë në të njëzetat, por ne praktikisht s’kishim kohë për të shijuar “ditët pa kokëçarje të rinisë”. Mezi ia dilyn. Atë kohë të lirë që kisha, e kaloja duke lexuar. Bashkë me muzikën, librat ishin gëzimi im i madh. Pavarësisht se sa i zënë, sa i rraskapitur isha, apo nëse kisha mbetur trokë, askush s’mund të më pengonte të shijoja këto kënaqësi të miat.

Ndërsa u afrova fundit të njëzetave, bari ynë i xhazit në Sendagaya, më në fund, filloi të tregonte shenja qëndrueshme. E vërtetë, s’mund të rrinim ulur dhe të çlirët, ende kishim para për të paguar, dhe shitjet kishin uljet dhe ngritjet e tyre, por të paktën gjërat dukej se kishin marrë drejtim të mirë.

Një pasdite të ndritshme të prillit në 1978, ndoqa një lojë bejsbolli në stadiumin Jingu, jo shumë larg nga ku jetoja dhe punoja. Ishte hapja e sezonit të Ligës, ndeshja e parë në orën një, ekipi i *Yakult Swallows* kundër *Hiroshima Carp*. Tashmë isha një tifoz i *Swallows*, kështu që nganjëherë shkoja të shihja ndonjë ndeshje sa për të bërë një zëvendësim, si të thuash, në vend që të dilja shëtitje.

Atëherë, *Swallows* ishin ekip shumë i dobët, me buxhet të vogël dhe u mungonin lojtarët e shquar dhe me emër. Natyrisht, s’kishin tifozeri të madhe. Mund të ketë qenë ndeshja hapëse e sezonit, por s’kishte vetëm disa tifozë ulur matanë rrjetës rrethuese të fushës. U ula dhe u rehatova për të parë ndeshjen pasi mora një birra. Asokohe s’kishte ulëse si sot, vetëm një shpat me bar. Qielli ishte me një blu të thellë, birra e ftohtë sa s’ka, dhe topi mrekullisht i bardhë në dallim me fushën e gjelbër, të gjelbrën kishte kohë që s’ma zinin sytë. Për *Swallows* në fillim gjuajti Dave Hilton, një i sapoardhur thatanik nga SHBA, krejt i panjohur. Ishte ai që gjuajti topin e parë. Ia pasoi Charlie Manuel-it, i cili më vonë u bë i famshëm si menaxher i ekipeve Cleveland Indian dhe Philadelphia Phillies. Atëherë ai ishte shtatmadh i vërtetë, i fuqishëm dhe tifozët japonezë e quanin “Demoni i kuq”. Mendoj se topin e parë nga Hiroshima atë ditë e gjuajti Yoshiro Sotokoba. Yakult mbulonte Takeshi Yasuda-n. Në fund të radhës së parë të gjuajtjeve, Hilton përplasi topin e parë të Sotokobas në anën e majtë të fushës duke fituar një gjuajtje mjeshtërore. Zhurma drithëruese kur u godit topi

jehoi në të gjithë stadiumin Jingu. Duartrokitjet shpërthyen përreth meje. Në atë çast, pa asnjë arsye dhe pa asnjë qëllim, papandehur pata mendimin befasues: *Mendoj se mund të shkruaj një roman*.

Ende mund ta kujtoj ndjesinë e saktë. Më dukej sikur diçka kishte ardhur duke u valëvitur nga qielli dhe unë e kisha mbërthyer me duar. S’e kisha idenë pse kishte *rastisur* që ta kapja unë. S’e dija atëherë, dhe s’e di tani. Cilado qoftë arsyeja, *ajo* kishte ndodhur. Ishte si një zbulesë. Apo ndoshta epifani është fjala më e afërt. Gjithçka mund të them është se jeta ime u ndryshua në mënyrë të skajshme dhe të përhershme në atë çast kur Dave Hilton dha atë goditje të bukur kumbuese me top në stadiumin Jingu.

Pas lojës (Yakult fitoi me sa më kujtohet), mora trenin për në Shinjuku dhe bleva një tufë letrash të bardha dhe një stilolaps. S’kishte programe Word dhe kompjuterë atëherë, që do të thoshte se duhej të shkruanim gjithçka me dorë, të merreshim me radhë me personazhet. Ndjesia e shkrimit ishte shumë e gjallë. Më kujtohet sa i emocionuar isha. Kishte kaluar një kohë kaq e gjatë qëkur kisha shkruar në letër.

Çdo natë pas kësaj, kur kthehesha vonë nga puna, ulesha në tryezën time të kuzhinës dhe shkruaja. Ato pak orë para agimit ishin e vetmja kohë që kisha të lirë. Gjatë gjashtë e ca muajve të mëpasëm, shkruajta *Dëgjoje erën duke kënduar*. E përfundova variantin e parë diku afër mbarimit të sezonit të bejsbollit. Rastësisht, atë vit Yakult Swallows në kundërshtim më të gjitha parashikimet fitoi garën e Ligës, pastaj mposhtën kampionët e Pacific League, ekipin me shumë trofe të Hankyu Braves në Japoni. Ishte me të vërtetë sezon i mrekullueshëm që çoi peshë zemrat e të gjithë tifozëve të Yakult.

* * *

Dëgjoje erën duke kënduar është vepër e shkurtër, më afër një novele sesa një romani. Megjithatë m’u deshën shumë muaj dhe shumë përpjekje për ta përfunduar. Arsyeja deri diku, ishte koha e kufizuar për t’iu përkushtuar, por s’kisha asnjë ide se si shkruhet një roman dhe ky ishte problemi më i madh. Të them të drejtën, megjithëse po lexoja të gjitha llojet e gjërave, të parapëlqyerit e mi ishin romanet ruse të shekullit të 19-të dhe historitë amerikane të ndërlikuara me detektiv, por kurrë s’kisha lexuar me qëllime serioze letërsinë bashkëkohore japoneze. Kështu që s’e kisha idenë se çfarë lloj romanesh japoneze po lexoheshin asokohe, ose si duhet të shkruaja letërsi në gjuhën japoneze.

Për disa muaj, shkrova krejtësisht me hamendje, duke përvetësuar atë që dukej se ishte një stil i mundshëm dhe duke rendur me të. Megjithatë, kur e lexova në fund fare, s’ më la ndonjëfarë mbrese. Dukej se plotësonte kërkesat standarde të një romani, por ishte disi i mërzitshëm dhe libri në tërësi më la të ftohtë. Nëse kjo është mënyra si ndihet autori, mendova, reagimi i një lexuesi ndoshta do të jetë edhe më negativ. Duket sikur thjesht s’kam atë që duhet, mendova i dëshpëruar. Në rrethana normale, do të kisha hequr dorë. S’do të shkruaja më, por epifania që kisha përjetuar në shpatin me bar të stadiumit Jingu ishte ende e gdhendur qartë në mendjen time.

Ta mendosh tani, pamundësia të nxirrja një roman të mirë ishte mëse e natyrshme. Ishte gabim i madh të hamendësoje se një djalë si unë, i cili s’kishte shkruar kurrë asgjë në jetën e tij, të mund të krijonte diçka të shkëlqyeshme me provën më të parë. Po përpiquesha të arrija të pamundurën. Hiq dorë nga përpjekjet për të shkruar diçka të sofistikuar, i thashë vetes. Harroji të gjitha idetë e përshkruara në lidhje me “romanin” dhe “letërsinë” dhe shkruaj për ndjenjat dhe mendimet e tua sikur të të vijnë, lirisht, ashtu si të pëlqen.

Ndërsa ishte e lehtë të flisje për të përshkruar përshtypjet e tua lirshëm, ta bëje s’ishte kaq e thjeshtë. Për një fillestar si puna ime ishte veçanërisht e vështirë. Për të patur një fillim të ri, gjëja e parë që duhej të bëja ishte të hiqja qafe grumbullin e letrave të dorëshkrimit dhe stilolapsin. Për sa kohë që i kisha para meje, ajo që po bëja ngjante si “letërsi”. Në vend të tyre, nxora makinën time të shkrimit të vjetër Olivetti nga dollapi. Pastaj, si eksperiment, vendosa ta shkruaj fillimin e romanit tim në anglisht. Meqenëse isha i gatshëm të provoja gjithçka, mendova, pse të mos e provoja?

S’ka nevojë të thuhet se aftësia ime për të shkruar në anglisht s’shkoi shumë larg. Fjalorin e kisha tejet të kufizuar, ashtu si zotërimin e sintaksës angleze. Mund të shkruaja vetëm me fjali të thjeshta, të shkurtra. Kjo do të thoshte që, sado të ndërlikuara dhe të shumta të ishin mendimet që kisha në kokë, s’mund të përpiquesha t’i shkruaja si më vinin. Gjuha duhej të ishte e thjeshtë, idetë e mia të shpreheshin në një mënyrë lehtësisht të kuptueshme, përshkrimet të hiqeshin nga të gjitha tepricat, forma të bëhej kompakte dhe gjithçka të rregullohej për t’iu përshtatur një ene me

madhësi të kufizuar. Kësisoj ishte një lloj proze e përafërt, e papërpunuar. Ndërsa rrekeshja të shpreheshja në atë mënyrë, megjithatë, pak nga pak, proza filloi të merrte formë një ritëm i veçantë.

Meqenëse jam lindur dhe rritur në Japoni, fjalori dhe modelet e gjuhës japoneze kishin mbushur sistemin që *unë* duhej të shpërtheja, si t’i hapësh derën një stalle të mbushur me bagëti. Kur kërkova të shpreh mendimet dhe ndjenjat e mia me fjalë, ato kafshë filluan të përtypeshin dhe sistemi u rrëzua. Të shkruarit në një gjuhë të huaj, me të gjitha kufizimet e saj, e hoqi këtë pengesë. Po kështu bëri që të zbuloja se mund të shprehja mendimet dhe ndjenjat me një grup të kufizuar fjalësh dhe strukturash gramatikore, për sa kohë që i kombinoja në mënyrë të efektshme dhe i lidhja me mjeshtëri. Me pak fjalë, mësova se s’kishte nevojë për shumë fjalë të vështira – s’duhej të përpiquesha t’u bëja përshtypje njerëzve me lakadredhat e bukura të frazës.

Shumë më vonë, zbulova se shkrimtarja Agota Kristof kishte shkruar disa romane të mrekullueshëm në një stil që kishte efekt shumë të ngjashëm. Kristof ishte një hungareze e cila u arratis në Neuchâtel, Zvicër në 1956 gjatë trazirave në vendin e saj të lindjes. Ajo kishte mësuar - kishte qenë e detyruar të mësonte - frëngjisht. Megjithatë, përmes të shkruarit në atë gjuhë të huaj ajo arriti të zhvillonte një stil që ishte i ri dhe unik i saj. Përmbante një ritëm të fortë me fjali të shkurtra, dialogë që asnjëherë që ishin gjithmonë të drejtpërdrejtë, dhe përshkrime të sakta, pa ngarkesa emocionale. Romanet e saj kishin një tis misteri që sugjeronte të lexohej mes rreshtash. Mbaj mend që ndiheshja disi nostalgjik kur hasa për herë të parë veprën



e saj. Rastësisht, romani i saj i parë, *Fletorja e madhe*, u botua në vitin 1986, vetëm shtatë vjet pas *Dëgjoje erën duke kënduar*.

Pasi zbulova efektin kureshtar të krijimit në një gjuhë të huaj, duke përfutur kështu një ritëm krijues timin, e ktheva Olivetin në dollap dhe nxora edhe një herë tufën e letrave të *dorëshkrimit dhe stilolapsin*. Pastaj u ula dhe “përktheva” nga anglishtja në japonisht kapitullin që kisha shkruar. Epo, “transplantova” mund të jetë fjala e saktë, pasi s’ishte përkthim i drejtpërdrejtë, fjalë për fjalë. Gjatë këtij procesi, në mënyrë të pashmangshme, u shfaq një stil i ri në japonisht. Stili që do të ishte i imi. Një stil që e kisha *zbuluar* vetë. Tani e kuptova, mendova. Kështu duhet ta bëj. Ishte një *çast* i qartësisë së vërtetë, *çasti* kur sakaq gjithçka m’u bë e qartë si drita e diellit.

Më kanë thënë disa: “Vepra jote të krijon ndjesinë e përkthimit”. Kuptimi i saktë i këtij pohimi është i paqartë, por mendoj se godet në shenjë njërën anë të medaljes por s’i afrohet fare anës tjetër. Meqenëse fragmentet hapëse të prozës time të parë ishin, “mirëfilli” të “përkthyer”, komenti s’është plotësisht i gabuar; megjithatë vlen thjesht për procesin e shkrimit. Ajo që po kërkoja duke shkruar së pari në anglisht dhe më pas “duke e përkthyer” në japonisht ishte thjesht krijimi i një stili “asnjanës”, të pabukuruar, i cili do të më lejonte lëvizje më të lirë. S’kisha interes të krijoja një formë të zbutur të japonishtes. Doja të përdorja një lloj japonishteje sa më larg të ashtuquajturës gjuhë letrare në mënyrë që të shkruaja me zërin tim natyror. Kjo kërkonte masa të dëshpëruara. Në atë kohë do të shkoja aq larg sa

të thosha se, mund ta kem parë japonishten thjesht si vegël pune.

Disa nga kritikët e mi e panë këtë si fyerje kërcënuese ndaj gjuhës sonë kombëtare. Gjuha është shumë e vështirë, me një histori të gjatë qëndrese. Autonomia e saj s’mund të humbasë apo të dëmtohet seriozisht, sido që t’i qasesh, edhe nëse kjo qasje është deri diku e rreptë. Është e drejtë e qenësishme e të gjithë shkrimtarëve të eksperimentojnë me mundësitë e gjuhës në çdo mënyrë që ta imagjinojnë - pa këtë frymë aventure, asgjë e re s’mund të lindë kurrë. Stili im në japonisht ndryshon nga ai i Tanizakit, ashtu siç ndryshon nga ai i Kavabatas. Kjo është e natyrshme. Para së gjithash, unë jam një tjetër, një shkrimtar i pavarur me emrin Haruki Murakami.

* * *

Ishte një mëngjes pranveror me diell kur pata një telefonatë nga një redaktor në revistën letrare Gunzo duke më thënë se *Dëgjoje erën duke kënduar* ishte përzgjedhur listën e shkurtër për çmimin e tyre për shkrimtarëve të rinj. Kishte kaluar gati një vit që nga hapja e sezonit në stadiumin Jingu dhe kisha mbushur 30 vjeç. Ora ishte diku rreth 11 e mëngjesit, por isha ende në gjumë, pasi kisha punuar shumë vonë, një natë më parë. Prishaqejfas ngrita dorezën e telefonit por në fillim s’po e kuptoja se kush ishte apo çfarë po përpiquej të më thoshte. Të them të drejtën, e kisha harruar fare se ia kisha dërguar Gunzos *Dëgjoje erën duke kënduar*. Sapo e kisha mbaruar dorëshkrimin dhe ia ngeca në duar dikujt tjetër, dëshira ime për të shkruar m’u zhduk plotësisht. Shkrimi kishte qenë, si të thuash, një akt sfide - e kisha shkruar shumë lehtë, ashtu si më erdhi mua - kështu që ideja se mund të arrinte tek lista e shkurtër s’më kishte shkuar kurrë në mendje. Në fakt, u kisha dërguar kopjen e vetme. Nëse ata s’do ta kishin zgjedhur, ndoshta do të ishte zhdukur përgjithmonë. (Gunzo s’i kthen mbrapsht dorëshkrimet e refuzuara.) Me shumë gjasë gjithashtu, s’do të kisha shkruar kurrë një roman tjetër. Jeta është e çuditshme.

Redaktori më tha se ishin pesë finalistë dhe isha njëri ndër ta. U befasova, por isha edhe shumë i përgjumur, kështu që realiteti i asaj që kishte ndodhur s’u perceptua plotësisht. U ngrita nga shtrati, u lava, u veshja dhe dola për një shëtitje me time shoqe. Pikërisht kur po kalonim nga shkolla fillore vendase, vura re një pëllumb lajmës që fshihej në një kaçubë. Kur e ngrita, pashë që kishte një krah të thyer. Në këmbën e tij ishte ngjitur një etiketë metalike. E mora butësisht në duar dhe e çova në stacionin më të afërt të policisë, në Aoyama-Omotasando-s. Ndërsa po ecja përgjatë rrugëve anësore të Harajukut, ngrohtësia e pëllumbit të plagosur m’i mbushi duart. E ndjeva që dridhej. Ajo ishte një e diel e ndritshme dhe e kthjellët, dhe pemët, ndërtesat dhe vitrinat e dyqaneve shkëlqenin bukur në dritën e diellit të pranverës. Ky ishte çasti ku më goditi një mendim. Do ta fitoja çmimin. Dhe do të bëhesha romancier që do të gëzonte njëfarë suksesi. Ishte hamendësimi i guximshëm, por isha i sigurt në atë çast që do të ndodhte. Plotësisht i sigurt. Jo në mënyrë teorike por në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me intuitë.

* * *

E shkrova *Pinball*, 1973 vitin e mëpasëm si vazhdim i *Dëgjoje erën duke kënduar*. Ende e kisha barin e xhazit, që do të thoshte se edhe *Pinball* shkruhej natën vonë, në tryezën e kuzhinës. E them me dashuri dhe me pak siklet që këto dy vepra i quaj romane të tryezës së kuzhinës. Jo shumë kohë pasi përfundova *Pinball*, 1973, vendosa të bëhesha një shkrimtar me kohë të plotë dhe e shitëm biznesin. Menjëherë nisa të punoj për romanin tim të parë të plotë, *Gjuetia e ethshme e deles*, të cilin e quaj fillimin e vërtetë të karrierës time si romancier.

Sidoqoftë, këto dy vepra të shkurtra luajtën një rol të rëndësishëm në atë që kam arritur. Ato janë krejtësisht të pazëvendësueshme, ashtu si miqtë e dikurshëm. Duket e pamundur që do të takohemi përsëri, por kurrë s’do ta harroj miqësinë e tyre. Ishin një prani e rëndësishme, e çmuar në jetën time asokohe. Ato ma ngrohën zemrën dhe më nxitën në rrugën time.

Ende mund ta kujtoj kaq qartë se si u ndjeva kur diçka që po fluturonte erdhi dhe më ra në duar 30 vjet më parë në barin prapa rrethimit të fushës në stadiumin Jingu; dhe kujtoj po aq qartë ngrohtësinë e pëllumbit të plagosur që mora në po ato duar atë pasdite pranvere një vit më vonë, pranë shkollës fillore Sendagaya. Gjithmonë i ndërmend ato ndjesi sa herë që mendoj se çfarë do të thotë të shkruash një roman. Kujtime të tilla të prekshme më bëjnë të besoj në *diçka* që mbart brenda vetes dhe të ëndërroj për mundësitë që ajo ofron. Sa e mrekullueshme është që ato ndjesi janë ende brenda meje edhe sot.

Përktheu: Granit Zela

LIRIDON MULAJ

mos harro
të më kujtosh



OnufriRoman